

Nepër rrethet partizane

1-822
4/58



8SH-822

H 4 8

8SH-822

SV

NËPËR SHITIGJET PARTIZANE

~~U5778~~

LIBRARI SHTETËRE
BURGOS

2918

263 - H28
2

Materialet e këtij vëllimi janë marrë nga librat «Shtigjeve partizane» botime të Drejtorisë Politike të Ushtrisë Popullore.

Ushtria

LIBRARIA
DREJTORIA
POLITIKE
TË USHTRISË
POPULLORE

LIBRARIA DREJTORIA POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE

«Lufta nacionalçlirimtare ka qenë shkollë e madhe e luftës dhe e revolucionit për partizanët dhe për kuadrot tona politike dhe ushtarake. Atje ne hodhëm themelet e ushtrisë sonë, atje mësuam kuadrot tona të luftonin dhe të drejtonin në mënyrë revolucionare.

Kjo freski e frymës revolucionare, kjo partishmëri, jo vetëm duhet të përshkojë vazhdimisht ushtrinë tonë, por ajo duhet të lihet edhe si trashëgimi më i madh për brezat e ardhshëm të ushtarëve dhe kuadrove të Ushtrisë sonë popullore».

ENVER HOXHA

SIHARIQI I NJË NGJARJEJE TË MADHE

Ishin ditët e para të nëntorit, të vitit 1941.

Në orët e para të mëngjezit, të njëjës nga ato ditë, ashtu siç ishim marrë vesh, u takuam me shogën Nexhmije Xhuglini në një qoshe të rrugës së «Dibrës», (tani rruga Bajram Curri), afër selvisë.

— Balila! Merre! Duhet shtypur sa më shpejt! Trakti është i rëndësishëm! Kujdes!...

Ishte dorëshkrimi i traktit të parë të partisë, i traktit i cili të nesërmen me shpejtësi të rrufeshme, do të përhapte në tërë vendin sihariqin e ngjarjes së madhe: formimin e Partisë Komuniste Shqiptare.

Ç'gëzim e krenari ndjemë të gjithë ne, që na u besua të shtypim traktin e parë të partisë!

... Një bodrum i errët i një shtëpie përdhese në rrugën «Ceno Sharra», një qiri i hollë, që lëshonte një dritë të zbetë, një maqinë shkrimi e vjetër, marrë armikut, gjatë një aksioni, nga Mistua, Mihali dhe shokët e tjerë, një shaptilograf shumë i vjetër, letër dhe disa kuti boje, — ja kjo ishte e gjithë «shtypshkronja».

Fiqreti, një vajzë e paktë nga trupi, duke kënduar lehtë-lehtë, shkruan me shpejtësi të madhe në letrën e dyllit:

«... Fashizmi italian që prej më se dy vjetësh

na ka shkelur vendin dhe na ka punuar gjithë të zezat mbi kurrizin tonë...

...Lufta e hapur është i vetmi qëndrim kundrejt zaptuesit... Të gjithë burrat shqiptarë duhet të rrokin armët dhe të bashkohen me çetat... Lufta e çetave do të jetë shprehja më besnike e vullnetit të popullit shqiptar, për t'u çliruar nga skllavëria fashiste...»

Sa shpejt u shtyp ai trakt i jashtëzakonshëm. Letra e dyllit u bë gati. Shokët përgatitën shaptilografin dhe bojën. Filloi shtypi. Ja kopja e parë, e dyta, ... e dhjeta, ... e qindta. Sa gëzim ndjenë, Aliu, Mistua, Mihali, gjithë sa ishin aty, kur e lexuan traktin e shaptilografuar!

S'kishin kaluar veçse disa orë që ishte shtypur trakti dhe shokët e përhapën atë në të gjitha rrugët e Tiranës. Të nesërmen, «fatorinot» e çuan atë në të gjitha qytetet e vendit. Populli mësoi kështu sihariqin e madh, dëgjoi zërin e partisë.

Trakti i parë i partisë ra në duart e atij që i drejtohej, popullit. Thirrja e partisë për luftën e armatosur kundër armikut, shkoi në skajet më të largëta të vendit.

Qindra e qindra trakte dhe thirrje të tjera e pasuan atë. Ato çonin në popull zërin e partisë, zërin e lirisë.

Me sa dëshirë, etje dhe dashuri të madhe e lexonte, e ruante dhe e shpërndante populli shtypin e partisë. Traktet, shtypi i partisë, nën parullën «lexoje, shpërndaje, por mos ja dorëzo armikut», kalonin dora-dorës me shpejtësi të madhe. Ata bëheshin kështu një armë e fortë në duart e partisë, për mobilizimin e tërë popullit në luftën e madhe për çlirimin e vendit.

KUJTIME NGA DITËT E PARA

Thirrjes së parë të partisë, si kudo edhe në Vlorë, komunistët ju përgjegjën me zjarr e aksion. Kështu, 8 Nëntori, hyri në historinë e qarkut tonë, si sinjali i asaj lufte epike, që do të trondiste nga themelet okupatorët e kuislingët e vendit.

Në mbrëmjen e asaj dite, katër shokë, u nisën në drejtim të depove e kazermave armike, të vendosura mbi kodrat e Babiçës.

Rrugë e vështirë! Shi! Errësira e thellë dhe balta nuk i pengojnë shokët. Ata, ecin gjersa më në fund i afrohen kodrës së rrethuar nga dy gjerdhe telash me gjemba. Brenda atyre telave ndodhen kazermat e depot; ushtarët që flenë, dhe rojet që vijojnë në kulla betoni.

— Erdhëm! — përshpërit ai që i prin katërshes komuniste.

Po të tjerët, ende janë pas. Në heshtje, ngadalë, me këmbë e me duar, afrohen edhe ata.

— Kujdes! — thotë rishtaz ai dhe i qetë nxjerr gërshtëren, për t'u hapur shtegun shokëve, për t'ju futur në thellësi atyre depove e kazermave të armikut. Po edhe këtu duhet vepruar me shumë kujdes. Zhurma më e vogël mund t'u kushtojë shumë shtrenjtë. Mbi telat janë varur qindra kuti teneqesh, të cilat me lëkundjen më të vogël, mund të zgjojnë

rojet, që diku janë strukur në postet e tyre të vrojtimit.

Dhe ja, dora e kujdesshme e përgjegjësit të këtij aksioni e hap pa zhurmë këtë shteg.

Zemrat e të katërve rrahin nga emocioni.

Njëri prej tyre caktohet të qëndrojë në mbështetje.

Tre të tjerët bëjnë përpara. Po tani si telat edhe oborri janë mbuluar tej e tej me kuti teneqeje. Prapë duhet kujdes. Goditja me këmbë e ndonjërës prej tyre, mund t'i vërë në kushte tepër të vështira.

Dhe ja, me këmbë e me duar, ata afrohen në destinacion. Sipas ndarjes së detyrave: dy prej tyre, shpejt e shpejt minojnë depot e kazermat, kurse i treti i spërkat me benzinë.

Çasti i fundit afron.

Ja dhe fitilave tek u vihet flaka!

Pas pak, kur katërshja komuniste del nga ai rrethim telash me gjemba, një buçitje dëgjohet mbi ato kodra, e pastaj buçitje të tjera lëkundin nga themelet tokën. Flakët ngrihen në qiell. Të alarmuar, ushtarët e armikut braktisin shtretërit e kazermat e tyre. Edhe Vlora zgjohet!

— Ç'ka ngjarë? — pyesin qytetarët me habi.

Po të nesërmen, përkrah traktit që lajmëronte formimin e partisë, komunistët e Vlorës i bënë të ditur popullit të tyre, se ato flakë dhe ai shpërthim s'ishin gjë tjetër, veçse përgjegjja e tyre ndaj kushtrimit të madh që Partia Komuniste Shqiptare i kish drejtuar, si gjithë Shqipërisë, edhe Vlorës së Ismail Qemalit e Selam Musait.

Atij kushtrimi, si në gjithë Shqipërinë, ju përgjegj, po atë ditë, me një demonstratë të madhe antifashiste edhe populli patriot i Korçës. Mijëra

vetë demonstruan nëpër rrugët e bulevardet. Sihariqi i madh i themelimit të PKSH i kish ngritur peshë zemrat e tyre. Armiku ju përgjegj me plumba. Demonstrata u përgjak. Në krye të demonstronjësve, me grushtin lart, dhe me fjalët: «Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!», «Rroftë Shqipëria»!, ra komunisti Koci Bako, i goditur nga plumbat e agjentëve të armikut. Flamuri i rezistencës, flamuri i luftës për liri, u bë edhe më i kuq.

Armiku, për të tretur gjurmët, si dhe për ta shpëtuar agjentin që vrau Koci Bakon, e hoqi atë nga Korça dhe e dërgoi në Vlorë. Po Komiteti Qendror i PKSH, menjëherë sinjalizoi Komitetin qarkor të Vlorës dhe urdhëroi që ai të zhdukej sa më parë. Përgjegjja qe e rrufeshme. Brenda dhjetë ditësh, vrasësi i Koci Bakos, u shtri pa frymë nga plumbat e shokëve tanë të Vlorës. Tani vendi kish zot. Nëpër rrugët e qyteteve tona kërciste revolja kundër armiqve dhe tradhëtarëve.

Më 28 Nëntor të vitit 1941, punëtorë e fshatarë, burra e gra, të udhëhequr nga partia dhe duke bërë titur: «Jashtë okupatorët!», «Vdekje fashizmit gjakatar!», «Rroftë Shqipëria e lirë!», «Rroftë PKSH!», dualën në demonstratë. I tronditur, armiku u vërsul me bajoneta mbi demonstronjësit. Përleshja qe e ashpër. Nga shtiza ra trengjyrëshi i huaj. Urrejtja e popullit e bëri atë copë-copë. Në vend të tij hapi palët flamuri kuq e zi, ai që më 28 Nëntor të 12-tës, pas 5 shekujsh robërie, kish vleruar krenar, po në atë shesh, po në atë Vlorë.

Jehona e këtyre aksioneve të guximshme ndihet anembanë qarkut të Vlorës. Traktet e komunikatat e partisë bëjnë thirrje, për t'u ngritur të gjithë në këmbë.

Ideja e bashkimit si dhe parulla «Liria s'fitohet pa gjak!» bëhen motua e ditës.

Fjala e partisë kumbon me një forcë të çuditshme edhe në skajet më të largëta. Prestigji i saj ka filluar të rritet. Këtë e tregoi më së miri demonstrata e bukës në Vlorë, në mars të 42-së, gjatë së cilës, për herë të parë, masat popullore të fshatit e qytetit nën udhëheqjen e partisë u diktuan vullnetin e tyre organeve qeveritare. Ngjarja ndodhi kështu: Mungonte buka. Hambarët e fshatarësisë qenë boshatisur. Po edhe në treg bereqeti mungonte pothuaj krejtësisht. Edhe ai pak misër që dilte, blihej me çmim të lartë nga akaparatorët, për t'u shitur pastaj me trefishin e çmimit të blerjes. Me një anë mungesa e bukës e në anën tjetër spekulimi e rjepja e kishin shtuar urrejtjen e fshatarësisë së varfër e të mesme, si dhe të shtresave të varfëra të qytetit. Në këto kushte, partia në qark vendosi të dilte në krye të kësaj beteje. Komunistët, duke aktivizuar simpatizantët dhe aktivistët e partisë, e çojnë fjalën e saj gjer në skajet më të largëta. Parulla e partisë: «Të bashkuar ta detyrojmë qeverinë të gjunjëzohet!» bëhet e masave. Dhe ja, një ditë pazari, mijëra vetë nga fshatrat e Vlorës, zbresin në treg me thasë bosh. Komunistët, të rinjtë komunistë si dhe aktivistët e partisë, të fshatit e të qytetit janë vënë në lëvizje.

— Shokë! Të gjithë përpara prefekturës! — thërresin disa.

Nga qenë e nga s'qenë mijëra vetë drejtohen atje.

Për të gjithë u bë e qartë se në krye të këtij aksioni të madh e të guximshëm, qëndronte partia.

Fjala e saj qe e prerë: «Jo me lutje, po me bashkim e forcë do t'i detyrojmë të hapin depot!»

Po edhe përgjegjja e masës është e njëzëshme.

— Asgjë s'do të na luaj që këtej!

Dhe ja, para prefekturës shpërthejnë thirrjet:

— Bukë! Duam bukë!

Të tronditur, qeveritarët dalin në ballkon. Ata e ftojnë masën të largohet. Duke e quajtur këtë akt revoltë, e kërcënojnë se po të mos largohet, qeveria do të detyrohet të përdorë forcën.

Po asnjeri s'tutet nga këto fjalë. Asnjeri s'luan nga ai shesh.

Dhe thirrjet për bukë bëhen më të zjarrta.

Të ndezur, qeveritarët dalin për së dyti e për së treti në ballkon:

— Po s'u larguat menjëherë, do t'ju shtiem me armë.

Po kërcënimeve të tyre, masa u përgjegjet me qëndrim të prerë:

— Ne s'luajmë që këtej! Po s'na dhatë bukë, do ta marrim vetë!

Tani përballë turmës së revoltuar qëndrojnë qindra xhandarë e karabinierë të armatosur e gati për sulm.

Po njerëzit u qëndrojnë syptrembur përballë. Këngët patriotike e revolucionare gjëmojnë anembanë. Për qeveritarët bëhet edhe më i qartë karakteri i kësaj demonstrate. Komandanti i karabinierisë jep urdhër për shpërndarjen e demonstronjësve. Karabinierë e xhandarë vihen në veprim. Po turma, duke u zënë krah për krah, ngre një mur të pakalueshëm.

Në krye të tyre qëndrojnë komunistët. Me gjokset përpara, në krye të masës së revoltuar, ata thyjnë njëren pas tjetrës tentativat e armikut të armatosur.

— Bajonetat! — ndihet një zë.

Një karabinier sulmon, po dy duar të fuqishme e ngrejnë peshë në hava dhe e hedhin disa metra tej. Kapela i fluturon nga koka, kurse pushka përplaset në shesh, diku larg.

Çaste të zjarrta.

Qeveritarët, të trembur, kërkojnë të zbuten gjakrat.

Po masa kërkon të dalë prefekti në ballkon. Me urgjencë e gjejnë dhe e sjellin nga Skela. I zbetë, ai del dhe i lutet masës që të shpërndahet.

— Ju premtoj se pas disa ditësh çështja e bukës do të zgjidhet. Për të mirën tuaj e tonën, ju lutem shpërndahuni!

Po masa e frymëzuar nga partia, as largohet e as heq dorë nga kërkesa e saj. Dhe përsëri dëgjohet:

— Duam bukë! Po s'na dhatë do t'i hapim vetë depot.

Prefekti, i tronditur nga qëndresa e tyre e prerë, kërkon prej masës, të caktohet një komision, që çështja të bisedohet më shtruar.

Midis turmës dëgjohen zëra, që kërkojnë t'i përfaqësojë shoku Hysni Kapo. Dhe kështu bëhet. Shoku Hysni shkon te prefekti, i cili, duke fërkuar duart, mundohet ta bindë se pas një jave do të sjellë bukë patjetër. Po qëndrimi i të deleguarit është i prerë.

— Ata janë pa bukë! — i thotë. — Asgjë s'mund t'i largojë që këtej me thasët bosh!

Prefekti i shqetësuar nga këmbëngulja e tij mundohet të manovrojë, duke i premtuar se, jo për një javë, por brenda 3-4 ditësh do të sjellë bukë. Dhe kur sheh se as kjo s'i shkon, i premtun se kjo çështje do të zgjidhet brenda dy ditësh... E në

fund i lutet që të paktën, të presin gjer të nesërmen.
Po njeriu, që përfaqëson popullin, nuk bën lëshime.

— Do t'ish më mirë, — i thotë ai, — të dalim në ballkon e këtë fjalë t'ja thoni vetë popullit.

Dhe prefekti flet e premtion... Po i deleguari, nga ballkoni i prefekturës i demaskon premtimet e qeveritarit dhe e fton masën të thotë fjalën e saj. Dhe masa flet: Ajo e ka të qartë porosinë e partisë: «Të bashkuar e me grushtet lart t'i detyrojmë të gjunjëzohen!»

Dhe ja, parulla hidhet «Përpara! Drejt depos!»...

I deleguari, duke i lënë në strofkën e tyre qeveritarët, përsëri del në krye të masës.

Mijëra vetë drejtohen për nga konsullata italiane, drejt depos. Depua rrethohet e hapet përpara syve të konsullit italian. Tani jo qeveritarët, po komunistët dhe populli janë zotërit e saj, kanë marrë fuqinë në duar e po bëjnë shpërndarjen sipas nevojave. Tani jo qeveritarët, po partia dhe populli bëhen zot për disa orë në këtë skaj të qytetit.

Të trembura, organet qeveritare heshtin. Ndërsa turma zien e sheshi para konsullatës gjëmon nga këngët patriotike e revolucionare si dhe nga thirrjet:

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

Fitorja që e plotë. Mbështetja e partisë te masat dhe e masave te partia që dhe mbeti flamuri i ynë i luftës, flamuri ynë i fitores.

VOJO KUSHI «HERO I POPULLIT»

Vojo Kushi qe komandant i njësiteve guerile në Tiranë. Jeta e tij është e njëlojtë me jetën e shumë shokëve, që në lulen e rinisë së tyre, bënë fli veten për çlirimin e popullit nga okupatorët dhe tradhtarët.

...Kur dielli merrte udhën drejt qiellit dhe pushtonte me rrezet e tij Veliçikun e Rozafën, kur brigjet e Bunës avullonin e qyteti rropatej nën tingujt e kambanave, midis turmës ecte për në shkollë me çantën e librave në krah një djalosh tërë gjallëri e plot shëndet.

...Shkodra në atë kohë kishte shumë ngjyra, shumë minare e kambanare dhe të pasurit s'kishin kohë, për të parë dy gjunjë që mbuloheshin nga pantallona të grisura. Por Shkodra në pjesën më të madhe ishte e të varfërve. Dhe midis të varfërve s'kishte përse të turpërohej Voju për gjunjët që i kishin dalë jashtë. Kështu ai e kaloi vegjëlinë, i varfër dhe i këputur. Shumë herë i mungonin edhe librat, por ai i vinte shumë mendjen mësuesit kur shpjegonte, dhe kështu e kalonte edhe këtë vështirësi.

...Kur zilja lajmëronte mbarimin e mësimit të ditës, Voju hidhte në krah çantën me gjalmë e, i rrethuar nga çamarrokët e lagjes, kthehej në shtëpi.

Të gjithë e donin. Ndonëse dukej i rëndë në trup, ai ishte i zhdërvjellët si atlet. Disa nga tregëtarët e asaj kohe e tallnin pas krahëve duke e quajtur «leckaman të lindur për hamall». Por djali i Shkodër loces, që dukej sikur lëshonte shtat çdo ditë, tanimë kishte filluar të ëndërronte, për t'u bërë një luftëtar idealesh të reja. Vitet ja lëshonin vendin njëri-tjetrit dhe Vojua pajisej me virtyte të larta. Tani edhe zëri i tij kishte një notë burrërore. Fjala e tij zinte vend tek moshatarët e vet.

— Kanë me ardhë ditë të mira, o shokë, por jo nga qielli. Qe besa, kena me pa. Me krahët tona do të fitojmë atë që na duhet me jetue, por tash na duhet me bashkue grushtet. Grushti duhet të jetë i madh dhe i fortë sa të shembi malet, ndryshe mbreti nuk e liron fronin!...

Shokët e dëgjonin. Këto fjalët e fundit Vojua i thoshte me ton më të prerë.

— Ti ke fillue me folë kundër mbretit, e mbreti ka burgje ka hekura. Do të na lesh vetëm! — i thoshin ata nganjëherë. Por ai vazhdonte gjithnjë më me besim. Një ditë, shokët të shqetësuar i thanë të ruhej nga spiunët, porse ai pa frikë u tha me zë të lartë: Ju thashë, mbreti asht një hajdut me çizme. Mos prisni të mira prej tij! Bir i këtij kombi asht ai që punon e lufton me përmbysë mbretin...

Shokët çuditëshin për besimin e guximin që kishte. Shpesh në rrugicën për në shtëpi, ashtu siç ishin bashkë, takonin një furrxhi me shapkën e rrasur deri te veshët dhe me cigare në anë të buzëve. Vojua e ngrinte më fort zërin.

— Djalosh, djalosh, — i tha furrxhiu një ditë, — po të them se në rrugicën time s'të lejoj me folë kështu mbarë e mbrapsht!...

Vojua e shikoi drejt në sy, pastaj vazhdoi rrugën. Në orën kur Vojua kthehej nga shkolla, furrxhiu ndodhej shpesh përballë tij. Edhe ky dëshironte tani të bisedonte me këtë djalosh. Një ditë i doli përpara.

— Kam me të porositë për diçka. Hajde pak në furrë!

Si u përshëndet me shokët, djali i shkoi pas furrxhiut. Për të parën herë, ai u njoh me këtë furrxhi të çuditshëm. Biseda qe shumë interesante. Për të parën herë, Vojua mësoi se si mund të luftoj kundër regjimit.

— Na, merri këto fletë! Lexoi me kujdes! Le ta shtojmë familjen tonë të revolucionit dhe le të ecim me guxim e me këmbëngulje drejt qëllimit tonë!.. Vojua dëgjonte me vëmendje e çuditej. Furrxhiu që deri në atë kohë i kishte folur të rrinte urtë dhe të mos fliste ashtu mbrapsht i doli ndryshe!..

Një ditë e pyeti furrxhiun: — A kena shokë të tjerë?

— Shumë. Gjithë proletarët e Shkodrës, të Shqipërisë, të botës... Por nuk e kuptojnë të gjithë menjëherë. Ata duhet të kenë një shtab në krye, Partinë Komuniste. Dhe nuk do të jetë e largët dita kur do ta kemi edhe ne Partinë Komuniste.

Vojua mësoi shumë atë ditë. Ai mësoi se çdo veprim duhej të kishte një qëllim, çdo veprim duhej të studjohej më parë. Dhe doli nga furrxhiu me zemër të ngrohtë. Sapo kapërceu prakun, i hodhi një sy tabelës së nxirë të portës dhe lexoi edhe një herë emrin e njeriut që tani i kishte hyrë në zemër, Vasil Shanto.

Kështu u bë anëtar i Grupit komunist të Shko-

drës, dhe kështu i mori mësimet e para, për t'u kalitur si revolucionar. Një ditë, si çdo mëngjez, kambanat e Shkodrës nisën të gjitha në një kohë. Qyteti u zgjua. Dielli nxori synë mbi mal dhe Bregu i Bunës shkëlqeu. Vojua fërkoi sytë, u shkund pak dhe shkoi te depua e miellit, ku hamejtë vinin e venin me thasë në kurriz. Ishte veshur copë e çikë. U ngarkua, që kështu, duke u hequr si hamall, t'u kalonte më lehtë postbloqeve fashiste gjer në Tiranë, ku po vinte për t'u takuar me shokun Enver Hoxha.

Maqina me luan bronxi në turi, ishte e markës «Trenta katro». Qe e ngarkuar dhe shoferi po e fshinte me një leckë të lagur me benzinë. «Hamalli» i ra rreth e qark automjetit dhe pastaj ju afrua shoferit.

— Të hedh edhe tre thasë? — i tha parullën.

— Jo, s'ka nevojë. Hyp vetë! — ju kthye ai, pa e vështruar.

— Është e re dhe kujtova se mban më shumë se të tjerat, — tha e tundi kokën në shenjë miratimi.

— Thasët të m'i ruash me kujdes, përndryshe asnjë pare nuk të jap, dëgjove?

— Si urdhëron, zotni, — ju përgjegj Vojua dhe fytyrën e bëri tërë miell.

Pas pak maqina shungulloi dhe pastaj mori udhën drejt Jugut. Lart mbi dengjet e miellit ishte vetëm «hamalli» me fytyrën gjithë miell e rrobat lecka-lecka. Ndërsa vërtiste me gjallësi timonin, shoferi ndjente edhe frikë edhe kënaqësi. Ai nuk kishte prapa shpine vetëm dengje mielli, por edhe një «minë» të fuqishme që do të vendosej në themet e armikut e do të shpërthente për ta hedhur në erë. Pas disa kthesash nëpër rrugët e Tiranës u ndal në rrugën e Bamit. Vojua, me të arritur, u ngrit

të shkonte në punë të vet, kurse shoferi filloi të fshinte ngadalë xhamin e djersitur. Kur po ndahe-shin, shoferi i tha:

— Dalsh faqebardhë Vojo e mos harro udhën që bëmë bashkë! Përsëri do të takohemi. Ne jemi ushtarë të revolucionit!..

Dhe ushtarët e revolucionit me të vërtetë ishin shumë. Ato ditë ata i binin atdheut kryq e tërthor, për t'u lidhur me besa-besë në luftë për çlirimin e trojeve që u kishte shkelur i huaji.

Ndonëse dera e avllisë trokiti disa herë, plaka e Kusakëve nuk u ngut. Ajo, si i lajmëroi ilegalët se dikush po trokiste, hodhi mbi sup çarçafin dhe doli në rrugicë. Përballë saj u duk një djalë me trup të bëshëm e me rroba copë-copë. Plaka rrudhi vetullat.

— Ç'kërkon, more i paudhë? Largohu!

— Nënë, — i thotë Vojua, — kam punë tek ju.

— Ikë, more! — filloi t'i kërcënohej plaka. — S'ke punë ti këtu!

Por Vojua s'lëvizte nga vendi. — Kam punë, moj plakë, nuk i rashë kot kësaj dere. Bile më kanë thanë bash te shtëpia numër 300, këtu do të takoja Balilin, i cili ka ble një kalë e ai asht imi, e kam pasë humb gjashtë muej ma parë.

Balili, si i porositi shokët të kishin kujdes për Vojon, mori biçikletën e shkoi drejt e në rrugicën e ngushtë ku banonte në atë kohë shoku «Taras». Kur u kthye, e gjeti Vojon siç e kishte lënë.

— Fle akoma? — pyeti shokët. — Duhet ta zgjoj-

më. Tarasi e pret në takim. Ky është «Tarzani», ka ardhur nga Shkodra, i ngarkuar me një mision shumë të rëndësishëm.

— Tarzan, Tarzan, çohu se po të pret Tarasi!
— i flasin njëzëri shokët me gëzim. Djali brofi në këmbë.

— Kaq shpejt u kthehe? — i tha.

— Shkova te Tarasi dhe ai kur mori vesh se ke ardhur, u gëzua shumë dhe kërkon të takoheni menjëherë.

Tarzani i lëshoi sytë në kindat që kishte veshur e tha: — Me këto?

— Aq më mirë, shoku «hamall». Kur të bëjmë ndonjë dasmë do t'i gjejmë një palë rroba edhe për ty.

— Ka dasmë ma të madhe se me takue shokun Taras? — tha Vojua. Vështirë po e kam, or shok!

— Mos e ki vështirë! Ke për të parë sa do të gëzohet.

— Po vetë, kështu vishet?

— Si të mundë... Herë si usta, herë si kallaj-xhi e me pantallona të arnuara. Kjo është për ne veshja e kohës.

— Mirë, s'jam kah turpnohem. Na prij se po nisena! — shtoi i ardhuri.

Në rrugën e Bamit, drejt perëndimit, dy biçikleta rrëshqitën njera pas tjetrës. Balili shkante përpara, ndërsa Vojua njëzet metra pas tij. Balili frenoi dhe zbriti, kurse Vojua u fut me gjakftohtësi në rrugicë.

Dera e vogël u hap. Në rrugicë doli një grua, e cila e njohu mikun e shtëpisë.

— Ti, Balil, qenke?.

- Unë, por nuk jam vetëm.
 — Prit të lajmëroj!...
 — S'ka nevojë. Ai e di. Duhet të hyjë brenda ky miku i ri.

Biseda u zgjat. Vojua i tha të gjitha porositë që kishte dhe duke shikuar në sy me kureshtie shokun Taras, priste të merrte detyrën e re. Ishte i vendosur të kryente çdo punë, sado e vështirë që të ishte.

Shoku Taras, pasi e shikoi edhe një herë nga koka në këmbë, e shtrëngoi fort me të dy duart në krahë dhe i tha:

— Kështu pra shoku Tarzan, tani do të punojmë e do të luftojmë së bashku... Pastaj nxori nga brezi «nagantin» dhe ja zgjati atij.

— Na, merre këtë dhuratë nga unë! — i tha, — Vra me të sa më shumë fashistë e tradhëtarë! — dhe u ndanë...

Pas një copë herë, u hap prap deriçka, dolën Vojua e Balili dhe u hipën biçikletave. Shkodranit nuk ju durua dhe, para se të linte pas krahëve rrugicën, ktheu kryet edhe një herë, po nuk e pa atë që donte.

Kështu Vojo Kushi u njoh për të parën herë me shokun Enver.

...Gjethet po binin. Në oborrin e shtëpisë kishte dy kajsi, që kishin zbuluar krahët. Hardhia, si një tërkuzë zgjatej mbi çati. Vjeshtë. Një vjeshtë e mërzitshme.

Edhe atë natë të tre shokët, si hëngrën darkë, u

shtrinë në minderin e tyre. Herë-herë bënin ndonjë bisedë për jetën, për luftën.

Sadik Stavaleci shpesh kollitej rëndë. Shaminë e vogël nuk e hiqte nga goja. Mendonte se mikrobet e tuberkulozit nuk do të kalonin atë shami të mbushur me njolla gjaku. Në anën tjetër, përballë tij Xhorxhi Martini po ndërronte plagën që kishte në këmbë. Një shok kishte sjellë disa fasho e një pluhur si pudër. Ndërsa Vojua me atë trupin e tij të shëndoshë e të zhdërvjellët ishte mbështetur brinjazi e po fshinte armën. Vazhduan një copë herë kështu. Pastaj Sadiku ju drejtua Vojos.

— Sa e errët kjo natë, Tarzan!

— S'ashtë, por të duket ashtu.

— Sidoqoftë po të jetë nevoja do ta skuqim... (kolla e ndërpreu për një çast). Veç kjo drejt sëmundje s'po më le të qetë... — dhe përsëri u kollit.

— Do të bahesh ma mirë, Sadik, mbaje veten. Ke me pa.

— Po besa, — ndërhyri Xhorxhi, — mirë thotë Vojua. Do të bahesh ma mirë.

Sadiku bëri buzën në gaz.

— Ne jemi komunistë, dhe komunistët nuk kënaqen me lugë të zbrazët. Mbajeni mend këtë. Unë prej kësaj sëmundjeje nuk shpëtoj. Veçse kam një dëshirë që më vlon këtu në gjoks të mos vdes në shtratin e lëngimit, po në sheshin e luftës.

Xhorxhi e pa me keqardhje. Pastaj u ngrit, mori një libër nga rafti e nisi të lexonte. Kurse Vojua doli në sallon. Dritarja ishte e hapur. Ai pa se ishin vendosur rrëzë mureve skuadra të tëra fashistësh me helmata në kokë. U afrua te qoshja e dritares, dhe u përpoq të dallonte se çfarë kishte përtej shtëpisë.

Shpejt u bind se rrethimi ishte kryer. Si hije të zeza kalonin njëri pas tjetrit milicët e xhandarët. Siç dukej Kodra e Kuqe do të skuqej përsëri me gjak.

...Përjashta mbretëron një heshtje e rëndë. Një erë e ftohtë fryn dhe përplas mbi dritare gjethet e fundit të pemëve që rrethojnë shtëpitë. Qielli është i kthjellët. Rruga është mbushur plot. Po vallë ç'farë presin? Përse nuk fillojnë? Ndoshta sepse e dijnë që nuk është lehtë të luftosh kundër komunistëve?

Sa të gjata të duken minutat para fillimit të betejës. Të duket se nga çasti në çast diçka do të të përpijë...

Në derë trokasin me forcë. Këto të trokitura paralajmërojnë fillimin e betejës në Kodrën e Kuqe.

— Hapeni! Kontrolli! — dëgjoheshin zërat e fashistëve. — Hapeni me të mirë, se do ta thyejmë! S'kini ku vini shtëpia është e rrethuar!

Vojua u kthye te shokët, pa e prishur fare qetësinë, si të mos kishte ndodhur asgjë. Ndonëse nga jashtë dëgjoheshin britmat, ai nuk përgjegjej. Nga dritarja e shtëpisë tjetër, përsëri, dikush thërriti.

— Dëgjoni! Jeni të rrethuar! Hidhni armët dhe dorëzohuni!

Xhorxhit i hypi gjaku në kokë. Hapi me të shpejtë dritaren.

— Kjo është shtëpia jonë! Nuk dorëzohemi! Na jemi luftëtarë të lirisë, ne jemi komunistë!..

Fjala «komunistë» gjëmoi si krismë topi në veshët e fashistëve. Kujt nuk ju drodh zemra nga frika? Ata e kishin provuar sa herë se çdo të thotë komunistë. Komandanti nuk priti më dhe urdhëroi: — Zjarr!

Flaka çau errësirën dhe predhat thyen xhamet e shtëpisë. Lufta filloi flakë për flakë. Plumbat për-

shkonin kryq e tërthor shtëpitë e lagjes. Tirana gjëmoi.

Vojua hodhi në rrugicë granatën e parë. Të gjakosur ranë disa milicë. Pastaj me zërin e tij të fuqishëm thërriti:

— Përpara shokë, rroftë partia!

Hodhën tri granata njëherësh dhe vendin e mbuloi tymi. Dolën në rrugë, por nga shtëpia e lartë, në anën e poshtme, dy gryka zjarri prisnin në hesh-tje. Ato lëshuan breshëritë e para. Gjoksi i Sadikut u bë shoshë. Megjithkëtë trimi u kthye përsëri në derë. Vojua i shtriu krahun dhe përmes plumbave e ktheu në dhomë.

— Sadik, Sadik!..

Por Sadikun e kishin lënë forcat. Pa Vojon që i rrinte te koka dhe ashtu nëpër buzët e gjakosura, mezi belbëzoi: «Lamtumirë»... dhe ra në krahët e shokut.

Vojua e uli ngadalë, që të mos i lëndonte gjoksin e copëtuar nga plumbat. Veshët i ushtonin dhe dëshira për shpagë e bëri të papërmbajtur. Nuk ka hidhërim më të madh se kur humbet shokun.

Ja hoqi ngadalë granatat nga mesi, i futi nëpër xhepat e veta dhe nisi të dalë, por në çast, te dera u duk Xhorxhi. Edhe gjoksi i tij ishte bërë shoshë. Fytyra e tij ishte larë në gjak dhe si një lis i goditur nga rrufeja ra dhe ai përpara Vojos.

— Lamtumirë, Tarzan! Rroftë partia!

E mori në krahë dhe e afroi pranë Sadikut. Ju duk, sikur po flinin pranë njëri-tjetrit.

Pastaj hodhi granatën dhe kërceu nga dritarja. Kaloi avllinë e shtëpisë së parë, të së dytës dhe nëpërmjet një kopshti kaloi në rrugën tjetër. Ndërsa ecte me vrap mendjen e kishte te shokët, sikur tek

JU LUMTË DORA BREF TRIMAT E SHQIPËRISË!

Ditët e dhjetorit, si zakonisht, qenë të ftohta. Ngrica kishte mbuluar rrugët e Tiranës. Spiuni me damkë, i shitur këmbë e kokë te fashizmi, majori i «SIM»-it, Beqir Kazazi, që për të fituar para dhe për të marrë ndonjë gradë, vriste e priste këdo, po gjurmonte nëpër qoshe lëvizjet e komunistëve dhe të patriotëve të tjerë. Ky tradhëtar kishte kallëzuar te fashizmi me dhjetëra njerëz të pafajshëm, që dergjeshin nëpër burgje apo nëpër kampet e përqëndrimit. Si ata që vdiqën në tortura ashtu edhe ata që vazhdonin të torturoheshin, kërkonin hakmarrje. Dhe dita për t'u hakmarrë erdhi.

Nga Peza erdhën në Tiranë dy partizanë, të veshur si katundarë, me një kalë të ngarkuar me dru. Ata i shkarkuan drutë te shtëpia e një njeriu tonë, që banonte në një rrugicë, në fund të rrugës së Barrikadave.

Rreth tyre u mblodhën të zotët e shtëpisë dhe i shikonin partizanët me kureshtie dhe dashuri të madhe, se u dukeshin si njerëz të jashtëzakonshëm.

Në mbrëmje, pasi dha parullën, hyri brenda një djalosh, i dërguar nga Komiteti qarkor i partisë.

Pasi u përshëndetën, ata u veçuan në një dhomë dhe filluan të flisnin për spiunin dhe rrezikshmë-

rtnë e tij. Nga të dhënat e shokëve, që e kishin vëzhguar, dilte se spiuni, si finok i madh që ishte, ruhej aq shumë sa edhe tek rrinte ulur, fap kthente kokën sa nga një anë në tjetrën. Si duket, e ndjente se po i vinte rrotull hija e vdekjes. Partizanët u informuan nga shokët se spiuni, zakonisht, qëndronte në një kafe pranë kinemasë «Nacional» (sot 17 Nëntori). Si për ta mbyllur bisedën njëri nga partizanët tha: «Detyrën e kuptuam, tani shpejt do ta merrni vesh fundin e kësaj dhelpre».

U veshën që të dy tepdil, futën në xhepat e pardesyve nga dy granata dhe u nisën për të kryer detyrën.

Në kohën kur filmi po mbaronte, spiuni, pasi kishte hedhur disa gota, i kënaqur, se e kishte kryer detyrën e tij prej tradhëtari, u ngrit dhe u nis për në shtëpi. Por, sa bëri disa hapa, tre plumba të dhjetëshes së famshme të Kajo Karafililit e shtrinë për tokë dhe ai ra si buall në mes të rrugës. atentati i parë u krye me sukses. Shokët e qytetit i përcuallën partizanët, me një dashuri të jashtëzakonshme, për në çetën e Babë Myslimit. Kur po ndaheshin, ata u thanë shokëve: «Mirë u pafshim në ndonjë dasmë tjetër!»

Atentati i parë ishte sinjali i luftës së armatosur kundër tradhëtarëve, ishte përgjegjja që u jepte populli të gjithë atyre që i shërbenin okupatorit. Atë e pasuan dhjetëra aksione më të mëdha, e pasoi vetë lufta e madhe që bëri populli ynë nën udhëheqjen e partisë.

EPOPEJA E GJORMIT

Lufta e Gjormit kundër okupatorëve italianë dhe veglave të tyre u bë në një periudhë kur dashuria dhe besimi i popullit ndaj partisë qenë rritur shumë, kur, pas vendimeve historike të Konferencës së Pezës po kalohej nga aksionet e njësiteve të vogla në aksione më të gjera e me formacione më të mëdha dhe kur kudo po ngriheshin këshillat nacionalçlirimtare.

Në këtë kohë në krahinën e Kurveleshit dhe të Mesaplikut, si edhe në krahinat e tjera të qarkut të Vlorës, nuk njiheshin autoritetet e qeverisë fashiste e kuislinge. Atje vepronin kudo këshillat nacionalçlirimtare.

Për të dalë nga kjo gjendje armiku filloi të bënte një përgatitje serioze nga ana politike, me anën e emisarëve të Ballit Kombëtar, për të dobësuar rezistencën e popullit, për të tronditur besimin e tij tek partia dhe për të futur panikun me anë kërcënimesh e represaljesh. Por nga ana ushtarake, komanda fashiste italiane ishte e pazonja të stabilizonte gjendjen me forcat e veta, prandaj thirri në ndihmë bashibozukët, të ashtuquajturat «forca të milicisë vullnetare» me në krye tradhëtarët mercenarë Halil Alia dhe Selim Kaloshi. Këto forca, të

përbëra prej 1500 vetësh, arritën në Vlorë në 15 ditëshin e dytë të muajit dhjetor të vitit 1942.

Kështu u pregatit dhe filloi operacioni fashist kundër krahinës së Mesaplikut dhe Kurveleshit, që me të drejtë populli e quajti «epopeja e Gjormit».

Komanda fashiste italiane mendonte që në etapën e parë, me anën e forcave bashibozuke të Halil Alisë dhe Selim Kaloshit, të pastronte me anë të represaljeve qytetin e Vlorës nga komunistët dhe patriotët, të shkatërronte bazat e tyre dhe kështu të likuidonte lëvizjen nacionalçlirimtare në qytet. Në të njëjtën kohë i dërguari i Mustafa Krujës, i plotfuqishmi Qazim Koculi, duke shfrytëzuar influencën e tij në qarkun e Vlorës, me anë të emisarëve të Ballit Kombëtar, që pas Konferencës së Pezës, të përkrahur nga autoritetet e qeverisë kuislinge dhe nga agjentët e fashizmit, filluan të propagandonin programin e tyre, duhej të pregatiste terrenin në katundet e qarkut të Vlorës dhe të Kurveleshit, në mënyrë që forcat e operacionit të kryenin detyrën e tyre, asgjësimin e partizanëve, pa kurrfarë kundërshtimi nga populli. Etapa e parë duhej të mbaronte brenda muajit dhjetor 1942.

Në etapën e dytë komanda italiane mendonte që me forcat e saj bersaliere të motorizuara, dhe me të ashtuquajturën «milici vullnetare», të përbërë prej 1500 vetësh, të shkelte fshatrat e qarkut të Vlorës, duke filluar nga katundi Tragjas i krahinës së Mesaplikut dhe deri në fshatrat e Kurveleshit. Kjo etapë do të merrte fund me djegjen e shtëpive të ilegalëve dhe bazave të tyre, me internimin e familjeve fshatare deri në stabilizimin e situatës, dhe do të «kurorëzohej» me asgjësimin e çetave partizane.

Etapa e parë nuk u vu në jetë plotësisht. Planet e armiqve dështuan. Në kohën kur Halil Alia dhe Selim Kaloshi filluan rrethimin e qytetit të Vlorës, më 26 dhjetor 1942, si dhe kontrollin e brendshëm të qytetit, Çeta Plakë e Vlorës sulmoi depot e Radhimës. Po atë ditë me shpejtësi u nisën, për të asgjësuar çetën forcat e milicisë dhe bashibozukët në drejtimin Radhimë-Tragjas. Pas luftimesh, të cilat u zhvilluan më datën 26-27 dhjetor, çeta doli në malin e Gjormit. Forcat fashiste u përqëndruan në Tragjas dhe aty menduan që të vënë në jetë etapën e dytë — vazhdimin e operacionit në drejtim të Mesaplikut dhe Kurveleshit, duke sulmuar këto krahina në një kohë në dy drejtime: në drejtimin Tragjas-Mali i Gjormit — Gjormë do të vepronte grupimi prej 1500 vetësh i Halil Alisë dhe Selim Kaloshit, në drejtimin Kote-Qafë e Dushkut-Gjormë-Brataj, gjatë rrugës automobilistike, do të vepronte grupimi bersalier i motorizuar, i përforcuar me artileri dhe autobllinda.

Fillimi i operacionit do të varej nga koha që u duhej emisarëve të Ballit Kombëtar dhe të dërguarve të Qazim Koculit si dhe agjentëve të fashizmit për përgatitjen e terrenit, që operacioni të kalonte me lehtësi, pa rezistencë.

Edhe kjo etapë dështoi me turp për ta. Ata i bënë hesapet pa hanxhinë. Menduan që të shfrytëzonin befasinë, por ranë në kurthe të papritura, të përgatitura nga forcat partizane dhe nga populli i krahinës.

Ja si u zhvilluan ngjarjet: Prej datës 28-29 dhjetor 1942 Çeta Plakë e Vlorës, pas luftimeve në katundin Rradhimë e Tragjas me forcat italiane dhe milicinë bashibozuke, zuri vend në malin e Gjormit.

Gjatë kësaj kohe u ngrit në këmbë populli i fshatrave të krahinës së Mesaplikut dhe Kurveleshit të poshtëm për të shkuar në ndihmë të Çetës Plakë, atje ku zhvillohej lufta. Më datën 28 dhjetor në malin e Gjormit u grumbulluan afro 300 vetë nga njësitet vullnetare të fshatrave të afërta: Tragjas, Gumenicë, Gjormë, Velçë e Lepenicë nën udhëheqjen e shokut Hysni Kapo, i cili drejtonte edhe luftimet e Çetës Plakë në Tragjas. Forcat fashiste, të informuara për këtë forcë, nuk e muarën iniciativën të vazhdonin sulmet e tyre në drejtim të malit të Gjormit-Gjormë.

Më datën 30 dhjetor, me që s'dihej koha kur armiku mund të vazhdonte sulmin, dhe që të mos gozhdoheshin gjithë forcat e popullit në një luftë të gjatë, u vendos që ata të shpërndaheshin nëpër katundet e tyre dhe Çeta Plakë të zbriste në katundin Gjormë, në gatishmëri për të rifilluar luftimet në vendin më të përshtatshëm, në qoftë se armiku do të fillonte sulmin e tij. Atje ku do të fillonte lufta, në ndihmë të çetës duhej të vinin edhe njësitet vullnetare të katundeve.

Në pasditën e datës 30 të gjitha forcat zbritën nga mali dhe u grumbulluan në katundin Gjormë. **Shoku** Mehmet Shehu, i cili sapo ishte kthyer nga Kurveleshi, foli për situatën e krijuar, demaskoi veprimtarinë e agjenturës fashiste dhe emisarëve të Ballit Kombëtar dhe dha udhëzime për forcimin e gatishmërisë, për luftën pa kompromis kundër armikut, kudo që ajo do të zhvillohej nga çeta partizane ose çetat e fshatrave. Pas fjalimit të shokut Mehmet Shehu, populli i krahinës premtoi se do të ishte kurdoherë gati, kudo që do të paraqitej

nevoja dhe në mbrëmjen e datës 30 dhjetor 1942 u shpërnda në katunde.

Duhet të theksojmë këtu se emisarët e Ballit Kombëtar, Hysni Lepenica, Skënder Muça, Isuf Luzi, etj. dolën për herë të parë në këtë krahinë, në ato ditë, dhe bile disa nga ata muarën pjesë edhe në meeting. Duke parë që populli u shpërnda dhe që Çeta Plakë, e cila kishte një efektiv të vogël 40-45 vetë, nuk mund të ishte në gjendje t'u bënte ballë forcave të mëdha armike, ata njoftuan menjëherë Qazim Koculin dhe prefektin e qarkut të Vlorës, Lele Koçin se konditat ishin pjekur dhe operacioni mund të fillonte menjëherë. Qazim Koculi e Lele Koçi njoftuan për këtë komandën fashiste italiane se operacioni duhej të fillonte dhe premtorin se ai do të kryhej me sukses pasi, siç mendonin ata, emisarët e Ballit, që ishin ngarkuar nga fashistët italianë për sabotimin e luftës, e kishin kryer këtë mision, duke përjashtuar ndonjë përpjekje të parëndësishme me çetën partizane ose partizanë të veçuar, që do të asgjësoheshin menjëherë.

Më datën 31 dhjetor 1942 grupet e armikut nën komandën e konsullit të milicisë fashiste, kolonel Klementis filluan lëvizjen. Grupi i parë — forcat mercenare prej 1500 vetësh nën drejtimin e Halil Alisë dhe Selim Kaloshit mori drejtimin Tragjas-Mali Gjormit-Gjormë. Grupi i dytë — forcat e motorizuara bersaliere prej afro 700 vetësh, të përforcuara me artileri dhe autoblanda morën drejtimin Uji i Ftohtë-Vlorë-Kote-Gjormë-Brataj. Të dy grupet duhej të takoheshin në katundin Gjormë, pastaj me goditje koncentrike të rrethonin dhe të asgjësonin forcat partizane në rajonin e Gjormit dhe më vonë të vazhdonin pastrimin e kra-

hinës së Mesaplikut dhe pjesës së poshtme të Kurveleshit, deri në katundin Kuç.

Në orë 14.00 të datës 31 dhjetor të dyja kolonat u afruan dhe mbyllën darën e rrethimit në katundin Gjormë. Një pjesë e çetës filloi luftën me trupat e motorizuara në katundin Gjormë dhe në përrua të Silorakut, ndërmjet katundeve Lepe-nicë dhe Brataj. Ndërsa, një orë më vonë, pjesa tjetër e Çetës Plakë dhe çeta e katundit Gjormë filluan luftën me grupin e parë në perëndim të katundit Gjormë, kur forcat fashiste zbrisnin malin e Gjormit.

Luftimet vazhduan gjithë ditën. Armiku u gozhdua në vend nga forcat partizane dhe njësitë e katundit Gjormë.

Gjatë natës 31 dhjetor — 1 janar 1943 çetat e katundeve Kuç, Bolenë, Vranisht, Tërbaç dhe një pjesë e çetës së Bratajt, që ditën e 30 dhjetorit ishin kthyer nga Gjormi, me të dëgjuar sinjalin e alarmit dhe luftimet në katundin Gjormë, lëvizën me shpejtësi në drejtim të katundit Gjormë dhe zunë pozicione kundrejt armikut, i cili kishte kaluar në mbrojtje në katundin Gjormë dhe në kodrat në periferi. Çetat e katundeve Brataj, Matogjin, Ramicë, Velçë gjatë natës zunë pozicione në bregun e lumit Shushicë në lindje dhe në juglindje të katundit Gjormë, deri te ura e Gjormit. Në këtë mënyrë forcat fashiste u rrethuan plotësisht.

Në mëngjezin e datës 1 janar shoku Hysni Kapo kontrolloi me radhë pozicionet që kishin zënë çetat e katundeve dhe u përcaktoi detyrat. Në orën 5.30 filluan luftimet, të cilat vazhduan gjatë gjithë ditës, dhe u karakterizuan nga sulme e kundërsulme nga të dyja palët. Armiku, pasi pësoi humbje të rënda

u detyrua të strukej në shtëpitë e katundit Gjormë, ku kaloi edhe në mbrojtje.

Më datën 1 janar 1943 lajmi për zhvillimin e luftimeve në Gjormë u shpërnda edhe në krahina të tjera të largëta, në atë të Mallakastrës, Sevasterit, Mavrovës. Populli i këtyre krahinave u ngrit të vinte në ndihmë të forcave partizane dhe të pullit të Mesaplikut. Disa nga çetat e këtyre krahinave, si ato të fshatrave Vajzë, Sevaster, Mavrovë zunë pozicione gjatë rrugës automobilistike Kotë-Tepelenë, për të pritur kolonat e armikut, që lëviznin gjatë kësaj rruge, dhe që mund t'u vinin në ndihmë forcave fashiste, kurse një pjesë e çetave të Mallakastrës u grumbulluan në Poçem, në gatishmëri për të kaluar lumin e Vjosës.

Lufta pothuaj po merrte një karakter frontal. Populli ishte ngritur në një kryengritje të armatosur. Komanda italiane, duke parë këtë rrezik, mori masa për sigurimin e rrugës automobilistike Drashovicë-Qafë e Dushkut-Tepelenë dhe Qafë e Dushkut-Gjormë, për t'u dhënë mundësi forcave, që luftonin në Gjormë, të tërhiqeshin në Vlorë dhe të ndalonte operacionin e ndërmarrë.

Nga sa përshkruam më lart arrijmë të nxjerrim këto konkluzione:

1. Lufta e Gjormit tregoi, në radhë të parë, lidhjet e ngushta të masave të popullit me partinë. Lufta u përgatit dhe u drejtua nga partia, nën udhëheqjen e shokëve Mehmet Shehu dhe Hysni Kapo.

2. Dështoi me turp dhe humbje të mëdha për armikun operacioni i filluar. Armiku nuk ua mbërriti dot qëllimeve që kish vënë për shtypjen e lëvizjes nacionalçlirimtare dhe asgjësimin e partizanëve. Në të kundërtën u shtua simpatia dhe besimi

i popullit tek partizanët, u shtuan radhët e partizanëve, u shtuan radhët e komunistëve. Krahina e Kurveleshit dhe ajo e Mesaplikut mbetën krahina të lira, të çliruara, ku pushteti ishte në duart e popullit, të këshillave nacionalçlirimtare që udhëhiqeshin nga partia.

3. Lufta e Gjormit demaskoi rëndë pseudo-patriotët dhe politikanët e Ballit si agjentë dhe bashkëpunëtorë të okupatorëve fashistë, qysh në fillim të aktivitetit të tyre për mashtrimin e popullit me anën e politikës tradhëtare, të kompromiseve dhe nënshtrimin ndaj zaptojësve.

4. Nga ana taktike lufta e Gjormit tregoi organizimin e lartë gjatë përgatitjes, zhvillimit dhe drejtimit të luftës popullore. Në këtë luftë u gërshtuan lufta e Çetës Plakë, si njësi e rregullt partizane, e cila kryente aksione dhe manovronte në gjithë qarkun e Vlorës, e mbështetur nga njësitet vullnetare (çetat e katundeve), të cilat qëndronin në katund, hynin në luftë po ta lypte nevoja në afërsi të katundeve të tyre ose katundeve fqinje, me ose pa çetën, vinin në ndihmë të çetës partizane ose çeta partizane u vinte në ndihmë këtyre, atje ku zhvillohej lufta. Ky bashkëveprim u vu në jetë në luftën e Gjormit. Përveç Çetës Plakë dhe njësiteve vullnetare (çetave të katundeve, të cilat në pjesën më të madhe ishin njësite të armatosura, punonin në fshat dhe ishin të gatshme për luftë), në luftën e Gjormit mori pjesë edhe populli, që nuk ishte caktuar në këto njësite, i armatosur kush me armë luftarë, kush me armë të ftohta e kush me drunj etj. mjete të vendit, por i gatshëm për të kryer detyra të ndryshme si furnizimin, ndërlidhjen, zëvendësimin e atyre që mund të vriteshin duke përdorur armët e

tyre, ose armët që mund t'i merrte armikut, të shtonte radhët e njësive.

5. Në luftën e Gjormit armiku u gjend përpara të papriturave. Ai jo vetëm u godit në befasi nga ana e Çetës Plakë, por edhe nga forcat e popullit dhe në mëngjez u gjend i rrethuar nga forca të mëdha të popullit, jo vetëm të krahinës së Mesaplikut, por dhe të katundeve të krahinave të tjera fqinje të qarkut të Vlorës, gjë që ai nuk e parashikonte kurrë se mund të ngjante brenda një kohe të shkurtër, siç ngjau që brenda natës të organizohej një forcë e madhe, e cila i kalonte të 800-900 vetët në Gjormë, përveç atyre që u ngritën në Mallakastër, Sevaster, Mavrovë dhe ishin gati për të hyrë në luftë. Kjo solli jo vetëm panik në radhët e armikut, por edhe mosbesimin dhe grindjen ndërmjet klikave tradhëtare të qeverisë kuislinge me komandën italiane dhe komandën e milicëve bashibozukë, duke pandehur se kurthi i Gjormit ishte i përgatitur. Për këtë, Halil Alia e Selim Kaloshi në bashkëveprim me komandën italiane, gjoja për hakmarrje, për dëmet e mëdha që pësuan, afro 200 të vrarë, ndërmjet tyre dhe komandanti i operacionit, koloneli Klementis, pushkatuan të dërguarin e Mustafa Krujës, Qazim Koculin dhe prefektin e Vlorës, të cilët i patën siguruar që operacioni do të kalonte pa asnjë humbje.

Kjo ishte disfatë e madhe për qeverinë kuislinge, për Ballin Kombëtar dhe për komandën fashiste italiane.

AUTOMATIKUN T'JA DËRGONI NËNËS SIME, PËR KUJTIM!

Kur dëgjuan sinjalin, të gjithë partizanët e Batalionit III të Brigadës XVI sulmuese, brenda një kohe shumë të shkurtër, u mblodhën te vendi i caktuar. Ata prisnin me padurim të mësonin pse ishin mbledhur. Në këtë kohë, doli përpara tyre nënkomandanti i batalionit, Sadush Myftari dhe, duke ju drejtuar partizanëve, tha:

— Shokë, shtabi i batalionit ka vendosur të sulmojmë Kodrën e Çipllakut! — dhe zgjati dorën në atë drejtim. — Kush del vullnetar?

Pa mbaruar mirë ai, shpërthyen thirrjet e partizanëve: «Të gjithë! Të gjithë!»

Komandanti, i entuziazmuar, tha vetëm:

— E mirë atëhere, si gjithnjë, edhe sonte do të sulmojmë të gjithë bashkë.

Të gjithë partizanët u gëzuan. Ata nisën të rregulloheshin shpejt: të shikonin armët, të merrnin municion, bomba, etj.

Shoqja Feride Hakimi ishte së bashku me një grup partizanësh. Ajo e qeshur dhe e gëzuar, po i thoshte komandantit të kompanisë së saj:

— Edhe unë do të jem sonte në aksion!

Me buzë në gaz ai ju përgjegj:

— Mirë, po mos e lësh pa mësuar dramën «Pleqtë në luftë», që do të lozësh?

Ferideja sikur u turpërua pak, u skuq në fytyrë, po shpejt e mblodhi veten dhe tha:

Pas fitores, atë do ta lozim dhe në Fier.

Të gjithë qeshën me të madhe. Pastaj ajo, duke marrë një pamje serioze, ju drejtua komandantit:

— Ti paske bomba plot, shok, unë s'kam asnjë. Mbrëmë i harxhova të gjitha, më jep të paktën një, sa për sonte.

Deshi s'deshi, komandanti i kompanisë I i dha një. Para se të largohej, ajo i tha komandantit:

— Ke për ta parë se si do ta përdor! — Dhe shkoi me vrap në skuadër.

Sadushi, që u nis përpara, u tha shokëve para se të ndahej:

— Posa të dëgjoni zërin tim, në sulm drejt kodrës!

Pregatitjet ishin bërë. Ora po afronte. Të dy kompanitë partizane u nisën drejt objektivit.

Nata ishte e errët. Binte një shi i hollë e i pandërprerë. Të gjithë u qullën. Dikush tha me zë të ulët.

— More po na hyri në kockë! Nuk pushoi i mallëkuari!

— U bë bashkudhëtari ynë, — ja preu fjalën një tjetër me të qeshur.

Nata e errët dhe shiu i ndihmuan kompanitë partizane t'u afrohen sa më shumë pozicioneve armike. Në një hendek afër kodrës u bë lidhja midis kompanive. Partizanët, pritën sinjalin e nënkomandantit të batalionit.

Pas pak, çasti i dëshiruar erdhi. Në krahun e majtë u dëgjua një zë: «Para partizanë!» Sa dëgjuan

këtë thirrje, partizanët, ashtu siç ishin me armët gati dhe granatat në duar, u turrën drejt kodrës ku gjermanët kishin zënë pozicione të mira dhe ishin në pritje. Kodra oshëtiu nga armët dhe bombat e dorës. Rreth e përçark, ajo u ndez flakë. Dukej sikur drejtoheshin mbi të prozhektorë të fuqishëm. Për një çast, heshtje! Po vetëm një çast, se pastaj, zhurma e mitralozave dhe bombave, që hidhte armiku, shpërtheu përsëri me furi.

Më shumë se katër mitralozë armiq përpiqeshin të pengonin sulmin partizan. Po ishte e kotë! Kur automatiku dhe bombat pushonin një çast, dëgjohej thirrja: «Përpara partizanë!» Ishte zëri i Feridesë, e cila sulmonte përpara. Më tej, partizanët hasën në tela me gjëmba.

— As këto nuk kanë për t'i shpëtuar gjermanët! — tha Ferideja.

— Kërkoni shtegun, shokë! — briti dikush.

Nga krahu tjetër u dëgjua zëri i Sadushit:

— Këtej shokë, këtej! Hajdeni, se e gjetëm shtegun!

Dhe partizanët u sulën andej. Lufta mori zjarr nga të dyja anët. Një mitralier partizan kish shkuar aq përpara sa që një bombë e plagosi në shumë pjesë të trupit dhe mitralozi pas pak, pushoi. Por s'kaloi shumë dhe një partizan e vuri përsëri në veprim.

— Ja atje qëllo! — i tha një zë i mbytur.

Mitralieri i ri e kuptoi se për ku ishte fjala. Një mitraloz armik i rrihte si me çekan partizanët e kompanisë dhe nuk i linte të ngrinin kokë. Mitralieri pasi vuri në shenjë, tërhoqi këmbëzën... «Kjo është për dasmën tuaj! — tha nëpër dhëmbë». Mitralozi armik heshti. Në këtë kohë, Sadushi dhe Fe-

rideja u hodhën në llogoret armike. Midis zhurmës së luftës, ata dëgjuan ca pëshpëritje. Këmbët u ndeshën në disa kufoma. Ishin gjermanë të vrrarë. Lufta tani zhvillohej trup me trup brenda në llogore. Në këtë luftë ra Ferideja. Pas saj, u plagos rëndë Sadushi. Armiqtë pësuan humbje të rënda, por ato nuk e zëvendësonin humbjen e Sadushit dhe të Feridesë.

Dhe në kohën kur Sadushi po jepte frymën e fundit, u la këtë porosi shokëve: «Automatikun tim t'ja dërgoni nënës për kujtim. Rroftë Partia! Rroftë Shqipëria!» — dhe heshti përgjithmonë.

ÇLIRIMI I VOSKOPOJËS

Në fillim të muajit janar 1943, komanda fashiste e qarkut të Korçës, e tronditur nga goditjet e çetave partizane, mori një sërë masash, për të forcuar postat e xhandarmërisë dhe garnizonet ushtarake, të vendosura në periferi të krahinës. Kështu, në ditët e para të janarit (në garnizonin e Voskopojës u vendos një repart i përbërë nga rreth 60 milicësh dhe një numër xhandarësh. Pas kësaj, menjëherë fashistët kryen një operacion kundër popullit të pafajshëm të katundeve të lokalitetit të Voskopojës, bënë tortura, masakra, si dhe arrestime për të shtypur lëvizjen nacionalçlirimtare. Komiteti qarkor i partisë për Korçën, udhëzoi shtabin partizan të qarkut, që të përgatiste dhe të organizonte operacionin, për likuidimin e garnizonit ushtarak të Voskopojës, të lironte të burgosurit dhe të vendoste pushtetin popullor.

Shtabi partizan i qarkut, për kryerjen e këtij operacioni, organizoi veprimet luftarake të kombinuara me pjesëmarrjen e tri çetave partizane: të Gorës, të Ostrovicës dhe të Oparit, që kishin së bashku gjithsej 85 partizanë.

Simbas planit të operacionit, për të ruajtur befasinë, afrimi dhe përqëndrimi i çetave partizane

u krye gjatë natës së 15 dhe 16 janarit. Çetat partizane erdhën në rajonin e Voskopojës nga drejtime të ndryshme. Marshimi i tyre u bë gjatë një nate dimri, kur dëbora në disa vende kalonte mbi një metër e gjysmë. Nata ishte e errët. Frynte një erë e fortë që të thante.

Çdo çetë, brenda natës, duhej të bënte mbi 25 km. marshim në kondita shumë të vështira klimaterike. Por urrejtja për armikun, dashuria për popullin, disiplina e lartë dhe besimi në fitore, bënë që ta kryenin marshimin në një kohë rekord. Kështu, të tria çetat zunë, përpara agimit, pozicionet e caktuara, vendosën lidhje midis tyre dhe bënë rrethimin e plotë të armikut në garnizonin e Voskopojës.

Shtabi i qarkut, drejtimin edhe organizimin e luftimit të të tria çetave, ja ngarkoi komandantit të çetës së Gorës, shokut Teki Kolaneci, i cili, pasi analizoi situatën, në bashkëveprim me komandantët e çetave të tjera, caktoi pozicionet e nisjes për sulm, drejtimet dhe objektet e sulmit për çdo çetë. U organizua kombinimi i veprimeve dhe bashkëveprimi midis tyre, si dhe mënyra e mbajtjes së ndër-lidhjes.

Për sigurimin e krahëve të çetave partizane, që sulmonin Voskopojën, nga çeta e Gorës dhe e Ostrovicës, u caktuan dy grupe partizanësh nga 5-7 veta secila. Ato u vendosën në kodrat tek ura e Kovaçit, për të ndaluar ardhjen e forcave armike, nga ana e Korçës.

Me sinjalin e caktuar, në orën 8 të mëngjezit, çetat partizane kaluan në sulm. Armiku që me goditjen e parë të partizanëve, lëshoi pozicionet që mbante në periferi të Voskopojës dhe u fut në strof-

kë, duke organizuar mbrojtjen brenda ndërtesave të qendrës së tij. Pas një orë luftimesh, kur pa se nuk kishte asnjë rrugë-dalje për shpëtim ose për rezistencë të mëtejshme, me thirrjen që i bëri shtabi i përbashkët i çetave, armiku pranoi të dorëzohej pa kushte. Komandanti i milicisë, së bashku me një grup milicësh, kaloi në anën e çetave partizane. Kështu që garnizoni armik mbeti pa komandë dhe si rrjedhim, pjesa tjetër u zu rob dhe u çarmatos. Garnizoni ushtarak i Voskopojës, u likuidua. Në godinën e xhandarmërisë u vendos flamuri çlirimtar i çetave partizane. Pas kësaj u hap burgu dhe u liruan 14 të burgosur. Gjithë armatimi, municioni, veshmbathja e materiale të tjera të armikut, u muarën nga çetat partizane, kurse ushqimet ju ndanë popullit të Voskopojës.

Komanda e garnizonit të Korçës, pa vonuar, dërgoi forca, për t'i ardhur në ndihmë garnizonit të Voskopojës. Kur pararoja armike erdhi te ura e Kovaçit, në lindje të Voskopojës, patrulla partizane lajmëroi shtabin, i cili urdhëroi që çetat partizane të nisëshin në drejtim të Urës së Kovaçit, duke lënë në Voskopojë një grup për tërheqjen e materialeve. Përpjekja e forcave kryesore të çetave partizane me pjesën më të madhe të kolonës armike, që vinte nga Korça, filloi nga mesdita.

Luftimet vazhduan gati 3 orë rresht me sulme e kundërsulme nga të dyja palët. Megjithëse armiku ishte 2-3 herë më i madh në numër, trimëria e shpejtësia e veprimeve të partizanëve, si dhe organizimi e drejtimi i mirë, siguruan supremacinë e forcave tona në të dy krahët e armikut, sollën fitoren mbi fashistët.

Në këtë luftë armiku pati 18 të vrarë, midis tyre agentin e rrezikshëm të milicisë fashiste, nëntoger Sali Pilurin, një major dhe një toger italian. 22 armiq u plagosën dhe 24 të tjerë u zunë robër. Nga armiqtë mundi të shpëtonte vetëm një. Nga ana jonë, u plagosën vetëm 2 partizanë, njëri prej tyre, Sami Qeska, vdiq më vonë me këto fjalë në gojë: «Vdes i lumtur se e kreuva detyrën! Rroftë Shqipëria e Lirë!»

Tri ditë më vonë, komanda fashiste e Korçës, u dërgoi ultimatum komandave të çetave partizane, që morën pjesë në luftën e Voskopojës, për të liruar robërit. Komandat e çetave partizane njoftuan okupatorin, se robërit mund të liroheshin, vetëm në qoftë se armiku do të plotësonte këto kushte:

- a) Të ndërpriste vrasjen e popullatës civile.
- b) Të ndërpriste djegjet e shtëpive të njerëzve të pafajshëm.
- c) Të ndërpriste arrestimet në masën e popullit.

Në shënimin e përgjegjes së komandave të çetave theksohej: «Në rast se midis robërve do të ketë njerëz që do të shfaqin dëshirën të qëndrojnë vullnetarisht në radhët e partizanëve, ata do të mbeten në çetë.»

Operacioni për likuidimin e garnizonit ushtarak të Voskopojës, shënoi një etapë të re në veprimet luftarake të çetave partizane. Ai ishte një nga operacionet e para, që u zhvillua me pjesëmarrjen e disa çetave, për likuidimin e një objekti të përbashkët. Ky operacion pati një rëndësi të madhe politike e ushtarake. Garnizoni i armikut u likuidua plotësisht. Voskopoja u çlirua përfundimisht.

Me gjithë përpjekjet e herëpashershme që bëri armiku, për ta pushtuar prapë Voskopojën, nuk pati asnjë sukses. Kështu që Voskopoja u bë bazë e qendër e çetave partizane dhe e formacioneve të tjera të Ushtrisë nacionalçlirimtare.

Tri ditë më vonë Komanda e Krahut të Dibrës u ngrit në Voskopojë dhe u bashkua me Komandën e Krahut të Dibrës në një Komandë të bashkuar të çetave partizane. Komanda e bashkuar e çetave partizane ngritën okupimin e rrethit rreth Voskopojës, të cilin e përbënte Komanda e bashkuar e çetave partizane të Krahut të Dibrës.

a) Të ndërpiste vrasjen e popullatës civile.
b) Të ndërpiste dëgjor e shpëtoj të njërësve të palishmë.

c) Të ndërpiste arrestimet në masë e popullit.
Me këto veprime të çetave partizane të bashkuara të Krahut të Dibrës, në rast se munda të bënte të mundur të shpëtojë dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin.

Operacioni për likuidimin e garnizonit ushtarak të Voskopojës shënoi një etapë të re në veprimet partizane të çetave partizane. Ai shënoi një etapë të re në veprimet partizane të çetave partizane dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin dhe të shpëtojë të gjithë popullin.

AI JETOI DHE VDIQ SI KOMUNIST

Para syve kam fotografinë e Shemsi Hakës dhe mendja më shkon në vitet e luftës, kur revolveri i Shemsiut, dhe i shokëve të tjerë, kërciste rrugëve të Tiranës, kundër spiunëve.

Shemsi Haka ishte bir i një familjeje të varfër nga fshati Cerjan i Peshkopisë. Varfëria e detyroi atë të vinte në Tiranë, për të nxjerrë bukën e gojës e për të ndihmuar familjen. Duke kaluar nga një familje pasaniku në tjetrën, Shemsiu provoi mbi shpatullat e tij të njoma barrën e rëndë të shtypjes, e bashkë me të, fyerjen, poshtërimin. Ndonëse akoma i ri, ai nisi ta kuptonte botën, të bënte dallimin midis të pasurve dhe të varfërve, midis njerëzve të dorës së tij dhe atyre që ja thithnin gjakun si shushunja.

Pushtimi italian i vendit i rëndoi edhe më shumë vuajtjet e popullit tonë dhe e shtoi më shumë revoltën e tij. Si njeri i varfër, i shtypur e i shfrytëzuar, edhe Shemsiu ziente nga urrejtja për pushuesit edhe sunduesit e vendit. Kjo revoltë ju shtua veçanërisht kur e mobilizuan ushtar dhe e dërguan, si mish për top, në frontin italo-grek. Atje Shemsiu ra shpejt në kontakt me grupet revolucionare, të

cilat bënin propagandë midis atyre pak ushtarëve, të mobilizuar me forcë dhe u tregonin se lufta ishte e padrejtë, se ajo nuk kishte asgjë të përbashkët me interesat e popullit shqiptar. Si pasojë, bashkë me të gjithë ushtarët shqiptarë, Shemsiu braktisi frontin pa zbratur asnjë armë, dhe u kthye përsëri në Tiranë. Fashistët, të xhindosur, e ndoqën këmbë-këmbës, por tani ai nuk ishte i vetëm.

Në periudhën e parë, pas braktisjes së frontit italo-grek, me urdhër të partisë Shemsiu punoi në një dyqan qofterie, tek ish pazari i vjetër, që shërbente si qendër ndërlidhjeje. Ato ditë «qoftexhiu» i ri bëri shumë për strehimin e shokëve ilegalë, për lidhjen e tyre me qarkorin e partisë të Tiranës, sigurimin e armëve, municioneve dhe materialeve të tjera të nevojshme. Në këtë mënyrë, ai u tregua i denjë, për t'u futur në radhët e njësitit gueril të Tiranës, që drejtohej nga shokët Vojo Kushi e Beqir Balluku. Shemsiu ishte një nga pjesëtarët më aktivë të grupit. Gjatë aksioneve të ndryshme, siç ishte djegja e materialeve sportive fashiste në rrugën e Kavajës, ndarja e bereqetit të depos në fshatin Fikas, hapja e burgut të Tiranës, etj, dolën mjaft mirë në pah cilësitë e tij prej komunisti dhe luftëtari: trimëria, guximi, vetëmohimi dhe, mbi të gjitha, këmbëngulja, për të plotësuar, deri në fund, çdo detyrë që i ngarkonte partia.

Në prill të vitit 1943, bashkë me tre pjesëtarë të tjerë të njësitit, ai u ngarkua të kryente atentatin kundër spiunit me damkë, Jani Kristo, i cili rrinte zakonisht në kafe «Përmeti», në hyrje të rrugës së Dibrës. Shokët, që do të kryenin atentatin, kishin zënë vend pak më lart, kurse Shemsiu me Njazinë, përkundruall kafenesë. Me të dalë spi-

uni, ata do të jepnin sinjalin. Qëndruan aty një kohë të gjatë, me vështrimin e ngulur tek dera e kafenesë. Shemsiu u shqetësua. Lëvizte poshtë e lart me nervozizëm.

— More, pse nuk po del ky? U bë më shumë se një orë që po presim, — i tha ai shokut.

— Duket se e nuhat të kegen dhe do t'i shtojë vetes akoma disa minuta jetë, — ja ktheu Njaziu.

— S'di si të them. Nuk më pëlqen kjo pritje!

— Mos u mërzit. S'ka si na shpëton.

Por Jani Kristo ishte shumë dinak. Ai e dinte se ish zhytur gjer në grykë në llumin e tradhëtisë, se kishte shumë gjynahe për të paguar, ndaj e ruante lëkurën. Duke u zvarrisur, si gjarpëri, midis turmës së klientëve, që u grumbulluan, për një çast, në hyrje të kafenesë, ai mundi të dilte tinës, pa u vënë re. Shemsiu e dalloi me vonesë, kur e kish kaluar vendin e caktuar për atentat.

— Na e lagu, qeni! — tha dhe u sul përperjetë. Njaziu dhe dy shokët e tjerë e ndoqën pas në pikë të vrapit, pa përfillur rrezikun. Megjithatë, spiuni mundi të fshihej. Ai i shpëtoi, kështu, edhe për një kohë, hakmarrjes së popullit.

Sa keq u erdhi atëherë Shemsiut dhe shokëve të tij! Ata ishin shokë të ngushtë, për njëri-tjetrin nuk e kursenin as jetën, por ja, filluan të hahen me fjalë:

— Si nuk e dalluat në kohë? Ku i kishit sytë?

— Po, po, ne e patëm fajin! Por edhe juve ju kaloi afër!

— Si të raportojmë tani, nuk e përmbushëm detyrën?

— Për ideal, është turp, turp i madh!

Në këto e sipër, grupi arriti te sahati. Tamam

aty, atentatorët u takuan me sekretarin e qarkorit të partisë dhe me komandantin e njësitit gueril. Ata e morën me mend se aksioni nuk ishte kryer dhe u munduan t'i qetësonin, duke u thënë:

— Mirë do të qe, ta kishim qeruar atë farë të keqe! Por mos u shqetësoni, do ta fusim përsëri në shteg.

Ishte ditë e diel. Bulevardi i Tiranës qe mbushur plot. Shemsiu vërente njerëzit, që kalonin poshtë e lart, por dukej se nuk e kishte mendjen aty. Befas fytyra e tij u gjallërua.

— Shikoni! — tha ai.

Të gjithë kthyen kokën. Për karshi vinte komandanti i milicisë fashiste shqiptare, koloneli Ndok Gjeloshi, bashkë me gruan, me drejtorin e Institutit femëror të Tiranës dhe me të shoqen e tij. Disa metra më pas ecte një kapiten, me çizme llustrafin, me jakë të ngrirë e me një kamxhik në dorë. Ishte «trimi», roja personale e kolonelit fashist.

Dikush tha:

— Na erdhi derri në shteg.

— Këtij i vlen lëkura më shumë se Janit, — tha Shemsiu në mënyrë të prerë e të vendosur.

Koloneli afrohej gjithnjë më shumë. Ecte plot kapadaillek, duke vërejtur me mospërfillje rreth e qark. Ai as që e merrte me mend se i kishte ardhur ora e fundit, se përballë kishte Shemsium dhe shokët e tij, që prisnin si gjahtari në shteg, se çdo hap që hidhte, e afronte më shumë me vdekjen.

Shemsiu nuk ja ndante sytë dhe përpiqej të zgjidhte vendin më të përshtatshëm, për ta gjakosur për vdekje armikun dhe kështu të qëronte hesapet me njërin nga krerët e tradhëtarëve.

As sheshi para sahatit, as ai para bashkisë (sot

komiteti ekzekutiv) nuk qenë të përshtatshëm për atentatin. Bulevardi ishte mbushur plot me njerëz, me xhandarë dhe ushtarë të armikut. Duhej zgjedhur vendi më i volitshëm prej nga shokët mund të largoheshin, pa u rrezikuar, pas plotësimit të detyrës.

Koloneli ecte rëndë-rëndë midis dy damave elegante, fliste, rrudhte buzët dhe pastaj qeshte me të madhe.

— Shihni, shihni si përkulet gjer në tokë ai, kur më saluton! — i mburrej gruas, duke ngritur kokën lart e duke i dhënë trupit një pozë prej kapadaiu. — Ah, i njoh mirë unë këta! Gjysma në mos të gjithë, e kanë në zemër komunizmin. Por të shohin, po s'i shkova në plumb të gjithë, të gjithë...

— Ha-ha-ha! Të gjithë, ë? Ha-ha-ha! — qeshte dama hijerëndë.

Shemsiu ecte vetëm 4-5 hapa pas. Ai i dëgjon-te këto fjalë dhe ziente nga inati. «Mjaft lllomotiti ky fundërinë! Ç'ta lëmë më...?» — fliste me vete, duke mbledhur grushtet e duke shtrënguar fort dhëmbët.

— Do ta qëlloj unë! — tha Shemsiu.

— Prit, mos u ngut! — ja ktheu komandanti i njësitit. — Do të zbatojmë planin që u hartua kundër Janit. Do ta qëllojnë ata të dy, kurse ti me Njazinë do t'i mbronin nga çdo e papritur dhe do të siguronin largimin e tyre. Në rast nevojë, do të hapni zjarr, për të ç'orientuar fashistët, që mund të vihen në ndjekje.

Tek qoshja e maternitetit, koloneli fashist, bashkë me «suitën» mori të kthehej. Pikërisht këtë çast kishin pritur shokët. Ata nuk e kishin zakon të qëllonin pas shpine, prapa ferrës, por mu në strofkën

e ujkut, në mes të Tiranës, nën hundën e xhandar-mërisë, të kuesturës, pa përfillur gardhin e bajonetave armike.

Krismat ushtuan njëra pas tjetrës. Ndok Gjeloshi lëshoi një britmë të çjerrë dhe u rrëzua shakull në tokë. Shoqëruesit e tij, bashkë me «trimin», ja kri-sën vrapit. Në bulevard u bë një pështjellim i madh. Fashistët kërkonin vrimë, për të futur kokën, kurse njerëzit e thjeshtë bisedonin, të gëzuar me zë të ulët:

— I dëgjuat krismat? Komandanti i milicisë fashiste na i mori të keqen!

— U qërua edhe një ferrë. E prenë nga rrënjët.

— Ja shtypën kokën gjarpërit mu në mes të Tiranës.

— He, m'u lumtë dora komunistëve!

Në vendin ku u krye atentati, në një nga muret e jashtme të maternitetit të Tiranës, është varur një pllakë përkujtimore. Atje shkruhet: «Në prill të vitit 1943, njësitë gueril vrau këtu spiunin e regjur të fashizmit italian Ndok Gjeloshin». Sa herë që kalojnë andej, qytetarët e kryeqytetit kujtojnë me krenari ata njerëz të guximshëm, që ngritën shpatën e drejtësisë, dhe i dhanë dënimin e merituar njerit prej shërbëtorëve më besnikë të pushtuesve fashistë. Vetëm shumë pak njerëz e dinë se një nga pjesëmarrësit e aksionit ishte edhe atentatori i guximshëm i njësitit gueril të Tiranës, Shemsi Haka.

E ky nuk ishte as aksioni i parë e as i fundit për të. Disa muaj më parë në fund të vitit 1942, bashkë me 10 shokë të tjerë, ai u mori fashistëve nga duart 6 mitralozë kundërajrorë, të cilët ju derguan çetës së Pezës. Njësitë gueril, ku bënte pjesë Shemsiu, kreu njërin pas tjetrit aksione të guximshme në qendër të Tiranës dhe në periferi të saj, duke mbjellë

panik e çorganizim në radhët e armikut dhe gëzim e shpresë në popull.

Fshatarët e katundit Fikas të rrethit të Tiranës nuk do ta harrojnë kurrë atë natë dimri të vitit 1942-43. Duke mbledhur të 10-tat, fashistët i kishin marrë fakir fukarasë edhe kilen e fundit të bereqetit, kafshatën e gojës së fëmijëve, për të ushqyer ushtarët e Musolinit, që shtypnin e masakronin popullin. Qarkori i partisë u njoftua se, së shpejti, bereqeti i grumbulluar do të hiqej nga fshati. A duhej lejuar kjo? Jo, në asnjë mënyrë! Për këtë u vu menjëherë në veprim njësitë gueril.

Në një natë të ftohtë dimri, banorët e Fikazit u zgjuan nga gjumi, të alarmuar. Korrierët njoftonin derë më derë:

— Të gjithë në qendër të fshatit! Do të bëhet një mbledhje me rëndësi.

Fshatarët arritën te sheshi me një frymë dhe pyesnin njëri-tjetrin të habitur:

— Ç'asht kështu?

— Përse na kanë mbledh?

— Ç'ka ba vaki?

Atëhere, nga mesi i turmës, u ngrit një djalë i ri:

— Ne jemi anëtarë të Partisë Komuniste Shqiptare, që i ka caktuar detyrë vetes të ngrrejë popullin në luftë, për të çliruar vendin e për të marrë pushtetin në duart e tij.

Nën dritën e zbetë të hënës, që herë dukej e herë fshihej pas reve, dalloheshin siluetat e fshatarëve, që ishin ulur këmbëkryq e dëgjonin me kureshtie. Brenda disa minutave, ata mësuan se si zhvilloheshin ngjarjet në vendin tonë dhe në botën e jashtme.

— A më bajn veshët, apo me të vërtetë thonë

se kan me hap depon? — pyeste shokun një fshatar i moçëm, veshur keq, me trup të kërrusur nga pesha e rëndë e vjetëve.

— Ashtu po duket, — ja ktheu tjetri duke mbledhur supet. — Thonë se depua ashtë çelë. Jan ba llogaritë me e shpërnda bereqetin sipas frymëve.

— Punë e vështirë po më duket kjo!

— Xhandarët nuk janë veçse gjysmë orë larg. Kanë me ardhë nesër, pastaj na shtrojnë në dru e na e marrin përsëri bereqetin.

Shemsiu dëgjonte dhe vinte buzën në gaz.

— Mos u shqetësoni, shokë! — tha ai më në fund. — Asgjë s'ka për të ngjarë. Nuk ua mban xhandarëve të venë dorë mbi ju. Ky është bereqeti juaj dhe askush nuk do të guxojë t'jua marrë. Komunistët do t'i keni gjithmonë pranë, në ditë të mira e të këqija.

Kështu, Shemsiu e tregoi veten edhe si një agjikator e propagandist i zoti, që çonte në popull zërin e partisë, fjalën e saj jetëdhënëse.

Për aktivitetin e vet revolucionar, ai ra shpejt në sy të fashistëve. Me urdhërin e partisë, doli partizan, në fillim në çetën e Dajtit, pastaj në Brigadën e 3-të sulmuese, ku ju besua detyra e komandantit të kompanisë. Ai kishte përvojë të pasur në punët ilegale, ndaj hynte e dilte shpesh në kryeqytet. Kjo ish një detyrë shumë e vështirë. Duhej kaluar nën hundën e armikut, që i kishte mbushur me spiunë të gjitha qoshet e rrugëve. Por Shemsiut nuk ja bënte syri tërt. Ai ecte me kokën lart, u kalonte në krah fashistëve, jo si fantazmë, por plot kurajë, gjakftohtë e i vendosur. I veshur me rroba fshatari, ai i kryente me fanatizëm detyrat e vështira, që i ngarkoheshin, që nga transportimi i armëve dhe mate-

rialeve propagandistike, deri te grumbullimi i të dhë-
nave mbi armikun, para kryerjes së aksioneve.

Me një mision të tillë hyri në Tiranë edhe në një ditë shkurti të vitit 1944, në kohën e reaksionit më të egër fashist. Ishte detyra e vetme që nuk mundi ta plotësonte. Në kryqëzimin e rrugës së Dibrës me rrugën e Barrikadave, atë e njohën fashistët, e arrestuan në befasi dhe e çuan në xhandarmërinë e Xhelal Staraveckës. Në fillim xhelatët provuan ta shtinin në dorë me lajka, me fjalë të mira, urtë e butë, por nuk ja arritën qëllimit, pastaj u sulën me egërsi mbi të.

— Folë, komunist i ndyrë! — çirrej xhelati.

— Komunistët nuk janë të ndyrë. Ata janë shpresa, gëzimi e ardhmja e Shqipërisë, — ja kthente gjakftohtë Shemsiu.

— Të shitur, spiunë të Moskës!

— Jo, ne nuk jemi të shitur, aq më pak spiunë. Ju ja shitët atdheun fashizmit për një pjatë makarona. Por ne do t'i shporrim ata, do t'i fshijmë nga faqja e dheut, bashkë me ju.

— Trego shokët, se do të ta rjepim lëkurën fije-fije! — ju kanos xhelati dhe e qëlloi me grusht fytyrës me tërë fuqinë e krahut. Shemsiu, i lodhur e i rraskapitur, nuk e mbajti dot ekuilibrin. U përplas për muri dhe u rrëzua.

— Trego shokët!

Ai u kap pas parmakut të dritares dhe u ngrit në këmbë. Hodhi sytë nga dritarja dhe foli me ton të qetë:

— Për cilin të flas më parë? Janë shumë.

— Trego!

— Ja, bulevardi është plot. Të gjithë komunistë janë. I tërë populli me ne është, — pastaj hodhi sytë

nga mali. — Ja Dajti. Shokët e mi janë atje. Sa lisa, aq partizanë ka...

Fashistët u tërbuan nga zemërimi. Mbi trupin e tij ata provuan torturat më të tmerrshme, që nga vezët e ngrohta nën sqetulla e rrahja me thupër hekuri, deri te vënja e korentit në pjesët delikate të trupit. Por nuk nxorën asnjë fjalë, asnjë të dhënë. Shemsiu qëndroi si burrë dhe vdiq ashtu siç i ka hije komunistit. Ai u nda nga gjiri i partisë, që e rriti dhe e kaliti në beteja, por kujtimi i tij rron dhe do të rrojë gjithmonë.

TRIM MBI TRIMAT

Maj i vitit 1943.

Nëna habitej kur i tregoja se Tafili ishte trim mbi trimat.

Dhe vërtet, në dukje, s'ta linte atë përshtypje. Embëlsia feminare e fytyrës së tij, ajo buzëqeshje që gjithmonë i qëndronte mbi buzë, ata sy që me aq dliresi të shikonin si me ndrojtje e me turp, ajo skuqja si e ndonjë vajze të mbyllur, që ja mbulonte shpesh fytyrën, të bënë të kujtoje se ai djalosh nuk ishte nga ata të mejdaneve të luftës.

Por ja, katër veta, të veshur me uniformën ushtarake të armikut, kanë hyrë në qytetin e Beratit, për të qeruar Mukinin, drejtorin e «Banka di Napoli», në të vërtetë shefin gjakësor të Simit. Në krye të kësaj katërsheje qëndron vetë komandanti i Çetës së Kuçovës.

Dhe ja në mes të ditës, në zyrat e «Banka di Napolit» kërcet revolveri. Përpara se sinjor Mukini t'i lerë shëndenë Italisë dhe fashizmit, Tafili i thotë: Në emër të të vrarëve dhe të internuarve tanë, në emër të atyre që po dergjen e po torturohen nëpër qelitë, në emër të... na...!

Në çast grupi i të katërve del nga «Banka di

Napoli» dhe merr tatëpjetë në drejtim të rrjedhës së Osunit. Po tërheqja e tyre është tepër e vështirë. Në të majtë është lumi kurse në të djathtë shkëmbajtë thikë të kalasë. Në mes, është një rrugë e ngushtë ku duhet të kalojnë, të ndjekur nga forcat dhe plumbat e karabinierisë, milicisë dhe kuesturës së armikut.

Dhe tërheqja vazhdon. Komandanti e Tafili plagosen rëndë. Po ndërsa të parin e ka marrë plumbi më lehtë, të dytit ja ka thyer kockat e këmbëve. Ai s'mund të eci më, më tej dhe kështu shkëputet nga shokët. Në çast rrethohet nga armiqtë.

Tafil Skëndua i shtrirë para godinës së centralit elektrik të qytetit, as njëqind metra larg armiqve zvarritet buzë një kubeje dhe, duke nxjerrë «beretën» e tij, fillon të qëllojë. Një karabinier përmbysët në krye të tatëpjetës që zbret për në central. Tani as tridhjetë metra nuk e ndajnë. Duke e parë në atë gjendje, një marshall i karabinierisë jep urdhër të mos vritet, po të kapet me çdo kusht i gjallë.

Po Tafil Skëndua, pasi i përdor të dy karikatorët e «beretës» së tij, fishekun e fundit e ruan për vete.

Dhe ja, gryka e revolverit, e mbështetur nën gushë nxjerr zjarr. Tafili bie. Nga koka i buçiti gjaku. Sytë menjëherë mbyllen, po zemra e tij akoma nuk i ka ndaluar rrahjet e saj. Ajo do të rrahi edhe disa ditë për t'u treguar armiqve se, as në atë gjendje, i huaji s'mund ta mposhtë dot.

Një shok, që e kishin arrestuar po atë ditë, si e rrahën në karabinieri, e çuan në spitalin ushtarak në Uznovë.

Pa, na trego, — i tha marshall Martini, — kush është ky?

Shokut i theri në zemër kur e pa ashtu të gja-
kosur, por nuk dha asnjë shenjë, sepse aty për aty
e kuptoi që fashistët nuk e kishin njohur.

— Thuana, — vijoi përsëri marshalli, — kush
është ky?

— Po ç't'ju them. Unë s'e kam parë kurrë këtë
njeri, — ju përgjegj marshallit.

Po, duke përfitur nga rasti që marshalli i kishte
kthyer krahët, Tafili, duke shtërnguar dhëmbët e
duke vënë gishtin në gojë ja bëri me shenjë, që të
mos tregonte asgjë.

Dhe shoku heshti, sado që marshall Martini aty
dhe më vonë e torturoi.

Pas një jave Tafil Skëndua, duke mos pranuar
as ushqimet e tyre vdiq.

Ai mbeti mister për ta, po për partinë, për sho-
kët flamur qëndrese në atë tufan.

KUJTIME NGA LUFTA E MEZHGORANIT

Më 29 qershor të vitit 1943, çeta partizane «Hajredin Tremishti» u grumbullua në Kuç dhe në mbrëmje u nis, për t'u shkuar në ndihmë çetave partizane, që luftonin me forcat italiane në Mallakastrën e Sipërme dhe në Mezhgoran, në Grykën e Këlcyrës.

Natën e 29 qershorit, çeta, duke kaluar nëpër Shurin e Kuçit, del në Kurvelesh të Sipërm dhe drejtohet për në Salari. Dëgjohet që gjëmon gryka e lumit Vjosa nga krismat e pandërprera të armëve.

Në mëngjezin e 30 qershorit, çeta arrin në Salari. Aty qëndron edhe shtabi i çetës, i cili urdhëron një skuadër të kalojë lumin e Vjosës dhe të marrë kontakt me çetën e Mallakastrës.

Skuadra, pasi kalon lumin dhe, pasi merr kontakt me çetën partizane, njihet me situatën e luftimeve, që zhvillohen, me sukseset e partizanëve dhe me humbjet e fashistëve dhe kthehet përsëri. Shtabi i çetës vendosi t'u shkojë menjëherë në ndihmë shoqëve, që luftonin në Mezhgoran, por duhej gjetur rruga dhe mundësia, për të mbërritur shpejt. Nga Tepelena nuk mund të shkohej, sepse aty ishte përqëndruar ushtri italiane. Urat e Leklit dhe të Dragotit dhe të gjitha rrugët ishin zënë nga italianët. U muar shpejt vendimi që të kalohej Vjosa dhe të

dilej në mal të Trebeshinës. Gjatë gjithë ditës, çeta kalon fshat më fshat me këngë në gojë, ashtu siç e kishin zakon partizanët.

Marshimi vazhdon. Luftimi dëgjohet gjithnjë e më afër. Me sa duket, luftohet prapa malit të Shendëllisë, në Mezhgoran.

Nga mesi i natës, çeta del në majën e Trebeshinës.

Jepet urdhëri që çeta të pushojë aty deri në mëngjez, prandaj partizanët me skuadra strehohen nëpër llogoret e bëra gjatë luftës italo-greke, në faqen e kundërt të fshatit Mezhgoran.

Mëngjezi i datës 2 korrik 1943 është i paharruar për partizanët e çetës sonë. Nga maja e malit, duket një bukuri e rrallë e atyre vendeve.

Atë kohë u mblodh shtabi i çetës dhe përpunoi planin e sulmit. U vendos që sulmi të bëhej në dy drejtime: drejtimi kryesor do të ishte përballë forcave fashiste nga fshati dhe drejtimi i dytë, në krahun e djathtë të kurrizit të malit. Kjo do të bëhej me qëllim që të mos lejoheshin italianët të merrnin krahun e djathtë dhe në rast se vinin forca nga Dragoti në drejtim të malit për të marrë krahët, të ndaloreshin. Në drejtimin kryesor, përballonte sulmin e fashistëve, një pjesë e çetës «Koto Hoxhi», me fshatarët e Mezhgoranit, kurse pjesa tjetër luftonte në krahun e majtë.

Shtabi, pasi mori vendimin për sulm, urdhëroi të mblidhej çeta, për t'i komunikuar vendimin dhe për të sqaruar situatën. Ndërkaq, fashistët u hodhën në sulm. Kështu që nuk duhej humbur kohë, sepse fashistët filluan të përparonin.

Atëhere, komisari i çetës Asim Zeneli tha:

— Shokë, nuk kemi kohë për mbledhje të gjatë.

Ju e shikoni se italianët u hodhën në sulm. Shokët tanë kanë ditë të tëra që po luftojnë me trimëri dhe heroizëm. Ne vetë kemi ardhur t'i ndihmojmë për shpartallimin e këtyre breshkaxhinjve, që na kanë zënë vendin dhe duan të na djegin fshatrat tona e të na bëjnë robër. Ne tashti do të kundërsulmojmë. Çdo partizan e di detyrën e tij dhe përgjegjësinë që mban para popullit. Këtë gjë ne duhet ta zbatojmë deri në fund, ashtu si na mëson Partia Komuniste! Kundërsulmin do ta fillojmë me sinjalin që do të jepet me bori. Nisemi shokë, sipas ndarjes së bërë! Vdekje Fashizmit!

Ne u përgjegjëm të gjithë njëzëri: Liri Popullit! Atë çast, gjëmoi gryka e Mezhgoranit. Pastaj u nisëm. Komisari ecte në krye të partizanëve me belxhikun në dorë. Ai hidhej gur më gur, i shkathët dhe energjik, i qeshur dhe guximtar. Ai printe për në sulm dhe vazhdimisht thoshte: «Më shpejt, shokë!».

Italianët ishin hedhur në sulm dhe, nga pozicionet që mbanin më parë, në anën e përtejme të një përroi të vogël, kaluan dhe filluan t'u ngjiten arave me misër për të thyer andej partizanët që kishin zënë vend në krye të arave, në një lëndinë dhe që shtinin pa pushim mbi ta.

Pasi një pjesë e çetës zbriti faqen e malit dhe kaloi shtëpinë e fundit të fshatit, komisari ndaloi, shikoi nga pjesa tjetër e çetës që përparonte gjatë kurrizit të malit, u kthye dhe tha: «Skuadra e katërt, në të majtë dhe e treta, në të djathtë!» Pastaj shtoi: «Ti Sokol, — i tha mitralierit, — mitralozin do ta vendosësh tek ai guri i madh dhe do të mbulosh kundërsulmin e shokëve!»

Në këtë kohë në xhadenë që vinte nga Këlcyra

dëgjohej një zhurmë. Nuk vonoi e u duk tanksi italian, në krye të disa maqinave, të ngarkuara me ushtarë, që vinin për ndihmë. Nuk kaloi shumë dhe u dëgjua një buçitje në rrugë, u ngrit një tym dhe, për disa sekonda, nuk u pa asgjë. Tanksi kishte rënë në minat e vendosura gjatë natës nga partizanët e Çetës «Koto Hoxhi». Maqinat ndaluan për një çast dhe pasi bënë një kthesë të vogël, kaluan përpara, por nuk vonoi dhe maqina e parë, ra në mina dhe mori flakë. U dëgjuan britmat e italianëve të tmerruar. Komisari dha sinjalin e kundërsulmit. Buçiti buria dhe filloi një zjarr i dendur nga të gjitha anët. Zëri i komisarit thërriste: «Përpara, shokë!» Ky zë pasohet nga të gjithë partizanët: «Përpara, partizanë!» Mitralozi i Sokolit villote zjarr mbi fashistët. Ata nuk e prisnin këtë sulm të rrufeshëm dhe, të tmerruar, zunë të tërhiqen në panik, për të zënë pozicionet, që kishin para sulmit.

Komisari, në krye të shokëve, po sulmonte me shpejtësi, duke shtënë me belxhikun e tij. Përkrah komisarit, sulmonte edhe partizani 16 vjeçar, Samiu. Ai tregon se si komisarit kapërceu arën e parë dhe të dytën me misër dhe u gjend në buzë të përroit. Mbi një mur të veshur me kulpra, ai filloi të shtinte mbi italianët që dilnin nga përroi dhe kalonin një shteg për në pozicion.

Tek luftonte, ai u foli italianëve që ishin në përrua, për t'u dorëzuar. Kur e pa që ata nuk po dorëzoheshin, hoqi nga mesi dy bomba dhe i hodhi mbi ta. Në këtë kohë i thotë Samiut: «Qëlloni në atë shtegun atje, se në atë vend do të dalin!». Ndërkaq, drejt shtegut vrapuan 4-5 italianë. Komisarit mori nishan dhe qëlloi të parin, i cili ra kryq në shteg, të tjerët donin të kalonin mbi të, që të shpë-

tonin kokën, por komisarit shtiu dhe një fashist, duke bërëtitur, ra mbi të parin. Në këtë kohë, një mitraloz italian në befasi hap zjarr nga krahu i djathtë i pozicioneve partizane. Një plumb e goditi në ballë komisarit trim të çetës. Samiu që ishte afër fare, e pa që ra dhe i foli, por nuk mori asnjë përgjegje. Pastaj u afrua edhe më, i foli dy-tre herë po komisarit nuk mund të fliste. Ai shikonte në drejtim të armikut. Atëherë Samiu u ngrit dhe thirri Petritin, komandantin e skuadrës, që ishte disa metra prapa. Petriti erdhi shpejt dhe kur e pa komisarit të shtrirë, i foli: «Asim!» Por Asimi shikoi me sy dhe i dha të kuptojë se nuk mund të fliste dot. Atëherë Petriti me Samiun e kapën të dy me kujdes dhe e futën në misër në një vend me hije. Filluan ta mjekojnë, por panë se plaga ishte për vdekje.

Vrasja e komisarit, u ra si bombë partizanëve, por nuk i dekurajoi. Ata u hodhën në sulm, për t'i marrë hakun. Lufta vazhdoi deri në pasdrekën e 2 korrikut, me shpartallimin e plotë të italianëve.

Në këtë përpjekje ngelën të vrarë e të plagosur rreth 50 fashistë, u dëmtua një tank, u zunë tri maqina dhe një sasi armatimi. Pas dite, të hidhëruar dhe me lot në sy, u mblodhën në Mezhegoran partizanët e çetave «Hajredin Tremishti», «Koto Hoxhi» dhe fshatarët e Mezhegoranit. Në varrimin e tij ata u betuan se do të luftonin deri në pikën e fundit të gjakut për çlirimin e atdheut, ashtu siç i mësonte Partia Komuniste.

LUFTA E REÇIT

Lufta e Reçit është një ndër episodet e Luftës legjendare nacionalçlirimtare. Shoku Mehmet Shehu ka thënë: «Lufta e Reçit u bë nxitje e madhe për t'i dhënë hov Luftës nacionalçlirimtare aso kohe në të gjithë Shqipërinë e Veriut dhe jehona e saj mbërriti në të gjitha skajet e Shqipërisë».

Kjo luftë u zhvillua në prakun e kapitullimit të Italisë fashiste, kur në qarkun e Shkodrës posa ishte formuar batalioni partizan «Perlat Rexhepi», i cili mbante të çliruar një zonë relativisht të gjerë përreth qytetit të Shkodrës.

Ekzistenca e kësaj force partizane, fare pranë qytetit të Shkodrës në këto rrethana, përbënte një kërcënim të drejtpërdrejtë për pushtonjësit, sidomos për tradhëtarët, që e ndienin se kapitullimi i Italisë fashiste nuk ishte i largët. Prandaj, për t'ju shmangur këtij rreziku, fashistët italianë, në bashkëpunim dhe të nxitur nga tradhëtarët, organizuan një operacion të gjerë me qëllim që të likuidonin forcat partizane dhe kështu të pengonin çlirimin e qytetit. Për t'ja arritur këtij qëllimi, fashistët italianë grumbulluan pothuajse të gjitha forcat që kishin në Shkodër: dy skuadronë kavalerie, dy kompani karabiniere, dy kompani milicësh dhe forcat e disa post-

bloqeve, gjithsejt më shumë se 1150 vetë. Operacionin e këtyre forcave tokësore do ta mbështeste edhe aviacioni i përqëndruar në aerodromin e Shkodrës.

Përveç kësaj, reaksionarët, kombinuan planet me fashistët në një mbledhje që u bë nën drejtimin e majorit fashist, Xhelozo. Në këtë mbledhje u vendos që, menjëherë, pasi të fillonin operacionin trupat italiane, të hidheshin në luftë bashibozukët, të ashtuquajturit «vullnetarë» të Malësisë së Madhe dhe të Dukagjinit, nën komandën e Llesh Marashit.

Nga plani i operacionit, që ju kap një oficeri të vrarë, doli se fashistët italianë kishin planifikuar që, për tri ditë, të likuidonin të gjitha forcat partizane, të pushkatonin disa fshatarë, të digjnin disa shtëpi, të internonin rreth 20 familje. Për caktimin konkretisht të masave represive, do të mbahej lidhje me priftin e Shkrelit, Dom Nikoll Gazullin dhe kryetarin e komunes Nikoll Dedën.

Në këtë kohë Batalioni «Perlat Rexhepi» përbëhej prej tri çetash partizane, të cilat së bashku kishin një efektiv prej 90-100 vetësh. Komanda e batalionit kishte të dhëna që armiqtë po përgatiteshin për një operacion, por kohën dhe vendin e këtij operacioni nuk e dinte. Çetat partizane u shpërndanë në ato drejtime nga mund të pritej sulmi i armikut: njëra u vendos në Reç, tjetra në Grizhje, e treta në Postribë, në gatishmëri secila prej tyre të thyente sulmin e fashistëve ose të shkonte në ndihmë të çetave të tjera.

Gjatë natës së 30-31 gushtit, forcat italiane, të ngarkuara nëpër maqina, dolën nga qyteti i Shkodrës për në drejtim të Reçit. Në orën 5 të mëngjezit të datës 31 gusht, këto forca, pasi arritën në rajo-

nin e Reçit, zbritën nga maqinat dhe u ndanë në dy kolona. Njëra kolonë mori drejtimin e fushës së Reçit, kurse tjetra bëri një manovër të gjerë, për t'i dalë Reçit nga veri-lindja.

Çeta e Reçit, me përjashtim të rojeve ishte shpërndarë nëpër baza dhe ndodhej në gjumë. Ardhja e forcave të armikut nuk i shpëtoi syrit vigjilent të rojes partizane, e cila menjëherë dha alarmin. Partizanët si rrufe dolën nga shtëpitë dhe, pasi morën detyrat, shkuan përpara, duke zënë pozicione të përshatshme për luftë. Forcat kryesore të çetës u vendosën në mbrojtje në fushën e Reçit, kurse një pjesë e vogël kapi Qafën e Zhabadrit dhe të Pustares, për të mos lejuar krah marrjen e Reçit nga veri-lindja.

Italianët nuk zbuluan daljen e partizanëve dhe zënjen e mbrojtjes nga ana e tyre. Ata vazhduan përparimin me masa të dobëta zbulimi. Partizanët kishin marrë urdhër të mos qëllonin, por t'i linin fashistët të afroreshin sa më afër. Kur këta u ndodhën në një distancë 50-100 m. nga pozicionet e partizanëve, u dha komanda «zjarr» dhe nga plumbat e parë të partizanëve gjetën vdekjen disa fashistë. Kjo ndodhi rreth orës 7.30 në fushën e Reçit. Italianët, të gjetur në befasi, u tronditën dhe duke lënë përdhe një numër të vlarësh dhe të plagosurish u tërhoqën në mënyrë të çrregullt deri te Suka e Kuçit, ku u vendosën në mbrojtje.

Nga mesi i ditës arriti në Reç nga Grizhja çeta e dytë. Ndërkaq radhët e luftëtarëve po shtoheshin me forca vullnetare nga fshati. Menjëherë çeta e Grizhjes u hodh në kundërsulm në drejtim të fushës së Reçit, dhe në bashkëveprim me forcat e çetës së parë, që mbroheshin, i morën armikut Sukën e

Kuçit, e thyen atë me humbje të ndjeshme dhe spastruan krejt fushën e Reçit.

Mirëpo kolona armike që kryente manovrën prapa vargut të maleve në veri të Reçit, nga ora 9.00 doli në Qafën e Zhabdrit dhe në atë të Fushtarës, ku forcat partizane ishin shumë të pakta.

Partizanët luftuan trimërisht, nuk u sprapsën, thyen sulmin e armikut përballë. Vetëm kur armiqtë e shumtë filluan t'u dilnin nga krahët dhe në shpinë, partizanët filluan tërheqjen, duke bërë qëndresë në çdo shkëmb dhe breg. Forcat fashiste, shumë herë më superiore në numër dhe në armatime, të mbështetura nga aviacioni, pasi morën Qafën e Zhabdrit dhe të Pustares, zbritën në lagjen Aliaj, ku dogjën 5-6 shtëpi. Në këtë situatë komanda e batalionit vendosi t'i tërhiqte forcat, që ndodheshin në fushën e Reçit, t'i nxirrte në drejtimin ku armiku kishte sukses, nga Brinja e Bardhë, dhe, pasi të ndalohej përparimi i mëtejshëm i tij, të kalonte në kundërsulm, për spastrimin e krahinës së Reçit nga fashistët.

Në orën 19.00, armiku u ndal në lagjen Aliaj dhe kaloi në mbrojtje, derisa të vinin forcat e tjera.

Gjatë natës së 31 gushtit, italianët sollën forca të freskëta nga Shkodra dhe kryen manovrën me nënrepartet e tërhequra nga fusha e Reçit, duke i hëdhur nga Qafa e Zhabdrit për në lagjen Aliaj. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm bashibozukësh, nën komandën e Llesh Marashit, kishin zbritur në fushën e Posta-Pojës, ngjitur me Reçin dhe po viheshin në gatishmëri, për të kaluar në mësymje. Në mëngjezin e datës 1 shtator situata u ndërlikua për armikun. Forcat balliste me Jup Kazazin në krye, që erdhën në mbrëmjen e datës 31 gusht,

«për të ndarë frytet e fitores», kur morën vesh se situata ishte krejt ndryshe, pa u futur fare në luftë, u tërhoqën.

Komanda e batalionit duke përfituar nga kjo situatë, vendosi që në mëngjezin e 1 shtatorit të kalonte në kundërsulm me të gjitha forcat, duke kombinuar goditjen përballë me goditjen nga shpina. Për këtë qëllim që gjatë natës u dërgua në shpinë të armikut një njësit, nën komandën e Bejto Faslisë, me detyrë që sapo të zbardhte drita ta godiste armikun nga shpina. Njësi kreu manovër të gjerë, dhe i doli armikut në shpinë.

Me të dalë të dritës sulmin e filloi njësi kra-hëmarrës, duke e goditur në befasi armikun në shpinë. Menjëherë pas kësaj u hodhën në kundërsulm edhe forcat e tjera përballë. U krijua një situatë e papritur për armikun. Në kohën kur po bëhej gati për të vazhduar mësymjen, për t'u dhënë grushtin vendimtar forcave partizane, ai u sulmua përballë dhe nga shpina.

Kjo gjë e çorientoi dhe futi panik të madh në radhët e armikut. Ai pa çmuar fare sasinë e forcave tona, duke menduar se po mbetej në rrethim, filloi menjëherë tërheqjen. Tërheqja u bë e paorganizuar, pa masa sigurimi. Kjo u dha mundësi forcave tona që të kalonin në ndjekje dhe t'i shkaktonin dëme të mëdha armikut. Në këtë kohë krerët e bashibozukëve, që ishin bërë gati këtë ditë të futnin forcat në luftim për asgjësimin e «mbeturinave të partizanëve», kur panë ushtrinë fashiste që po tërhoqej e shpartalluar, hoqën dorë nga sulmi dhe i shpërndanë bashibozukët.

Forcat italiane, duke lënë në fushën e luftimit dhjetëra të vrarë, pasi u tërhoqën nga rajoni i Reçit, u kthyen me turp në Shkodër.

Faktorët kryesorë që përcaktuan suksesin e këtij luftimi genë:

1. Shembulli personal në luftim i anëtarëve të partisë.
2. Lidhjet e ngushta të partizanëve me popullin, i cili luftoi përkrah partizanëve.
3. Patriotizmi i lartë i partizanëve, që buronte nga natyra e luftës së drejtë çlirimtare, vendosmëria për të luftuar me guxim me një armik që kishte epërsi të pakrahasueshme në teknikë dhe në njerëz.
4. Manovra e guximshme krahëmarrëse, goditja që ju bë armikut në shpinë, ndonëse me forca të pakta, dhe ndjekja e vendosur e armikut që tërhiqej.

E FUNDIT NË TËRHEQJE

Aty nga 28 qershori i vitit 1943, në fshatin Barmash u mblohdën njësitet e vullnetarëve të Kolonjës, Panaritit, Skraparit dhe partizanëve të Batalionit «Tomorri». Ata do të merrnin pjesë në një aksion të rëndësishëm, për të ndaluar çdo orvajtje të armikut nga Korça dhe Erseka, për t'i shkuar në ndihmë garnizonit fashist të Përmetit.

Sipas planit të shtabit udhëheqës të këtij aksioni, forcat u vendosën në krahun e djathtë të rrugës automobilistike dhe në ballë të saj, me detyrë që të ndalonin çdo orvajtje të armikut, për të marshuar në drejtim të Leskovikut dhe për ta asgjësuar atë mbi grykën e lumit. Pas daljes së forcave, të gjithë filluan përgatitjet e pozicioneve, duke shfrytëzuar gurët si mjete mbrojtëse. Në vargun e pozicioneve, ku qëndronin partizanët, binte në sy një pozicion i ndërtuar me kujdes. Ishte pozicioni i një vajze partizane, që e quanin Vera. Ajo e ndjente veten të gëzuar, se do të merrte pjesë në një aksion të rëndësishëm. Pozicioni ndërpriste rrugën automobilistike në afërsinë e një ure të vogël, që ishte prishur nga partizanët. Me ardhjen e pararojës armike në këtë urë, do të hapej zjarr që do të ishte dhe sinjali i fillimit të luftimeve. NË

këto pozicione, partizanët ndenjën të maskuar, duke pritur dhe vigjiluar, rreth 10 ditë. Çdo ditë mbi pozicionet tona, vinin vazhdimisht aeroplanë armiq, për zbulim dhe herë pas here mitralonin. Spiunët e Ballit lëviznin poshtë e përpjetë, po ne nuk lëviznim dhe kjo bëri që forcat tona të mos zbuloheshin nga armiku.

Pas 10 ditësh në mëngjezin e 6 korrikut, rreth orës 9.00, u dëgjuan tri të shtëna pushke. Ky ishte sinjali që njoftonte për afrimin e kolonës armike në fshatin Barmash.

Kur u dëgjua sinjali, të gjithë partizanët dhe Vera u vunë në gatishmëri dhe prisnin nga çasti në çast të godisnin armikun. Dhe ja, u dukën motoçikletat, që lëviznin në pararojë, por jo me ushtarët e Duçes me pupla në helmetat e rrumbullakta, por me ushtarë që kishin në ballë të helmetave një kryq të zi, të thyer. Këta ishin armiq të panjohur gjer atëhere. Motoçikletat ju afruan urës që ishte e prishur, ngadalësuan shpejtësinë dhe deshën të ktheheshin prapa, por në këtë çast filloi zjarri i fuqishëm dhe breshëria e plumbave i rrëzoi përdhe. Me këtë breshëri pushkësh u bashkua edhe krisma e pushkës së Verës që, sytrembur shtinte mbi ta. Pararoja u asgjësua. Kjo ishte goditja e parë që i bëhej armikut të ri që shkelte tokën shqiptare, nazizmit gjerman. Lufta u ndez edhe më e ashpër, kur u duk kolona gjermane. Zjarri i fuqishëm i të gjitha forcave e gozhdoi në vend kolonën armike. Ushtarët e armikut të hutuar u shpërndanë në të dyja anët e rrugës, u shtrinë nën maqina dhe filluan të shtinin kot, në drejtime të ndryshme. Artileria e armikut, që u vendos menjëherë në veri të Barmashit, hapi zjarr të dendur, duke e përqëndruar në drejtim të pozicio-

neve, ku ndodhej dhe Vera. Ajo qëndronte e patundur në pozicion dhe, duke luftuar me guxim, i detyronte nazistët të mos lëviznin përpara. Pas një orë luftimesh, për të bërë presion dhe për të hapur rrugën përpara, armiku solli edhe një autobлиндë që filloi të qëllonte po në atë drejtim, ku ndodhej pozicioni i partizanes. Por kur autobлиндën u afrua rreth 30-40 metra pranë pozicioneve tona, u hodh në erë nga një minë e vendosur me kujdes në rrugë nga partizanët. Autobлиндën e shkatërruar u rrokullis në përrua. Zjarri i artilerisë rrihte vazhdimisht pozicionet. Ajo e shtoi zjarrin, duke hedhur pa kursim qindra predha topi dhe mortaje që bënë pyllin të ndizet flakë. Për t'u shmangur zjarrit të artilerisë dhe flakës që digjte pyllin, forcat, që ishin në sektorin ku ndodhej dhe Vera, muarën urdhër të kalonin në pozicione më të përshtatshme, duke u afruar më tepër nga ana e armikut, dhe të mbështetnin me zjarr tërheqjen e forcave që ishin në krahun e djathtë të rrugës. Lufta vazhdoi deri në mbrëmje. Armiku megjithëse i shumtë në numër, nuk mundi të kalonte në drejtim të Leskovikut. Duke shfrytëzuar errësirën, partizanët, pasi vranë rreth 100 gjermanë, u tërhoqën në drejtim të fshatit Kamnikë, vend që ishte caktuar, për t'u grumbulluar pas luftimit.

E fundit që erdhi në vendin e grumbullimit ishte Vera. Dhe kjo ndodhi, jo se ajo nuk ishte e shpejtë, por sepse nuk donte ta linte pozicionin. Po të mos qe detyruar të tërhiqej nga shokët që kishte në krahë, ajo do të luftonte e vetme, deri sa t'i rridhte dhe pika e fundit e gjakut.

GODITJE E BEFASISHME, SUKSES I PLOTË

Fashistët gjermanë, që kur shkelën në tokën tonë për të zëvendësuar fashistët italianë, e ndjenë urrejtjen e thellë të popullit shqiptar nga grushtet që u dhanë partizanët në Barmash e gjetkë. Episodi që po tregoj bën fjalë për një goditje të rrufeshme që i dha një autokolone të okupatorëve nazistë një pjesë e Brigadës së parë sulmuese, pak kohë pasi fashistët gjermanë kishin shkelur tokën tonë.

Para nisjes për aksionin që do kryhej dhe mënyrën e lëvizjes: të ecej me shpejtësi dhe pa u ndjerë, të veprohej shpejtë, të bëhej maskimi i plotë, të tregohet guxim dhe zgjuarësi në sulm.

Mesnata sapo kish kaluar, kur kolona partizane filloi të lëvizte me shpejtësi në drejtim të xhadesë automobilistike Peqin-Elbasan ku do të zihej prita.

Lumi i Shkumbinit u kalua në disa pika dhe me shpejtësi kompanitë zunë pozicionet në bregun e djathtë të lumit mbi xhade. Dy nga kompanitë u vendosën në krahët e pritës, me qëllim që të siguronin batalionin e tretë, të kryente me sukses aksionin pa u shqetësuar nga krahët. Kurse artileria e brigadës, që do të mbështeste këtë aksion, u vendos në pozicione zjarri në kodrat në bregun e majtë të lumit.

Dielli kishte kohë që ishte ngritur lart në horizont, por autokolona armike, që pritej të vinte, nuk po dukej akoma. Me gjithë lodhjen, askush nuk flinte në pozicionin që kish zënë, askush nuk lëvizte. Mendja e të gjithëve ishte përqëndruar atje larg, ku dukej kthesa e xhadesë, nga ku priteshin orë e çast të dukeshin maqinat.

Më në fund partizanët, që ishin në krye të pritës e pastaj me radhë gjithë të tjerët, dëgjuan zhurmën e motorëve të një autokolone dhe maqinat filluan të dilnin njëra pas tjetrës te kthesa. Ishin 25 maqina.

Ishin çaste emocionesh. Partizanët prisnin me padurim, që të dëgjonin krismën e parë të pushkës së komandantit, e cila do të ishte sinjali i fillimit të luftimit. Zemrat e partizanëve zienin nga një dëshirë e vetme: të përlesheshin sa më parë me armiqtë. Për një pjesë shokësh ishte hera e parë që i përpiqnin armët me nazistët gjermanë.

... Një krismë çau ajrin dhe pastaj një breshëri zjarri u derdh mbi autokolonën armike. Disa nga maqinat mbetën në vend, kurse disa u rrokullisën në hendek. Shumë gjermanë u vranë, por një pjesë mundën të hidhen nga maqinat në anën tjetër të xhadesë dhe filluan t'i përgjegjen zjarrit tonë.

Komandanti i batalionit të tretë, i cili kish qëndruar me skuadrën sulmuese të automatiksave jo më shumë se 30 m. larg xhadesë, u hodh i pari në këmbë dhe thirri: «Në sulm, para partizanë!» Pas tij u hodh në sulm me shpejtësi e gjithë skuadra, i gjithë batalioni. Një fashist i fshehur pas ledhit drejton automatikun nga skuadra që po zbriste në rrugën automobilistike, por syri i mprehtë i një partizani e dikton dhe thërret: «Kujdes shokë, një

gjerman tek ledhi!» Të gjithë si një trup u hodhën pas grumbujve të çakejve anës xhadesë. Ndërkaq një breshëri plumbash fishkëlleu mbi kokat tona, por pas kësaj gjashtë breshëri e një krismë pushke ju përgjegjën dhe fashisti nuk bëri as gëk, as mëk. Partizanët u hodhën mbi maqinat. Dikush mori dy pushkë nga kabina e një maqine, të tjerët hapën spondet dhe po mundoheshin të çelnin arkat me municion që ndodheshin aty, por më kot. Ato ishin mbyllur fort dhe pa vegla nuk mund të hapeshin. Brenda çdo maqine kish 6-8 bomba aviacioni, të destinuara, sigurisht, për të djegur e shkatërruar fshatrat tona.

U dha urdhër të digjen maqinat. Leekat e lagura me benzinë e të ndezura u hodhën në sarbatorët e tyre dhe flakët filluan të përvëlonin gjithshka.

Partizanët u tërhoqën në pozicionet që kishin më parë. Por, komandanti i batalionit po qëndronte akoma pranë dy maqinave që po digjeshin dhe drejtonte veprimet e batalionit. Një ndjenjë tmerri i pushtoi të gjashtë partizanët e skuadrës së sulmit, kur panë se komandanti i tyre trim kish mbetur atje poshtë dhe nga çasti në çast mund të pëрпиhej nga eksplozioni i bombave që ndodheshin nën maqinat. Gjashtë zëra thirrën komandantin për ta lajmëruar mbi rrezikun, por kërkëllima e flakëve dhe krismat e pushkëve atje më tej, ku akoma vazhdonte përleshja, nuk e lanë zërin të dëgjohej. Çdo sekondë ishte vendimtare për jetën e shokut, e komandantit. Dhe këtu u shfaq qartë vetëmohimi partizan. Të gjashtë partizanët, sikur ta kishin bërë me fjalë, u lëshuan tatëpjetë drejt komandantit. Por njëri, më i shpejtë se të tjerët, doli përpara, e arriu, e shkundi prej krahu, e lajmëroi për rrezikun që e kërcënonte

dhe të dy së bashku u turrën lart bregut për tek shokët, të cilët ndiqnin me ankth çdo hap të tyre. Nuk ishin shtrirë akoma mirë, kur një krismë shurdhonyesë drodhi tokën dhe një rrymë ajri me presion të fortë, tërë pluhur e tym, fshikulloi fytyrat, kokat dhe tërë trupin e partizanëve. Pas disa çastesh nga sipër filluan të binin copëra hekurash, rrotash e dërrasash të hedhura në erë nga plasja e bombave. Secili mund të goditej në kokë, në trup e kudo, pasi nga sipër nuk kishe si mbroheshe, pa qenë në strehim. Po rastësisht asnjëri nuk pësoi gjë.

Kur u largua tymi, partizanët hodhën sytë nga dy maqinat që para disa çastesh ndodheshin aty në xhade, por nuk panë asgjë, sikur një fshesë gjigande t'i kishte fshirë dhe t'i kishte hedhur kushedi se ku.

Tani aksioni ishte kryer dhe duhej tërhequr por kjo nuk ishte e mundur, pasi plasjet vazhdonin njëra pas tjetrës dhe u dha urdhër që të gjithë të qëndronin në pozicione.

... Pasi mbaruan plasjet dhe nga të 25 maqinat nuk mbeti në rrugë asnjë shenjë, batalionet u tërhoqën në rregull. Në këtë kohë nga drejtimi i Elbasanit po vinte një autobлиндë zbulimi e cila qëllonte në tym kodrat përpara. Fashistët gjermanë, që i kishin dëgjuar në Elbasan plasjet, të tmerruar dërguan zbuluesit e tyre, për të parë ç'kishte ndodhur. Pamja që shtrihej para tyre, të 50 ushtarët e asgjësuar (48 të vrarë e dy robër) dhe të gjitha maqinat e shkatërruara me gjithë municionin, u tregonin atyre se ç'i priste në Shqipëri.

Në këtë aksion një rol shumë të rëndësishëm lojti artileria, e cila jo vetëm që hapi zjarr mbi autokolonën, por që në fillim të sulmit goditi me përpikmëri dhe e neutralizoi një bateri të artilerisë

armike të vendosur në pozicion zjarri, diku aty afër pritës dhe që do të kishte penguar zhvillimin me sukses të aksionit. Kjo hapi zjarr, gjithashtu edhe kundër autoblindës, duke e detyruar të kthehej nga kishte ardhur.

Që ky aksion u krye pa humbje nga ana jonë dhe u arrit asgjësimi i plotë i armikut, kjo u arrit si rezultat i sigurimit të befasisë së plotë dhe sulmit të rrufeshëm për shkatërimin e autokolonës, pa i dhënë armikut kohë ta mblidhte veten ose t'i vinin në ndihmë. Por as befasia dhe as sulmi i rrufeshëm nuk mund të arriheshin pa bindjen e lartë politike dhe ideologjike, pa guximin, trimërinë dhe heroizmin e partizanëve, të cilët i zbatonin urdhërat e detyrat luftarake me një ndërgjegje e disiplinë të lartë. Vetë këto cilësi e kishin burimin në luftën e drejtë që bënte populli ynë nën udhëheqjen e partisë për çlirimin e vendit nga okupatorët fashistë dhe tradhëtarët dhe në punën e madhe që bënte partia për edukimin ideopolitik të partizanëve.

NËNA E ÇETËS

Aty nga fundi i vitit 1943, një grua nga fshati Kuç i Kurveleshit, pasi mbylli derën e shtëpisë së saj gjysmë të djegur e të rrëzuar, bashkë me të bijën 15 vjeçare, u nis për t'u bashkuar me çetën partizane që luftonte në Buzën e Këmbezit. Atë ditë, ajo, pa i rënë njeriut në sy, zuri vend përkrah partizanëve dhe qëllonte mbi gjermanët. Në mbrëmje, pasi u tërhoq armiku, ne u mblodhëm në një kodrinë dhe filluam të pastronim armët. Kur mbaruam, komisari u çua dhe na foli mbi rezultatet e luftimit, pastaj na njoftoi se në çetën tonë kishin ardhur edhe dy partizane të reja.

— Këto janë nënë dhe bijë. Kështu që, tashti, e gjithë familja e tyre ndodhet në çetë, dhe me armë në dorë lufton për çlirimin e atdheut, — shtoi komisari, duke shikuar me buzë në gaz shokun «Burim», që ishte ulur aty afër dhe bënte sikur rregullonte rrypat e gjerdanit.

Ajo ishte nëna e përgjegjësit të rinisë, e shokut «Burim». Quhej Fato Levendi. Ish rreth të dyzetave, me trup mesatar, fytyrën e kishte të ashpër, të rrahur nga jeta, me një hundë si të shqiponjës. Qe veshur me rrobat karakteristike të vendit. Në shaminë e zezë, që mbante në kokë, kishte qepur një

yll të kuq, kurse në krah mbante një pushkë të shkurtër italiane. E bija ishte një vajzë e pashme, me trup të bëshëm, quhej Naze.

Itendenti, që atë ditë i çoi te togu i plaçkave të zëna armikut dhe u dha disa rroba. Nënë Fatos i dha një pushkë gjermane, kurse pushkën e saj e mori Nazia, meqënëse ajo e përdorte më lehtë.

Kështu u njohëm për herë të parë ne partizanët me këtë grua labe që së bashku me djalin dhe vajzën, të vetmit njerëz që kish, doli malit me pushkë në dorë për çlirimin e atdheut.

Ditët kalonin. Në fillim partizanët, pastaj dhe disa partizane i drejtoheshin asaj jo «shoqja Fato», siç veprohej me të gjithë, por «nënë Fatua». Kjo qe e natyrshme, sepse po t'i hidhje një sy gjithë çetës, zor se mund të gjeje shoqe në moshë të Fatos. Mirëpo një ditë, në mbledhjen e kritikës dhe të autokritikës disa partizanë thanë se nuk e quanin të drejtë që ndonjë shoku ose shoqeje partizane t'u drejtoheshe ndryshe, veçse sipas rregullit partizan.

— Në qoftë se u ka marrë malli për nënat e hallat, shkoni në shtëpi! — tha Rexhua. — Këtu të gjithë jemi shokë, e keni dëgjuar ndonjëherë të birin që t'i ketë thirrur nënë Fatua?

Dhe me të vërtetë, megjithëse në fillim dukej si qesharake, «Burimi» e Nazja kurrë nuk i thërrisnin asaj nënë, por shoqja Fato.

— Mirë, ore mirë, shokë jemi të gjithë, por atë e kemi si nënë këtu, — tha Hakimi. — Ne shokë kemi të birin dhe të bijën, por nuk mund të kemi edhe nënën e tyre.

Po Rexhua kish mendjen e tij dhe nuk ja mbushje dot kokën.

— Këtu në luftë s'ka nënë e bijë, ka dy parti-

zane, njëra është shoqja Fato e tjetra shoqja Naze.

Megjithatë ne nuk na pëlqente, që ta thërrisnim shoqja Fato, kështu që i thamë Rexhos se nuk ishim dakord. Në fund «sherrin» e shuajti zëvendëskomisari, shoku Ali Gjolicu.

— Ajo në luftë është shoqja jonë, por nga moshë është nëna e çetës sonë, prandaj unë mendoj t'i drejtohem asaj duke e thirrur «Nëna e çetës».

Dhe që atë ditë Fatos nuk i thërrisnin më shoqja Fato ose nënë Fatua, por Nëna e çetës. Këtu nuk bëri përjashtim as Rexhua, sepse fjala e zëvendëskomisarit që ligj për të gjithë.

Nëna e çetës luftonte krah për krah me partizanët, qëllonte me pushkë, mbi llogoret e armikut, hidhte granatat që i mbante të varura në gjerdanin e fishekëve. Me zërin e saj burrëror: «Para partizanë!» na jepte zemër, për të sulmuar. Nuk e kisha parë, as edhe një herë, që në zjarrin e luftës të rrinte afër të birit ose së bijës, të gjithë ishin bijt e Nënës së çetës.

Në muajin shkurt 1944, gjermanët dhe ballistët ishin në fshatin Senicë të Delvinës. Ata ja kishin shtruar me të ngrëna e me të pira dhe po masakronin popullin. Ne ndodheshim në qafën e Skërficës. U vendos që t'i sulmonim në të gdhirë. Udhëtuam tërë natën. Një pjesë kaluan nga Qafa e Luadhit, kurse një pjesë nga Qafa e Kikës. Në kohën e caktuar, u vendosëm nëpër vende gati, për të filluar sulmin. Binte vesë. Rojet balliste kishin ngrehur një çadër mbi fshat dhe po loznin letra. Pas pak njëri nga ata tha:

— More Çerçiz, pa shiko andej se mos vjen njeri!

— Jo, a derëzi, kush do të vijë. Të ka hyrë frika në palcë.

— Ja, këlyshët e kuq, kush do të vijë tjetër!

— Ata kushedi ku dridhen nga të ftohtit.

Në këtë kohë ne ndodheshim rreth çadrës. Aliu thirri fort:

— Duart lart, tradhëtarë!

— Dorëzohuni! — bërtiti Nëna e çetës dhe gryka e pushkës së saj i lemeriti ballistët brenda.

Roja, që ishte te dera, hodhi pushkën dhe përmes nesh, ja mbathi për në fshat, kurse të tjerët, ashtu ulur, ngritën duart lart. I çarmatosëm të gjithë, i lidhëm dhe të shoqëruar nga dy partizanë, i nisëm për në Fushë-Bardhë. Në çadër, veç të tjerave, kishte edhe një kusi plot me pilaf dhe mish të pjekur.

— Të hamë nga një mëlë bukë, se kemi dy ditë pa ngrënë, — tha një shok. Por, papritur u dëgjua zëri i Nënës së çetës: «Para partizanë!». Pastaj, ajo vetë e para u vërsul përpara. U nisëm me shpejtësi poshtë. Ballisti, që mundi të na ikte, kishte dhënë alarm. Lufta filloi e rreptë, ballistët dhe gjermanët qëllonin nga pozicione të përgatitura dhe nga dritaret e shtëpive. Artilerinë e kishin vendosur në Palavli dhe qëllonin herë pas here. U përleshëm për disa orë. Armiku pati shumë të vrarë e të plagosur, por edhe nga ne pati humbje. Vendi ku sulmonim ishte krejt i zhveshur. Dukeshin si në pëllëmbë të dorës shokët që rrëzoheshin të vrarë ose të plagosur nga plumbat dhe predhat e armikut. Më takoi për një çast, të jem afër me Nënë e çetës. Ajo, e mbështetur në njërin gju, merrte shënjë dhe qëllonte, pastaj vraponte përpara dhe prapë qëllonte.

Herë pas here kthente kokën nga ndonjë shok që rrëzohej për tokë, vraponte atje, dhe i lidhte plagët kur që nevoja. Lufta vazhdonte...

Nja njëqind metra djathtas, «Burimi» u përplas për tokë nga shpërthimi i një predhe artilerie fare afër tij. Nëna e çetës e pa mirë si u mbulua nga flaka dhe tymi djali i saj i vetëm. Në këtë kohë, pak më tej «Burimit» u rrëzua Skënder Pepiu nga Progonati. Nëna u nis me vrap dhe shkoi te Skënderi. Plumbi e kish marrë në gjoks, pak nga e majta. Ishte duke jetuar minutat e fundit. Ajo i zbërtheu bluzën dhe këmishën, pastaj i nxori një fishek nga gjerdani, i hoqi plumbin dhe i hodhi në plagë barutin që kishte gëzhoja.

— Mbahu si burrë, bir i nënës! — i thosh dhe me pëllëmbën e dorës i fshinte nga balli djersën e ftohtë, kurse fytyra e plotë dhe zeshkane e Skënderit po venitej. Pas pak, ai vdiq. Vetëm më vonë nëna ju afrua të birit të plagosur.

Një ditë, tek ne në Fushë-Bardhë erdhi dhe foli Memo Metua. Ky ishte fjalimi i fundit që dëgjuam nga goja e tij. Pasi mbaroi fjalën, Memua ju afrua Nënës së çetës dhe e pyeti:

— Shoqja Fato, a ke mësuar shkrim e këndim?

— Jo, po do të mësoj, shoku «Grum»! — ju përgjegj ajo, si me ndrojtje. Dhe po atë ditë, Nëna e çetës filloi të mësonte gjermën e parë të alfabetit të gjuhës shqipe, kurse pas një jave, ajo lidhte gjermat.

Në fund të marsit filluan luftimet me gjermanët dhe ballistët në qafën e Prapanicës. Armiqtë qenë shumë dhe qenë hedhur në sulm, por megjithatë, ne mbroheshim me këmbëngulje. Secili nga ne kishte zënë nga një gur dhe po qëllonte. Nëna e çetës ishte në të majtë të zëvendëskomisarit, shokut Ali Gjolicu, i cili ishte shtrirë në një pllakë guri dhe po qëllonte si të gjithë të tjerët. Më kujtohet

gjakftohtësia e Aliut, i cili, pasi shënonte mirë me maliherin e tij të ri e me sytë të bukur, hiqte këmbëzën, qëllonte rrallë, por në mish. Lufta filloi që me të lindur të diellit. Aty nga pasdreka, gjermanoballistët, pasi e panë se nuk na shkulin dot nga pozicionet tona, përqëndruan zjarr të dendur me artileri e me mortaja. Një predhë mortaje plasi mbi kofshën e djathtë të Aliut dhe i copëtoi këmbën. Gjaku i rridhte rrëke. Pas ca minutash ai vdiq aty në krahët e Nënës së çetës, të cilën e donte aq shumë. Ajo nuk e mbante dot të qarët. Lotët e saj pikonin mbi ballin e gjerë të Aliut. Kjo ishte hera e parë që ne pamë lot në sytë e saj.

NËNË! MOS TRADHËTO SHOKËT!

Në një natë të errët tetori me shi, kur gjëmonte pushka për liri në fshat e në qytet, një detashment ushtarësh gjermanë, duke kaluar midis Lagjes së Re të Vlorës, u nda në grupe të vogla. Një grup prej më se 10 vetësh u drejtua për tek një shtëpi përdhese. Papritur të çelej dera, ata e shqyen. Nënë Tarike Hoxha, së bashku me katër djemtë e vajzën nuk arritën të ngriheshin nga dyshekët. Nazistët gjermanë ishin brenda në dhomë, me automatikë në duar, të gatshëm për të hapur zjarr. Njëri prej tyre, një burrë i shkurtër, me bark të madh e me flokë të kuqe me spaleta ari në sup foli me nervozizëm: «Ales kaput». Sytë i kishte të çakërdisur dhe krekosej si të ishte në shtëpinë e tij.

Ushtarët filluan t'i vinin vërdallë shtëpisë, duke kontrolluar. Njëri, që kishte një feste të bardhë në kokë e një pistoletë «Valter» në dorë, duke i picëruar sytë e tij të vegjël, si të gjarpërit, ju drejtua nënës:

— Ku e ke fshehur Rahmanin?! Dëgjon ç'të them? Atë komandantin e njësitit gueril.

— Nuk e njoh këtë njeri dhe as ma ka zënë veshi kurrë këtë emër!

— Ne jemi të sigurtë... Ti e njeh shumë mirë.

Para disa orësh, ai ka qenë këtu, në shtëpinë tënde. Trego pra, ku është? Kjo do të të lehtësojë shumë!

Me dorën e tij të akullt e plot damarë, ai e kapi plakën prej gryke dhe i vuri revolverin në gojë. Sytë i shkrepëtinin. I dukej se po bënte trimëri me një grusht eshtrash të një nëne, që ish plakur, para kohe, nga vuajtjet.

— Do të tregosh, apo...

Nënë Tarikia, duke e parë atë drejt në sy, mendonte: «A thua të më vrasin vërtet?... Më vjen keq që nuk pashë një ditë të bardhë... Burri m'i la fëmijët të vegjël. I rrita vetë, me thonj. Dhe ja, tani që prisja t'i gëzoja, ky xhelat kërkon të më marrë xhanin. Por unë nuk tradhëtoj. Më mirë le të vdes me nder... Kurrë nuk mund ta mbaj këtë turp në derën time...»

— Këtu nuk ka të huaj. Mos na bini në qafë. Mendo se edhe ti ke nënë, — ju përgjegj ballistit.

Gjermani me spaleta filloi të fliste gjithnjë e më egër, duke lëvizur vazhdimisht revolverin, që mbante në duar. Ai herë skuqej e herë zverdhej.

— Zoti kapiten kërkon nga ti, — i tha ballisti, — që të tregosh, sa nuk është vonë... Fol, ku ndodhet tani ai bandit? Kini parasysh se ai do të kapet patjetër. Në qytet është shpallur shtetrrëthimi dhe, as miza nuk mund të shpëtojë nga ne. Në rast se nuk do të thuash të vërtetën, do të humbasësh djemtë.

Kur dëgjoi këtë, nënë Tarikia, me një lëvizje të shpejtë, u derdh nga djemtë si shqiponja te zogjtë e saj. E lagu me lot fytyrën e njomë të Hysniut, që akoma nuk kishte hequr brisk në faqe.

— Nënë! Mbahu, mos e jep veten! — i tha ai. Njëpërmjet atyre fjalëve, ajo kuptoi qartë

«Nënë e dashur, më mirë të vdesim me nder të tërë, se sa...»

Në çastin kur ajo i hodhi duart në qafë Feçorit, djalit të madh, me të cilin kishte filluar të qante hallet, një dorë e fuqishme e kapi për flokësh dhe e rrëzoi për tokë.

— Dëgjo këtu, o shtrigë! Mendohu sonte dhe në rast se edhe nesër nuk tregon, djemtë do t'i takosh vetëm në botën tjetër!

... Të qarët e djalit dhe të vajzës së vogël, që mbetën në shtëpi, e sollën në vete. Ajo vështroi e hutuar nga të katër anët, me shpresë se do t'i shihte djemtë. Por më kot, ata tani ishin në duart e xhelatëve.

— Vdekje ku je, merrmë! Nuk mund të duroj dot! — bërtiti nëna me sa fuqi që kishte.

Syrjai i vogël dhe vajza e saj 13-vjeçare e kapën për qafe, duke u lebetitur.

— Nënë, o nënë!

— Jo! Do të jetoj që t'ju rris ju dhe që të hakmerrem kundër xhelatëve! — tha ajo duke i mbuluar me të puthura.

... Si nëpër tym i kujtohet nënës, dita e nesërme në zyrën e gestapos, që u hap e u mbyll shpejt. Nga dera, ajo pa të dy djemtë e saj të lidhur. Ishin bërë tërë njolla në fytyrë. Prej gojës dhe hundëve, u kullonte gjak.

— A u mendove mirë, o plakë? — i tha ai ballisti që e kishte parë natën e kaluar. — Gjermanët nuk duan gjë tjetër prej teje, veç të thuash se në cilën shtëpi ndodhet ai hallvaxhiu dhe pastaj do të t'i lirojnë djemtë. Djalin e tretë ta kanë çuar në spital, pasi kishte thyer një këmbë. Po nuk na tregove, do të t'i vrasim të tre. E ty nuk ka ç'të

duhet jeta pa ata. Kurse ne nuk humbasim asgjë. Do ta gjejmë patjetër atë banditin. Nuk do të lëmë shtëpi pa kontrolluar? Trego pra, sa nuk është vonë!

— Nuk u ka hije të shfreni zemërimin tuaj mbi këta jetimë. Ndoshta do ta paguani, patjetër do ta paguani këtë...

Mbi nënën shpërthyen grushte. Ajo nuk pati mundësi t'u lërë lamtumirën fëmijëve të saj. Fashistët e tërhoqën zvarrë deri në rrugë. Kur u ndodh përpara shtëpisë së saj, tha me vete: «Duhet patjetër të lajmëroj Rahmanin mbi gjithshka!»

Pasi u sigurua se nuk e ndiqte njeri, u fut në shtëpi... Përpara i doli Rahmani, një djalë i gjatë shpatullgjerë, me ca sy të zezë e vetulla të trasha. Mbi faqet e fishkura të nënës filluan t'i rridhnin lot. Mbuloi fytyrën me duar e qau me dënësë.

— Ç'ke, nënë? Folë, të lutem! — i tha ai, duke e përqaftuar.

Dhe ajo i tregoi ç'kishte ndodhur.

Po atë mbrëmje, shokët e njësitit gueril, që vepronin në qytet, mundën të hiqnin nga thonjtë e fashistëve djalin e vogël të Tarikies, Gjyshon. Ndërsa dy djemtë e tjerë, fashistët gjermanë i çuan në kampet e shfarrosjes, ku gjetën vdekjen.

... Kanë kaluar vite nga kjo ngjarje. Nënë Tarikia jeton tani me dy djemtë, që i mbetën, Gjyshon dhe Syrjanë. Krahas tyre, ajo ka edhe shumë djem të tjerë që e respektojnë dhe e duan si nënë. Po, ai që e do më shumë nga të gjithë nënë Tarikien, është Rahmani.

AKSIONI PRANË URËS SË KRANESË

Ishim një skuadër partizanësh dhe ecnim një-ri pas tjetrit në një natë të errët e të ftohtë të mu-ajit shkurt. Kishim marrë urdhër që të arrinim pa gdhirë në fshatin Krane, pranë urës, të cilën e ru-ante një postë gjermane. Ndaj të gdhirë do të ka-lonte andej një autokolonë e madhe gjermane, që vinte nga Saranda në Konispol. Qëllimi ynë ishte që ta pengonim këtë autokolonë. Prandaj nxito-nim. Ndjenim të ftohtë, por asnjëri nuk ankohej. Të gjithë mendonim për një gjë: Të arrinim pa gdhirë tek ura e Kranesë.

Në një kthesë dëgjova zërin e shokut që ecte përpara meje: «Kujdes, po futemi në kanal!» «Do të jetë kanali për të cilin na foli komisari para se të niseshim, — mendova». Atje në fund ngrihej si një xhungë e shëmtuar posta, ku bënin roje ushta-rët nazistë. Ata kishin ardhur aty që me kapitulli-min e Italisë fashiste dhe e hiqnin veten si zotër të këtij vendi.

— Do t'jua tregojmë se sa u vlen lëkura! — thashë me vete.

Kur hymë në kanal, ndjeva ujët e ftohtë që m'u ngjit gjer në gju dhe të dridhurat më pushtu-an trupin. Mblodha veten dhe fillova të eci. Papri-tur një dritë prozhektori ra mbi kodrat aty pranë, zbriti në fushë dhe po i afrohej kanalit.

— Shokë, përkuluni!

Drita e prozhektorit u afrua, kaloi mbi ne. Ndalova frymëmarrjen. M'u duk sikur shiriti i gjatë i dritës u ndal mu mbi kokat tona, mbi kanal. Drita e prozhektorit qëndroi për disa sekonda, pastaj lëvizi në drejtim të fushës. Gjermanët s'na kishin parë.

— Shokë, ecni me kujdes! — Këto fjalë kalojnë gojë më gojë.

Sa kohë kemi që ecim nëpër kanal? Ndoshta një orë? Ndoshta më shumë? Po sikur të mos arrijmë në kohën e duhur, atëhere autokolona do të kalojë dhe skuadra jonë partizane do të mos e kryej detyrën. Por kjo nuk mund të ndodhë. Ne nuk do ta lëmë të ngjasë një gjë e tillë. Do të luftojmë deri në pikën e fundit me postën gjermane që autokolona të mos kalojë. Gjermanët ta kuptojnë dhe një herë se ky vend ka zot!

Trupi më është lagur i tëri, por, për çudi, nuk ndjej më të ftohtë. Mendja e zemra janë përqëndruar në një vend: tek posta armike që nxin si një xhungë e shëmtuar, pranë urës.

Përpara meje duket ndërtesa e postës, ura e Kranesë, frëngjitë e ngushta të postës. Atje me siguri qëndrojnë grykat e ftohta të mitralozave. Posta është e rrethuar. Qëndroj në pozicion me pushkë në dorë dhe pres... Pres vetëm një urdhër që të heq këmbëzën.

— Zjarr!... Lufta fillon e rreptë. I tërë zjarri ynë drejtohet në frëngjitë e postës. Midis gjermanëve dëgjohen të thirrura dhe zhurmë. Ata kapen në befasi. Grykat e zjarrit të tyre një nga një fillojnë të heshtin.

Qëllimi u arit, autokolona armike nuk kaloi në datën dhe orën e caktuar sipas planit gjerman.

ARMIKU NUK KALOI...

Në ditët heroike të luftës, kur do të mbliidhej Kongresi historik i Përmetit, Batalioni II i Brigadës IV sulmuese ishte i dislokuar në rajonin Podgorije-Qafë e Grabovicës-Çerravë dhe kishte prerë rrugën automobilistike Korçë-Pogradec. Komanda e batalionit ndiqte me vëmëndje veprimet e armikut dhe herë pas here forcat tona godisnin posta dhe baza të ndryshme të tij deri në thellësi të Fushës së Korçës, duke i detyruar ballistët dhe nazistët të qëndronin vetëm në rajone të fortifikuara brenda në qytetin e Korçës.

Armiku nga ana e tij, po përgatitej për operacionin e qershorit të vitit 1944. Dukeshin qartë përgatitjet e tij për këtë operacion, sepse armiku bënte zbulime me forca të pakta në drejtime të ndryshme. Për këtë operacion ishin mobilizuar gjithë forcat gjermano-balliste të vendit. Armiku kishte sjellë trupa edhe nga Greqia dhe veç këtyre, kishte marrë të gjitha masat, për të shfrytëzuar edhe forcat fashiste bullgare që ishin dislokuar në Ohër dhe në Shën-Naum. Këto forca, pasi kishin zënë katundin Peshkëpi, kishin filluar të lëviznin në drejtim të Pogradecit dhe Podgorijes, që ishin çliruar nga forcat tona. Nuk kish dyshim se

qëllimi i tyre ishte t'u dilnin në shpinë forcave tona, të vinin midis dy zjarreve forcat që vepronin në drejtimin Çerravë-Qafë e Grabovicës-Podgorije, të ndihmonin gjermanët për asgjësimin e forcave tona, dhe të okuponin Pogradecin.

Batalioni ynë mori detyrën që t'u jepte një mësim të mirë forcave bashibozuke fashiste bullgare: t'i përzinte këta armiq nga toka jonë, të çlironte Peshkëpinë dhe të mbante të çliruar qytetin e Pogradecit. Këtë detyrë ua bëri të qartë komandave të kompanive komandanti i batalionit, ndërsa komisari u foli partizanëve të batalionit mbi punimet e Kongresit të Përmetit dhe mbi forcat fashiste bullgare që bashkëpunonin me gjermanët. Urrejtja e partizanëve, ashtu si kundër gjithë fashistëve, edhe kundër fashistëve bullgarë ishte e pakufishme.

Pas një zbulimi të hollësishëm të forcave armike, kur dielli akoma ishte më të perënduar, kompanitë u nisën në formacion luftimi nga kodrat e Bllacës, në drejtime të kundërta. Tërë kujdesi i komandave të kompanive dhe partizanëve ishte që t'u afroreshin fshehtazi sa më shumë pozicioneve të armikut, në mënyrë që t'i zinin në befasi fashistët bullgarë, t'i përzinin nga toka që kishin zënë, t'i nxirrnim në fushë të hapët, pastaj, ose t'i bënim të iknin nga kishin ardhur, ose t'i asgjësonim. Për këtë arsye u shfrytëzuan si duhet përrroi i katundit Çerravë, një përrua i vogël afër katundit Alarup dhe rruga këmbësore e katundit Alarup-Peshkëpi, e cila në pjesën më të madhe ishte e mbuluar në të dy anët me ferrishte të mëdha.

Me gjithë përpjekjet tona për të maskuar lë-

vizjen drejt tyre, ata diç kishin nuhatur, sepse kishin nxjerrë roje të forta dhe një pjesë e forcave të tyre ishte vendosur në llogore e pozicione, ndërsa të tjerët ishin duke bërë muhabet. Po kur kolonat tona filluan të marrin formacion luftimi dhe kur rojet e tyre filluan të shtinin e të jepnin alarmin, edhe këto forca u sulën drejt pozicioneve dhe tran-sheve që kishin hapur. Në këtë kohë, forcat tona, sidomos ato të krahut të majtë dhe të qendrës, ishin afruar shumë dhe me zjarrin e tyre i detyruan forcat kryesore të armikut të zinin pozicione në fushë të hapur. Pas këtij suksezi, komandanti i batalionit urdhëroi që forcat tona të sulmonin me shpejtësi. Dhe përrrenjtë e kodrat e Alarupit, të Çerravës dhe të Peshkëpisë buçitën nga thirrjet: «Para partizanë!» U vranë fashistët e parë bullgarë. Të tjerët lanë pozicionet dhe u munduan të shkonin tek ata që kishin zënë pozicione më prapa. Duke shfrytëzuar këtë tërheqje, forcat tona u sulën më me tërbim, arritën një pjesë të këtyre forcave dhe filluan luftimet trup me trup. Të tmerruar, fashistët bullgarë lanë pozicionet dhe u tërhoqën në panik, në mënyrë të çorganizuar drejt Shën-Naumit. Rezultatet më të mira i arritën forcat partizane të krahut të majtë dhe të qendrës, të cilat, pas një lufte të ashpër, zunë kodrat mbi xhadenë, midis Ohrit dhe Shën-Naumit. Por në krahun e djathtë të forcave tona, aty ku fillon të ngrihet lart mbi kodrinat Mali i Thatë, armiku i mbrojtur nga shkëmbenjtë, të cilët ngrihen si kala natyrale, filloi të bëjë rezistencë të ashpër. Por mbi këtë kala filluan sulmin partizanët e kompanisë së parë dhe në krye të tyre shquheshin partizani trim, pjesëtar i vazhdueshëm i skuadrës së

sulmit, Stillo Gostivishti dhe partizani tjetër trim Nevruz Kreshova nga Skrapari. Duke qënë frymëzuesit e sulmit të kompanisë, ata vërshuan në krye dhe arritën të kacafyteshin me armiqtë grykë për grykë. Po edhe fashistët bullgarë qëndrojnë. Orët kalojnë dhe fillon të erret, por lufta bëhet gjithnjë e më e ashpër. Duke vlerësuar drejt situatën, komandanti i batalionit hoqi nga vija e parë një pjesë të forcave dhe i dërgoi në krahun e djathtë. Kjo i dha një shtytje të re sulmit, i cili me sinjalin e burisë «alarmi» u bë i rrufeshëm dhe i tmerroi armiqtë. Po në horizont, në pikën më të lartë, akoma dukej flamuri i tyre. Në drejtim të tij, të mbështetur nga zjarri i fortë i mitralozave dhe pushkëve partizane derdhen Nevruzi e Stilloja. Po pikërisht, kur ata i ishin afruar shumë flamurit, armiqtë shtien dhe partizani Nevruz Kreshova bie. Stillua, edhe pse pa shokun e tij, qëllon mbi armiqtë, dikë vret prej tyre dhe pastaj me nxitim turret në drejtim të flamurit. E arrin, e thyen shtizën dhe si e shkëput prej saj e gris si ndonjë leckë të ndotur. Po, në kohën, kur po e flakte për tokë, një fashist bullgar, i fshehur, shtie dhe Stillua bie. Pas kësaj ngjarjeje partizanët nuk u përmbajtën më. Të frymëzuar nga heroizmi i të dy shokëve, vërshuan me furi të paparë, duke i detyruar fashistët bullgarë t'ja mbathnin me të katra në drejtim të Ohrit, duke lënë në fushën e betejës më shumë se 30 të vrarë, po aq pushkë, armatim dhe plaçkë tjetër lufte. Ne humbëm dy shokë, Nevruzin e Stillon. Dy luftëtarë trima e të vendosur gjer në vdekje për çështjen e shenjtë të partisë dhe të popullit.

Kështu fashistët bullgarë, u thyen e u përzu-

në nga territori ynë, pa mundur ta kryenin detyrën që u kishin ngarkuar nazistët gjermanë.

Si u pastrua fusha e luftës nga armiqtë, në kodrat e Alarupit u dhamë përshëndetjen e fundit shokëve të rënë dhe u betuam para tyre se, për të rr.brojtur tokën tonë nga çdo armik, që do të tentojë të sulmojë vendin tonë, nuk do të kursejmë asgjë, as gjakun dhe as jetën.

KOMUNISTJA E ORËVE TË PARA

Kur hyn në oborin e shkollës pedagogjike në Shkodër, menjëherë të del përpara busti i dëshmorës Shejnaze Juka, «Lumi», siç e thërrisin atë gjatë luftës.

Shejnazi e nisi aktivitetin revolucionar qysh herët, kur filloi të kuptonte shtypjen dhe shfrytëzimin e egër që i bëhej popullit tonë nga klasat sunduese dhe nga regjimi satrap i Zogut. Kjo shtypje ndikoi shumë në formimin e karakterit të saj revolucionar.

Shejnazi ishte një ndër vajzat e pakta që vazhdonin atëhere shkollën. Pasjoni për të mësuar dhe për të zgjeruar horizontin e dijenive të saj ishte një ndër karakteristikat e saj. Ajo u dha pas letërsisë artistike përparimtare dhe literaturës. Shkrimtarët më të dashur për Shejnazin ishin Gorki dhe Migjeni.

Në atë kohë shumica e të rejave shkodrane, ashtu si gjithë të rejat e Shqipërisë, nuk i njihnin bankat e shkollës, e sidomos ato të shkollës së mesme. Ato ishin të mbyllura dhe veç punëve të shtëpisë nuk bënin gjë tjetër, veçse qëndronin me duar e lot lule të thata mbi ndonjë copë pëlhurë, ku shprehnin ëndërrat, ndje-

njat dhe dëshirat e tyre shpirtërore, pa ditur fatin që i priste. Shejnazi shumë herë i kritikonte djemtë, që mbanin motrat e tyre të mbyllura dhe dëshpërohej për jetën dhe fatin e femrës shqiptare. Duke u nisur nga kjo, ajo shkroi një vepër me titull «Lulet e gjergjefit», që u kush-tohej vajzave shkodrane dhe ku pasqyroheshin ëndërrimet e tyre të vdekura. Këtë dorëshkrim, ajo, ua lexonte shpesh shoqeve të saja të mbyllura.

Pushtimi fashist i vendit e gjeti Shejnazin në bankat e shkollës. Si shumë shokë të saj, ajo e shprehte hapur urrejtjen ndaj pushtonjësve dhe dashurinë për atdheun e robëruar. Hartimet e saj në shkollë gjithnjë preknin probleme sociale dhe shprehnin urrejtjen për zaptunjësin si dhe dashurinë e thellë për atdhen dhe popullin e robëruar.

Rreth vitit 1940, ajo bëhet anëtare e grupit komunist të Shkodrës dhe, me formimin e partisë — anëtare e saj. Kjo e bëri Shejnazin të punojë më shumë e me vetëmohim për çështjen e madhe të çlirimit të atdheut. Tani ajo propagandon dhe sqaron vazhdimisht masat, se e vetmja rrugë e shpëtimit nga vuajtjet ishte çlirimi i atdheut nga okupatorët dhe formimi i një shteti demokratik popullor, që të udhëhiqej nga Partia Komuniste Shqiptare.

Më 10 tetor të vitit 1942, ajo qëndroi në krye të demonstratës me një flamur të qëndisur nga duart e saja. Megjithëse fashistët shtinë mbi demonstronjësit dhe vranë komunistin Vaso Kadia dhe plagosën mjaft të tjerë, Shejnazi e patrembur qëndroi gjer në fund përballë grykave të pushkëve, duke u bërë kështu shembull qëndrese për të tjerët.

Në shkurt të vitit 1943, ajo mori pjesë edhe në demonstratën e vajzave të shkollës «Donika Kastrioti», që u zhvillua nën parullat: «Nuk duam drejtoreshë italiane!», «Nuk duam të huaj!». Në këtë aksion u manifestua edhe një herë gjallëria, shkathtësia dhe pjekuria e saj, për arësye se puna që kish bërë si militante partie, kish hedhur rrënjë të thella në zemrat e nxënësve të qytetit të Shkodrës.

Në luftë me familjen që e pengonte shumë dhe në luftë me armikun, ajo s'u spraps kurrë. Po aktiviteti i gjerë e ekspozoi dhe një ditë Shejnaze Jukën e përjashtuan nga shkolla si të padëshëruar, për shkak të veprimtarisë së saj revolucionare. Kështu u detyrua të largohej nga Shkodra dhe të vinte në Tiranë, ku pas disa përpjekjesh u regjistrua në shkollën pedagogjike të këtij qyteti.

Por edhe këtu ajo vazhdoi aktivitetin e saj revolucionar dhe filloi të shquhej në mes të shoqëve të klasës e të shkollës, për aktivitet antifashist. Një ditë, në shkollë, drejtoresha solli në klasën ku mësonte ajo dy nxënëse me qëndrim të keq politik. Shejnazi e para u ngrit e tha: «Ne s'pranojmë në gjirin tonë elementë që kanë shitur nderin tek armiqtë e vendit, prandaj kërkojmë të largohen sa më parë. Po të mos t'i përjashtoni ju, — ju drejtua drejtoreshës fashiste të shkollës, — kemi për t'i përjashtuar ne!»

Dhe ashtu u bë.

Meqënëse lëvizja nacionalçlirimtare po merrte proporcione gjithnjë e më të gjera edhe aktiviteti i saj sa vinte dhe zgjerohej. Kështu edhe në Tiranë u ekspozua e u përjashtua nga shkolla. Atëhere u detyrua të shkonte në Elbasan te kushërinjtë e

nënës së saj, Mendoj se atje do të kish mundësi t'i kushtohej më shumë çështjes së partisë dhe të atdheut. Porsa arriti në Elbasan, filloi menjëherë nga puna dhe për hir të aktivitetit të saj me masat e grave dhe të rinisë së qytetit të Elbasanti shpejt u bë një figurë e njohur. Po të pyesësh edhe sot, pas një kohe kaq të gjatë, ata që e kanë njohur, të flasin me shumë admirim për të. Por edhe në këtë qytet Shejnazi ra në sy të organeve ndjekëse të armikut dhe një ditë, pasi u hodh në ilegalitet, me vendim të partisë u dërgua në Batalionin partizan të Çermenikës, si përgjegjëse e rinisë.

Shejnazi edhe si luftëtare me pushkë në dorë filloi të shquhej midis shokëve të saj. Ardhja e gjermanëve në Shqipëri dhe operacioni i tyre i dimrit ishin një provë e madhe zjarri për çdo partizan. Në atë gjendje të vështirë, kur forca të mëdha sulmonin në çdo krah, ajo shpesh bëhej she-mbull i lartë qëndrese për të rinjtë dhe të rejtat në atë batalion partizan.

Në luftimet e ashpra të dhjetorit të vitit 43 dhe ato të janarit të vitit 44 ajo e tregoi veten si një luftëtare e paepur. Në një nga këto beteja më 18 shkurt të vitit 1944, përballë okupatorëve gjermanë, ra për të mbetur përjetë në zemrën e popullit që e deshi aq shumë. Po edhe vdekja e saj qe një vdekje heroike. U gjend e shtrirë në pozicion me pushkën në faqe dhe gishtin në këmbëz. Dukej sikur akoma shtinte, dukej sikur akoma mbronte pozicionin e saj. Por zemra s'i rrihte më. Një copë mortajë e kish goditur në kokë. Gjaku i kish ngjirë mbi flokët e saj të zez. Megjithëse e vdekur, sytë e saj akoma e ruanin gjallërinë. Dukej sikur në ta akoma kishte jetë.

Vdekja e saj ndezi edhe më shumë zemrat e partizanëve, zemrat e të gjithë atyre që e njihnin. Përpara varrit të saj një zë i fuqishëm buçiti nga ato zemra:

— Betohe mi, se do të hakmerremi, Shejnaz!
Krahas Zonja Çurres, Margarita Tutulanit e të tjera grave dhe vajzave shqiptare qëndron edhe emri i Shejnazit.

SHALLI I KUQ

Muaji prill ishte në të dalë. Batalioni II i Brigadës VII, që me goditjen e parë shpartalloi armikun në Qafën e Sinjës dhe e detyroi të tërhiqej për në Berat. Partizanët e dy kompanive u vendosën në fshatrat Paftal e Sadovicë, ndërsa ata të kompanisë tjetër, u vendosën në afërsi të Qafës së Mbreshtanit.

Partizanët kishin bërë rrugë të gjata dhe prej disa ditësh s'kishin vënë bukë në gojë e s'kishin mbyllur sy. Megjithatë, ata e kishin syrin pishë dhe asnjë nuk ankohej.

U dha urdhëri për pushim. Vetëm rojet qëndronin zgjuar.

Nuk kishte kaluar asnjë orë, kur një nga rojet thirri:

— Ndal, parullën! — dhe menjëherë i drejtoi automatikun njeriut të panjohur.

Pak larg rojes qëndronte një djalosh, i cili mbante në duar një shkop.

Përgjegjësi i rojes shkoi menjëherë në vend dhe, kur ju afrua të panjohurit, e pyeti:

— Pse ke ardhur? Cilin kërkon?

— Partizanët dua! — tha djaloshi. — Gjermanët e ballistët kanë shkuar në Starovë dhe po grabisin fshatarët.

Komisari, që ishte aty afër, sa mori lajmin, dha shenjën e alarmit. Nuk kaluan as dy minuta dhe

partizanët u grumbulluan. Komisari, duke parë se disa partizanëve nuk u ishin tharë akoma opingat, dhe me që rruga për në Starovë ishte gurishte, pyeti se kush do ta shoqëronte atë për në aksion. Partizanët, si të ishin një trup i vetëm, ju përgjegjën njëzëri:

— Nisemi, shoku komisar!

— Jo, e gjithë kompania! — tha ai, dhe urdhëroi disa me emër të rreshtoheshin në dy skuadra.

Hyseni, i cili në këtë kohë mbante automatikun në dorë, ju drejtua komisarit:

— Unë jam me skuadrën e automatiksave, pra ndaj është mirë të më merrni. Kur u takuam me armikun në Qafën e Sinjës, nuk e zbraza asnjëherë.

— Mirë e ke ti Hysen, — thanë disa partizanë të tjerë, që edhe ata kishin mbetur jashtë dy skuadrave, — por edhe ne duhet të shkojmë, se asnjëherë nuk e zbrazëm, pasi gjermanët dhe ballistët nuk e bënë të gjatë.

— More shokë, na vajti vonë! Ballistët dhe gjermanët do të na ikin, — tha Shabani, që qëndronte në krye të skuadrës së parë.

— Jo, a derëzi, — u përgjegj Hyseni. — Ata, pa lëpirë edhe kockat e shelegëve që kanë grabitur, nuk çohen nga vendi. Vetëm plumbin e kanë një çikë zët ata!

Të gjithë qeshën. Komisari ra në hall se s'dinte kujt t'ja prishte, cilin të linte e cilin të merrte. Hysen Çepua ishte syfajkua. Dhe komisarit ju kujtua përpjekja me gjermanët te Ujët e Ftohtë, ku Hyseni luftoi me granata dore me gjermanët, që ishin struktur në fortifikata. Të linte atë apo të linte të tjerët? S'mund të bënte dallim, të gjithë partizanët ishin njësoj.

Kaluan disa minuta. Komisari ju afrua Hysenit,

i hodhi dorën mbi sup, e fërkoj në shpatull dhe ju drejtua partizanëve:

— Armiqtë nuk janë shfarosur të gjithë. Me ata do të kemi rast të takohemi përsëri.

Pastaj komisarit, së bashku me dy skuadra, u nis për në Starovë. Djaloshi ecte me treshin e pararojës.

Sapo kapërcyen malin, partizanët ju afruan fshatit. Në të hyrë të fshatit, pararoja lajmëroi se gjermanët dhe ballistët ishin grumbulluar te çesmja. Partizanët, pa u diktuar, zunë vend ndërmjet disa pemëve. Afër komisarit qëndronte djaloshi, i cili herë pas here ngrihej më gjunjë dhe vështronte përpara. Komisarit i bënte shenjë që të mos lëvizte, por ai nuk rrinte i qetë.

— Qëndro i shtritur! — i tha komisarit.

— Ç'presim? — ja ktheu djaloshi. — Pse nuk i qëllojmë? Ata mund të na diktojnë.

Në këto fjalë, dikush nga partizanët u kollit. Megjithëse ai vuri dorën në gojë, që të mos i dilte zëri, gjermanët kthyen kokën nga pemët dhe brofën në këmbë. Kur ata po zinin pozicione, partizanët filluan sulmin. Edhe armiku ju përgjegj zjarrit. Mitralozat dhe automatikët e tij qëllonin partizanët, që zbrisnin me furi drejt tyre. Partizanët u vërvitën gjermanëve bomba dore. Gjermanët u thyen dhe partizanët i ndoqën këmba-këmbës, deri afër buzës së lumit.

Kur u dëgjuan pushkët, mbërritën në vend edhe fshatarët, të cilët gjatë rrugës kishin kapur disa gjermanë dhe ballistë të plagosur dhe ua dorëzuan partizanëve.

Pas aksionit, partizanët u kthyen te shokët e tjerë. Djaloshi nuk u ndahej. Ai ecte pas komisarit. Ndërsa udhëtonin, komisarit e pyeti:

— Si të quajnë?

— Ago, — ju përgjegj djaloshi dhe, duke vënë buzën në gaz, ju afrua komisarit dhe i tha:

— Fashistët ma vranë nënën. Ata po na djegin. Në çdo çast më përfytyrohet nëna. Unë dua të vij me ju në brigadë.

— Po, ashtu është. Armiku është i egër dhe barbar, prandaj kudo partizanët e luftojnë atë pa pushim, që të marrin hakun e popullit, ta shporrin atë nga Shqipëria dhe ta çlirojnë njëherë e përgjithmonë atdheun.

— Unë po pres fjalën tuaj, — tha djaloshi.

Komisari vështroi një nga një partizanët dhe ra në mendime.

«Këtu nuk do të jetë vetëm. Do ta ketë vështirë në fillim, por lufta do ta kaliti». Pastaj u kthye nga djaloshi e i tha:

— Edhe partizanët duan të të kenë në radhët e tyre. Prej këtij çasti ti je pjesëtar i kompanisë sonë. Të urojmë që ta mbash me nder emrin e partizanit!

Djaloshi u përlot nga gëzimi. Pastaj komisarri i dorëzoi një pushkë, të cilën Agua e shtrëngoi fort afër gjoksit dhe ju drejtua partizanëve:

— Kurrë s'kam për t'ju turpëruar!

Pasdreke partizanët e lanë fshatin. Agua u bë pjesëtar i skuadrës së Mediut. Sa herë që partizanët pushonin, djaloshi i drejtonte sytë tek pushka. Ai e kthente atë në çdo anë, e vinte në sy dhe shënonte herë në ndonjë gur dhe herë ua drejtonte trungjeve të pemëve, që ndodheshin rreth e qark vendit.

Kaluan dy muaj. Agua u mësua me jetën partizane. Ai asnjëherë nuk mbeti prapa të tjerëve, partizanët i ndiqte hap pas hapi. Në çdo përpjekje me armikun, nuk i ndahej skuadrës së tij. Kur partiza-

nët e skuadrës së Mediut takoheshin me shokët e tjerë të kompanisë, vetëm fjalë të mira thoshin për Agon.

— I vogël është, — i thoshin ata njëri-tjetrit, — por ama qëndron si trimat.

— E pashë vetë me sytë e mi, — i tha Zakoja komisarit, — kur Agua herë në këmbë herë në gjuhë qëllonte kundër gjermanëve, në Qafën e Shkozës. Tri herë sulmuan gjermanët atë ditë në drejtimin tonë, por i thyem. Edhe Agua luftoi si gjithë partizanët e tjerë.

Komisari buzëqeshi, e shikoi Agon; që bashkë me partizanët po fshinte pushkën e tij dhe ju afrua e i tha:

— E, si po të qëllon pushka? A ke vrarë ndonjë fashist?

— Njërën e shtriva për tokë, kur ngjiteshim përpjetë dhe, kur gjermanët u thyen, dy i rrokullisa në të kaptuar të Ujit të Zi, — ju përgjegj Agua.

Në këto fjalë mbërriti komandanti. Ai mbledhi partizanët dhe u foli mbi përpjekjen e fundit në Qafën e Shkozës:

— Ne e kryem mirë detyrën, — tha komandanti. — Gjermanët s'lanë gjë pa përdorur kundër nesh. Edhe artileria e tyre e rëndë, edhe murtajat nuk na thyen dot.

Pastaj, si përmendi disa emra të partizanëve, ju drejtua dhe Agos:

— Të lumtë! Edhe ti e nderove kompaninë tonë.

Agua dëgjonte me vëmendje dhe vështronte komisarin, i cili shoqëronte fjalët e komandantit, duke tundur kokën. Në çast, komandanti dhe komisarit biseduan me njëri-tjetrin. Komisarit nxori nga çanta një shall të kuq dhe ja vuri në qafë Agos.

AI ISHTE NJERIU MË I DASHUR

Ditët e bukura të majit të vitit 1964 kalonin njëra pas tjetrës. Më së fundi erdhi edhe dita që pritej me aq gëzim nga ish partizanët e Brigadës XII sulmuese, 20 vjetori i inaugurimit të saj.

Herët, që në mëngjez, kur dielli sa kishte lëshuar rrezet e tij të arta, në fushën e Sukës, të zbuluar si për festë, nga drejtime të ndryshme filluan të vinin ish partizanët e Brigadës XII.

Partizanët të grumbulluar grupe-grupe, me shallet e kuq e gjoksin plot medalje, i jepnin fushës një pamje edhe më madhështore.

Ç'gëzim ndjenin ish partizanët në ato çaste! Ata përqafoheshin e putheshin me njëri-tjetrin tërësi si vëllezër të një mëme. Shumë nga ata e kujtonin njëri-tjetrin vetëm si fytyrë, ndërsa emrin ja kishin harruar dhe kishin të drejtë. Kishin kaluar njëzet vjet, njëzet vjet luftë e përpjekje për ndërtimin dhe lulëzimin e Shqipërisë së re.

Sa ndryshime kishin bërë ata partizanët e dikurshëm, bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër, ata që nuk dinin të hidhnin as firmën! Kudo takoheshin punëtorë, racionalizatorë, barinj dhe bujq të rendimenteve të larta, oficerë, inxhinjerë, mjekë, mësues, agronomë dhe të tjerë. Ata ishin rritur, kishin ndryshuar, disa edhe qenë thinjur, por të

gjithëve u qeshte fytyra. Ata flisnin me zjarr për jetën e re, për ndryshimet e mëdha që ishin bërë në vendin tonë.

U afrova pranë një grupi. Ata diskutonin në mënyrë të zjarrtë e plot optimizëm me njërit-jetrin.

— Kujt ja merrete mendja se do t'i arrinim këto ditë të lumtura! — tha njëri prej tyre.

— Ashtu është, — ja priti një tjetër, — ku dinim ne atëhere... Po të mos ishte partia!...

— Ku je inxhinjer, ku je! — ja priti me shaka shoku tjetër, që kishte në krah. — Kur erdhe partizan nuk dije as alfabetin, pa le pastaj...

— Me gjithë mend, shokë, për t'u çuditur është! — tha një tjetër. — Si ishim atëhere dhe si jemi sot!

Lufta dhe sakrificat nuk kishin shkuar kot. Amaneti i shokëve të rënë ishte mbajtur.

Por ja, biseda e ngrohtë e këtyre shokëve, që kishin filluar të kujtonin ditët e vështira të luftës, u prish nga këngët partizane që filluan të jehonin përsëri, si në ato ditë të paharruara.

Në atë takim aq entuziazt e të përmallshëm u dëgjua boria, që jepte sinjalin për rreshtimin e brigadës. Partizanët, me shpejtësi, zunë vendet e caktuara. Të gjithë, pothuajse, e mbanin mend nënrepartin ku kishin qenë, mjaft që të dëgjonin kompaninë apo batalionin.

Isha në rreshtin e parë të kompanisë së parë.

Në krah të kompanisë ishte rreshtuar shtabi i batalionit. Me gjithë komandat që jepeshin, unë shpeshherë, si padashur, ktheja kokën dhe shikoja me admirim ata shokë që na kishin mësuar e drejtuar në ato ditë të vështira... Ata qëndronin në rresht të menduar dhe me bishtin e syrit herë pas here shikonin batalionin që ndodhej i rreshtuar në krah

të tyre, tamam si në majin e atij viti... Sa kujtime ruanin ata nga jeta në atë batalion, me partizanët... Midis tyre ishte dhe një djalosh, rreth të njëzetepe-save.

Në fytyrën e tij shprehej një ndjenjë krenarie dhe gëzimi. Ai qëndronte në krah të komisarit të batalionit me një shami të kuqe në qafë. Në gjoks i shkëlqenin dekoratat e luftës. «Në kohën e luftës, ai duhet të ketë qenë shumë i vogël, — mendova me vete. Si është e mundur?!»...

Por komandanti i kompanisë, që ishte aty pranë, e kishte vënë re shqetësimin tim dhe m'u afrua:

— E shikon atë djaloshin me dekorata? — më tha.

— Po, — i thashë.

— Nuk të ngjan me njërin nga shokët që kishim gjatë luftës? — pyeti përsëri ai dhe heshti një çast.

Pas kësaj bisede të shkurtër tërë vëmendjen e përqëndrova tek ai djalë që dalëngadalë po më ringjallte kujtimin e njërit prej shokëve të mi më të dashur. «Me siguri ai duhet të jetë, — thashë me vete, — vëllai i Brahos! Apo ndoshta...»

Komandanti, që vazhdonte të më vërente, pohoi me kokë, dhe duke marrë frymë thellë, u mat të thoshte diçka. Po në çast u dha komanda «eja në radhë»!, dhe ai nuk pati mundësi ta shprehte me fjallë atë që ndjeu në ato çaste për ish zëvendëskomisar-in e tij.

Ai kishte ardhur në vëndin e Brahos. Duke shikuar djaloshin, m'u ringjallën gjithë ato kujtime që kisha për atë. Figura e Brahos ishte e paharruar për mua.

Ai kishte një fytyrë pak si të hequr, po të hijshme dhe ekspresivë, që shprehte ndjenjat e

brendshme të një njeriu të pastër e të sinqertë. Sytë e tij të zez e pak si të futur ishin të qeshur e të mprehtë. Ata depërtonin thellë në botën e brendshme të partizanëve.

Ai ishte njeriu më i dashur për partizanët. Kudo dhe kurdoherë qëndronte pranë tyre dhe i mësonte e i ndihmonte ata. Me punën e tij të palodhur prej komunisti, ndizte në zemrat e partizanëve ndjenjën e urrejtjes së pashuar kundër armiqve dhe edukonte ndjenjat e dashurisë ndaj partisë, popullit dhe atdheut. Ai i edukonte partizanët me cilësitë e larta të moralit komunist.

Brahua nuk fliste shumë. Ai çdo gjë e bënte vetë dhe me shembullin e tij edukonte partizanët. Gjatë gjithë kohës, kudo që ishte ai kujdesej për jetën e partizanëve dhe gjithmonë qëndronte pranë tyre.

— Ç'farë njeriu është? — pëshpërisnin partizanët me njëri-tjetrin. — Si nuk lodhet njëherë, xhanëm! Me të gjithë duart në qafë! Nga e merr gjithë atë forcë?!

Partizanët kishin të drejtë të mendonin. Por, atij atë forcë të pashtershme ja jepte mëma e tij e madhe, partia!... Ajo e ushqente Brahon, si dhjetëra mijëra të tjerë, me idetë e saj revolucionare dhe i bënte të pamposhtur para çdo vështirësie.

Sa me zjarr fliste ai për partinë, për heroizmat që tregonin komunistët në përlëshje me armiqtë, për aksionet e guximshme që ata kryenin dhe si vdisnin heroikisht me fjalën e partisë në gojë.

Një ditë, Brahua, duke më shikuar në sy, më pyeti:

— A dëshiron të jesh komunist?

Unë për një çast mbeta si i hutuar.

— Po ne të gjithë komunistë jemi, — i thashë,
— përse ma thua këtë?!

Brahua, duke më rënë krahëve, m'u përgjegj menjëherë:

— Partizanët janë luftëtarë trima, luftojnë për çlirimin e vëndit, për vendosjen e pushtetit popullor, por, megjithatë komunistë nuk janë të gjithë. Komunistët janë më revolucionarë, më të përparuar në idetë e tyre, ata janë luftëtarët pararojë për fitoren e socializmit dhe të komunizmit... Komunistët janë pak, por ata do të shtohen me njerëz të rinj, që plotësojnë kushtet e nevojshme.

Ai vazhdoi, si me të qeshur, duke më shikuar me dashamirësi:

— Komunisti duhet të hidhet në sulm i pari, atje ku rreziku është më i madh!..

Pasi i dëgjova me vëmendje fjalët e tij, i thashë me gjysmë zëri, si i turpëruar:

— Më pëlqen shumë të jem komunist!

Ai më shikoi një çast, buzëqeshi dhe u largua.

— Ta hajë dreqi, ta hajë! — thashë me vete.
— Paskam qenë prapa dynjasë... Por fundja se mos dinim ne më parë. Sa i lumtur do të jem po të më pranojnë në parti!..

Tërë ato ditë kisha rënë në mendime të thella. Kisha qejf t'i tregoja shokut tim të ngushtë, por nuk guxoja. Ato ishin gjëra serioze, që s'duhej t'i merrte vesh njeri. Kështu, për disa herë me radhë, zëvendëskomisari bisedonte me mua, më lexonte libra, që, në atë kohë, unë i kuptoja me shumë vështirësi. Më fliste me optimizëm për të ardhmen, për komunizmin.

Pasi kaloi një kohë, më lajmëruan se më kishin kërkuar në komandë të kompanisë.

U mundova të gjeja shkakun pse po më thërrisnin dhe ashtu i menduar, u nisa.

Ishte një pasdite shtatori... Shokët e celulës ishin mbledhur në dhomën e një fshatari të varfër dhe po më prisnin mua. Kur hyra brenda, shtanga për një çast. Aty pashë edhe shokë të tjerë. Ata e kuptuan tronditjen time dhe, në mënyrë të përziermërt, më ftuan që të ulem. Unë kisha qenë dakord që të pranohesha në parti, por nuk e mendova se kjo ishte pikërisht mbledhja ku do të më pranonin mua. Shokët më buzëqeshnin dhe disa prej tyre më përshëndetnin me kokë dhe më uronin. Në atë çast ndjeja një ngrohtësi të madhe brenda në trup, por në të njëjtën kohë, gradualisht, po më pushtonte një ndjenjë e fortë gëzimi. Brahua, siç e kishte zakon, para se të fliste, fërkoji njëherë fytyrën me dorën e djathtë dhe nisi të ligjërojë plot temperament e shkathtësi:

— Shokë! Radhët e celulës sonë po shtohen edhe me një shok tjetër të ri. Ai ka pranuar të jetë anëtar i Partisë sonë të lavdishme Komuniste dhe, ashtu si të gjithë ne, do të luftojë e do të qëndrojë kurdoherë në pararojë të detyrave...

Pas tij e muarën fjalën edhe të tjerë. Në mes të atyre ndjenjave të thella që më kishin pushtuar, nuk munda të qëndroja më duarkryq. U mundova të shpreh gëzimin dhe kënaqësinë e madhe që ndjeja për këtë nder që po më bëhej, por nga emocioni m'u mblodh një lëmsh në grykë dhe me vështirësi i thashë ato pak fjalë të thjeshta. Kështu emri im në atë mbledhje u regjistrua në listën e komunistëve të celulës së kompanisë.

Pa mbaruar akoma nga diskutimet, një partizan hyri me shpejtësi në dhomë dhe njoftoi se kompa-

nia duhej të nisej në një drejtim të caktuar, sepse ishin parë forca gjermane.

Kompania, me shpejtësi, mori detyrën luftarake dhe në muzgun e asaj mbrëmjeje vjeshte filloi të zbresë tatëpjetë malit, për t'u vendosur në pritë. Gjermanët erdhën dhe përleshja filloi e ashpër. Kësaj radhe, në luftë, kisha një detyrë shumë të vështirë. Si komunist, duhej patjetër të jepja shembullin personal, të hidhesha në sulm i pari, siç më kishte thënë Brahua. «Sa krenari është të jesh anëtar partie, thoshja me vete, por, dhe kollaj s'është, ta mbash këtë titull!»

Të gjitha ato që më kish thënë Brahua për komunistët, i pashë pothuaj në këtë përpjekje që patëm me gjermanët. Brahua, Cani, Xhevdeti e të tjerë u hodhën të parët në sulm dhe të parët u përleshën me armikun. E si të mos hidheshin pastaj të gjithë partizanët në zjarr!

Kështu e kalova provën e parë si anëtar partie. Lufta nuk kishte mbaruar dhe përpara meje dilnin detyra edhe më të vështira. Por partia na mësonte dhe na edukonte me idetë e saj, të cilat të kalitnin dhe të jepnin forca për të qenë i pamposhtur. Brahua u bë njeriu më i dashur për mua dhe për të gjithë partizanët. Fjala e tij ngjallte tek ne shpresa dhe besim në fitore.

Ashtu si shumë komunistë të tjerë, që dhanë jetën në krye të detyrës në përleshje me spiunët fashistë dhe nën torturat më të egra të armiqve, ashtu dhe Braho Sakua ra heroikisht në fushën e betejës, duke luftuar në ballë të sulmit, duke u prirë si gjithmonë partizanëve përpara.

Por, kur «urratë» e forta të ish partizanëve të rreshtuar shpërthyen në një entuziazëm të papër-

mbajtur dhe jehona çau thellë në grykat e atyre maleve kryelartë, ndjeva një krenari të ligjshme dhe zëri im u bashkua me ata të qindra e mijëra njerëzve që ndodheshin në atë jubile të brigadës. Këto «urra» të forta tingëlluan si një betim solemn, për të ecur përpara drejt horizonteve të reja.

LETTA E SHITES

15 janar i vitit 1944 ishte një ditë shumë e bukur. Delli me rrezet e tij të ngrohta shpërthente nën mbulimin e brigadës së tretë sovjetike. Në këto ditë të bukura, por shumë të ngushta, për ndoshtë në krahinën Priskë një pjesë mikroparashutistëve partizanë, megjithëse ndodheshin vetëm pak kilometra larg kryeqytetit.

Komiteti qendror i partisë për Tiranën, me anë të komitetit të brigadës njerëzore, se forca të mëdha gjermane e balliste po përgatiteshin për të sulmuar në besat bazat partizane në rajonin e Priskës. Me urdhrin të komandës së brigadës, batalionet u hapën në formacione të forta dhe në pozicione të dalta e të rrethuara. Në Priskë, ku partizanët të kalonin forcat e shtetit.

Aty rreth orës 14.00 në xhironë që shkonte nga Tirana në Llukë-Lana Bregës-Priskë u dukën një numër i madh krahesh dhe gomave të ngulitura me çësë dhe me materiale të ndryshme. Të parët që i parë këto lëvizje të dyshimta në xhironë, partizanët e kompanisë së parë të batalionit të parë të komandoheshin nga trupi me fletë komanduese. Lëvizja e parë u raportua shpejt të brigadës për lëvizjet e dyshimta, kompania u përgatit për

LUFTA E SELBËS

15 janari i vitit 1944, ishte një ditë shumë e bukur. Dielli me rrezet e tij të ngrohta gjallëronte jetën mbi tokë. Efektivi i Brigadës së tretë sulmuese, në këtë ditë të bukur, por shumë të ftohtë, ishte vendosur në fshatin Priskë, një bazë mikpritëse për partizanët, megjithëqë ndodhej vetëm pak kilometra larg kryeqytetit.

Komiteti qarkor i partisë për Tiranën, me anën e korierit të brigadës njoftoi se forca të mëdha gjermane e balliste po përgatiteshin, për të sulmuar në befasi bazat partizane në rajonin e Priskës. Me urdhër të komandës së brigadës, batalionet u hapën në formacione luftimi dhe zunë pozicione në qafat e rrugëve kryesore, ku priteshin të kalonin forcat e armikut.

Aty rreth orës 14.00, në xhadenë që shkonte nga Tirana në Linxë-Lana-Bregas-Priskë, u dukën një numër i madh kuajsh dhe gomarësh të ngarkuar me thasë dhe me materiale të ndryshme. Të parët, që i panë këto lëvizje të dyshimta në xhade, ishin partizanët e kompanisë së parë, të batalionit të parë, që komandohej nga trimi me fletë, komunisti Myslym Keta. Pasi ju raportua shtabit të brigadës për lëvizjet e dyshimta, kompania u përgatit për

sulm. Lymi rregulloi pozicionin e mitralozit «Shars», me anën e të cilit do të jepej sinjali, për hapjen e zjarrit. Me dylbitë e tij, ai vrojtonte kolonën e kafshëve që po afroheshin. Kafshët shoqëroheshin vetëm nga fshatarë të paarmatosur. Papritur ai njo-hu njërin nga shokët që shoqëronin kolonën dhe atëhere kuptoi se ishin shokët, që po ktheheshin nga Tirana, pas një aksioni të guximshëm që kishin bërë në qendër të kryeqytetit. Gëzimi ishte i madh, por prapë Lymi, duke pasur parasysh porosinë e partisë për vigjilencë, pasi la tri skuadra në pozicione, me njërin skuadër, që udhëhiqte vetë, u doli shokëve përpara. Takimi ishte i përzemërt dhe arriti kulmin, kur Lymi me partizanët panë rrobat, këpucët dhe fanellat e leshta që shokët kishin sjellë nga Tirana. Ato ishin me shumicë dhe mjaftonin për gjithë partizanët e brigadës. Veç kësaj, ato vinin në një kohë kritike, në kohën që priteshin nga çasti në çast forcat gjermano-balliste. Si do që të ndodhte puna, partizanët tani do të luftonin me forca të shumëfishuara.

Lajmi i gëzuar i mbërritjes së shokëve nga Tirana dhe i rrobave e këpucëve, që sollën ata, u përhap në gjithë brigadën. U vunë në lëvizje intendentët e batalioneve dhe kompanive dhe brenda dy orësh rrobat dhe këpucët ju ndanë partizanëve.

Në mbrëmjen shumë të ftohtë të asaj dite të bukur, u dha alarmi në tërë brigadën. Batalionet u rreshtuan në vendet e caktuara, të gatshëm për marshim e luftim. Batalioni i parë mori urdhër që të siguronte pararojën dhe të nisej në drejtim të Qafës së Selbës. Në pararojë u caktua kompania e parë dhe pas një marshimi prej dy orësh mbërriti në fshatin Selbë, një bazë shumë e mirë e luftës sonë.

Partizanët u shpërndanë nëpër shtëpitë e fshatit, sipas kompanive. Edhe një herë, rreth vatrave të fshatarëve, partizanët propaganduan punën e madhe që bënte partia për çlirimin e vendit, për përmbysjen e pushtetit të bejlerëve e të çifligarëve dhe për vendosjen e pushtetit popullor. Nuk më harrohet fjala e shtruar dhe bindëse e Lymit me fshatarët, të cilët e donin dhe e dëgjonin.

Aty nga mesnata, në shtëpinë që ishte vendosur shtabi i kompanisë së parë, korieri i shtabit të batalionit, solli një letër, ku, pasi sqarohej mirë situata e krijuar, thuhej se disa forca balliste, të komanduara nga tradhëtari i popullit, krimineli Sul Selimi, ishin nisur në drejtimin tonë. Kompania jonë urdhërohej të zinte me shpejtësi të madhe Qafën e Selbës dhe ta mbante atë, derisa të mblidheshin gjithë forcat, pasi pushtimi i saj nga gjermanët rrezikonte brigadën, që ishte vendosur në Selbë.

U dha alarmi. Efektivi i kompanisë, me shpejtësi të madhe u ngrit dhe u vu në gatishmëri. Komandanti, me pak fjalë, sqaroi situatën e krijuar, vuri detyrën dhe kompania u nis për në objektivin e caktuar. Karakteristike ishte që partizanët e pritën me gëzim të madh aksionin kundër gjermanëve. Si gjithmonë, kompaninë e udhëhiqte komandanti i saj, Lymi me mitralozin «Shars» në krahë. Ishte thjeshtësia, guximi dhe urtësia e tij, që i frymëzoi partizanët të hidheshin në luftë me guxim.

Kompania manovroi me vrull, në përshtatje me situatën e krijuar dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, zuri objektivin e caktuar, para se atë ta zinin forcat gjermano-balliste. Kjo siguroi tërheqjen me sukses të të gjitha forcave të brigadës, duke i shpëtuar edhe një herë nga kurthi i rrethimit, që

kishte përgatitur me aq kujdes, komanda gjermane në zyrat e Hotel Dajtit. Edhe një herë tjetër dështuan me turp oficerët e akademive hitleriane, triumfoi talenti i komandës partizane, triumfoi populli i udhëhequr nga partia.

Zënja në kohën e duhur e Qafës së Selbës nga forcat tona i pengoi shumë forcat gjermano-balliste, për t'u futur në Selbë nga rruga më e shkurtër. Kështu që gjermanët u detyruan të zbatonin variantin e dytë, goditjen kryesore ta jepnin me forcat që do të kalonin nga Qafa e Priskës.

Në mëngjezin e 16 janarit, një kolonë gjermane me rreth 200-250 veta, që do të sulmonte në drejtim të Qafës së Priskës dhe një kolonë tjetër me mercenarë të regjimentit «Kosova» me rreth 200 veta, që do të sulmonte në drejtimin Tiranë-Gurrë-Selbë dhe forcat balliste, të komanduara nga kriminelin Sul Selimi, u nisën në drejtimin tonë.

Manovra e shkëlqyer, që kryen forcat e brigadës, bëri që të vihen në pozita rrethimi vetë forcat gjermano-balliste, dhe kjo u bë pa e kuptuar ata fare. Dhe pikërisht, kur kishin përfunduar rrethimin e afërt të fshatit dhe po bënë planin se si të asgjësonin të gjitha forcat e brigadës, skuadra sulmuese e kompanisë së parë, e pajisur me automatikë dhe granata dore, e komanduar nga Lymi, sulmoi në befasi një grup gjermanë, që po ngroheshin rreth një zjarri që kishin bërë në një gropë në veriperëndim të fshatit. Kjo goditje e befasishme i tronditi shumë gjermanët. Ata lanë në këtë përpjekje mbi 10-15 të vrarë, kurse nga ana jonë nuk pati asnjë humbje.

Pas këtij sulmi të befasishtëm dhe të guximshëm, gjermanët e kuptuan se ishin të rrethuar dhe

u detyruan të çanin rrethimin, duke sulmuar pozicionet tona në qafën e Selbës dhe atë të Priskës. Kundra-sulmet e partizanëve e detyruan armikun të tërhiqej në panik, duke lënë 10 të vrarë e të plagosur në fushën e betejës. Nga radhët tona, ranë në fushën e luftës, duke luftuar me trimëri për çlirimin e atdheut dhe të popullit, Muhamet Bakiri dhe Gaço Vinjau.

Në këto luftime u dallua Lymi, që ndodhej në vijën e parë, atje ku ishte rreziku më i madh.

LAVDI TRIMAVE

Yjet po shuheshin në qiellin pa re, atë mëngjez shtatori. të vitit dyzet e katër. Tutje, në kodrat e veshura me shqopë, përballë fabrikës së alkoolit, filluan të dalloheshin siluetat e rojeve gjermane. Dy fishekë të kuq shenjdhënës u hodhën prej kazer-mave të Krastës e u pasuan nga qindra të tjerë, që bubullitën prapa nesh, në kodrat e Labinotit.

— E filluan pa gdhirë mirë, — tha Lutua e tundi kokën e qethur me maqinë zero. — S'mendojnë se na kanë pranë hundës dhe goditin pozicionet e djeshme, — vazhdoi ai si nëpër dhëmbë dhe shikoi Balilin që diç po shënonte në një blok të vogël.

Nënkomandanti i batalionit, Balil Peçi, ktheu fytyrën e zeshkët, fërkoj fort ballin e gjerë me dorën e djathtë, si të donte të sheshonte dy rrudhat që e përshkonin, u ngrit pak në gjunjë dhe, si vështroi një copë herë përmes gjetheve ku ish strukur, lart nga Labinoti, pëshpëriti: Po vonon kompania e dytë!..

Në pritje të sinjalit të sulmit, po soditnim shtrirë qytetin e Elbasanit. Sa afër ishim! Vite të tëra në male, gërxhe e fshatra, kurse ja, tani ndodheshim në dyert e një qyteti të madh.

— Sot do t'i bëjmë fërtele. Pa le në zënçim

dhe autobлиндën që patrullon!.. — tha Sulo Arëza duke mbyllur përgjysmë sytë e zez nën rrezet e para të diellit.

— Unë them se po erdhi batalioni tjetër, drekën do ta hamë në Elbasan. Mori fund nemcja. Nuk e shikon që s'ja mban të nxjerrë kokën fare nga llogorja?

— Vetëm me artileri qëllon i paudhi, — u përgjegj Tefiku dhe tundi nja dy herë kokën, nxori kurtinë e drodhi një cigare.

— Mos e ndiz! — i tha shkurt Balili i vrenjtur në fytyrë. Po, me që e preku shikimi i hutuar i partizanit, vuri buzën në gaz dhe shtoi: U vonuam! .. Ndize në qoftë se t'u ça hunda, vetëm tymin mos e nxirr si oxhak!..

Lutua shikoi orën, kafshoi gishtin e madh të dorës së majtë dhe sytë i nguli në kodrën përpara dhe dhathtas. «Tanët?! Jo, më duket se po na marrin krahët!..» U zvarris më tutje.

«Gjermanët! U paskan ardhur forca të reja... Eh, dreq!..»

— Balil!

— Ç'ke, o Luto?

Nënkomandanti i batalionit u afrua dhe të dy shokët, për një çast, shikuan njëri-tjetrin të habitur.

— Si është e mundur, andej duhej të vinin forcat tona?! — pëshpëriti Balili.

Lutua ngriti supet e s'u përgjegj.

Artileria armike e mbarti zjarrin fare pranë kompanisë. Predha të veçuara kalonin majën dhe pëlcisnin poshtë në luginën e blertë të mbushur me pjergulla, që gati po rrëzoheshin nga rrushtë e shumtë.

— O nane! — ...e-e, o-o-o! — u dëgjua një zë fëmije që po qante.

— T'i sulmojmë, papritur kompaninë tjetër! Unë i këtij mendimi jam, — tha Lutua.

Balili nuk e dëgjo. Ajo klithmë fëmije që po qante i therte në zemër.

«Këtej populli është shpërngulur. T'u ketë shpëtuar prindërve vogëlushi? Mos është plagosur vallë? Të jetë njeri tjetër me të?...»

— Shikoni, shikoni atë fëmijë si po rend, përmes tymit të predhave! Do të vritet i shkreti! — tha **Xhezo Proda dhe shtrëngoi fort qytën e mitralozit.**

Balili s'pritti më, rrëmbeu automatikun dhe rrëshqiti poshtë kodrës. Koka i dukej hera-herës përmes gjetheve. Pa kaluar as njëqind hapa, e dik-tuan gjermanët dhe hapën zjarr mbi të. Ai, si sor-kadh mali, dredhonte e përgjegjej me breshëri të shkurtëra.

Kur u kthye, djersa i kish dalë mbi xhaketën prej shajaku, po fytyra e zeshkët i shndriste prej gëzimit.

— E solle? — e pyetën tre-katër shokë në një gojë.

— Po, e lashë tek intendent. Është nja pesë a gjashtë vjeç...

Shpjegime të tjera nuk muarëm dot, se në atë çast predhat armike plasën rreth e rrotull nesh.

— Tani do të ngatërrohet fare kompania e dytë edhe në ardhtë. Si do merremi vesh me të? Dërgo nja dy shokë prapa të vrojtojnë, o Bektash, se nëm-cja paska vendosur sot t'i boshatisë depot nga pre-dhat! — i tha Balili komisarit.

— Bajram! Tefik!

— E kuptuam, shoku komisar, po nisemi! — tha Bajrami që ishte aty pranë dhe, i përkulur, kapërceu një hendek të vogël e filloi t'i ngjitej kodrës, por vala e fuqishme e shpërthimit të dy predhave e rrëzoi të vdekur në vend.

— Shtjerë një herë me atë shenjdhënësen! Ndoshta e shohin shokët e kompanisë së dytë dhe sulmojnë drejt në ecje, se po na afrohen forca të mëdha, — tha prapë Balili.

Lutua qëlloi dy herë. Drita jeshile u shua mbi kodrën ku forcat armike përgatiteshin për sulm. Pas pak, u ngritën pìrgje dheu së bashku me tym predhash.

U habitëm. Siç duket, ky sinjal kish qenë për tregim objektivash nga këmbësoria fashiste artilerisë së vet.

Tani, të qetë e të gëzuar, shikonim se si po cëpëtohej armiku nga predhat e veta.

— Do ta marrin vesh gabimin, po më mirë, hajde t'i sulmojmë në këtë gjurulldi! — propozoi Lutua.

Balili shikoi me vëmendje djathtas.

— Po vijnë shokët! — thirri ai dhe me zë të lartë dha komandën që të hidheshim në sulm.

— Para Brigadë e gjashtë!...

— Para partizanë!...

Fashistët, që me goditjen e parë, u tërhoqën në panik e çrregullim të plotë.

Forca të reja gjermane u nisën nga Elbasani. Aty mbi kodrat e Labinotit të poshtëm, u ndeshëm me to.

— Para partiza... — thirri komandanti i kompanisë Luto Çani, po fjalën ja preu në mes breshëria e mitralozit armik. Atë e rrëmbeu përkrahësh Sulo Arëza dhe, pa e lëshuar (se dyshonte se nuk kishte vdekur), shtinte në ecje derisa u përmbys me të bashkë i goditur dhe vetë nga dy plumba në kokë.

Balili e pa mitralierin armik tek vendoste shiritin e ri dhe shtiu në atë drejtim. Gjermani nuk lëvizi fare. Plumbat e automatikut, siç duket, nuk arrinin deri atje. Atëhere nënkomandanti trim, me disa lëvizje të shpejta, u hodh buzë një rrëkeje, eci këmba-dorazi ndonjë qind metra dhe doli në një çukë të vogël. U ngrit përgjysmë. Kompania e dytë, me sulm të rrufeshëm, e kishte vënë armikun përpara. Ai ktheu sytë prapa. Një shok tjetër u rrëzua nga kompania e parë. Mitralierin armik s'po e shikonte. E drejtoi trupin e derdhur dhe, as pesëdhjetë metra para tij, pa atë që kërkonte. Kryqëzuan shikimet, Balili, më i shpjetë, ja zbrazi gjithë karikatorin gjermanit. Ngriti dorën e fuqishme, por s'mundi të thoshte «para...», siç dëshironte, se një plumb armik e shkëputi përgjithmonë nga ne. Ai ra me grusht përpara e me automatik shtrënguar sikur donte të na thoshte: Vazhdoni, mos e ndalni sulmin derisa ta çlironi të gjithë atdheun!

«U vra Balil Peçi!»! Ky lajm u përhap me shpejtësi të rrufeshme në gjithë batalionin. Edhe shokët e intendencës u hodhën në radhët e para të sulmonjësve. Kushdo kërkonte t'ja merrte hakun vetë.

Kur muzgu lëshoi vellon e zezë, i varrosëm të nëntë dëshmorët në një bregore të bukur. Rreth

e rrotull shtriheshin kufomat e më shumë se tetëdhjetë gjermanëve.

Lavdi përjetë trimave! — shkroi dikush me gurë të bardhë anës së varrit atë natë. Gurët u zhdukën, por shkrimi mbeti mbi lapidarin e ngrihur nga populli më vonë.

ZBULUESIT

Më 23 mars të vitit 1944, partizanët mbyllën rrugën në Qafën e Hoxhajt. Gjermanët, në pamundësi kalimi, mbetën në fushën e Peshtanit dhe u detyruan të luftonin pa mundur të zinin ose të ndërtonin pozicione. Kur panë, se çdo rezistencë ishte e kotë dhe rrugë tjetër për t'u tërhequr nuk kishin, gjermanët tentuan të kalonin lumin e Osumit. Por partizanët filluan sulmin dhe nisën t'i qëllonin nga afër. U bë një kasaphanë e vërtetë. Dhjetëra gjermanë mbetën të vrarë.

Ne, pasi e kryem me sukses këtë aksion, u kthyem në bazën e nisjes. Këtu nuk qëndruam shumë. Në orët e mesditës u nisëm për në fshatin Dobronik, për të pritur gjermanët.

Dimri, megjithëse i kishte ardhur fundi, nuk po dorëzohej. Shiu vazhdonte të binte. Nga gryka e Tomorrit vinte një erë e ftohtë. Shtrati i lumit të Osumit ishte mbushur plot e përplot. Por ne duhej të udhëtonim, duhej të kalonim matanë.

Kur ju afruam Osumit, dielli akoma s'kishte perënduar. Jo shumë larg nesh, gjarpëronte rruga automobilistike. Të kapur dorë më dorë, çamë dallgët e lumit të rrëmbyeshëm, të cilat përplaseshin në gjokset tona.

Pas tri orësh udhëtimi, herë shpateve të ko-

drave dhe herë rrugës së këmbësorëve, në mbrëmje arritëm në fshat.

Skuadrat u vendosën në pozicione për qark fshatit. Armiku nuk ndihej. Qëndruam në pritje. Po kalonte nata dhe gjermanët nuk po dukeshin.

Po gdhihej 24 marsi. Gjermanët filluan të qëllonin shpesh me artileri në drejtim të kodrës së Dobronikut dhe vazhduan gjatë gjithë ditës. Predhat fishkëllonin mbi kokat tona dhe pëlcisnin matanë kodrës. Sapo u err, u informuam se forcat armike kishin kohë që kishin dalë nga qyteti. Informatori nuk dinte se deri ku kishte mbërritur armiku dhe për ku drejtohej. Pra, duhej zbuluar lëvizja dhe qëllimi i tij, prandaj u nisën dy partizanë, Dervishi e Lluka, për të siguruar të dhëna të sakta.

Të dy partizanët u zhdukën në errësirën e natës.

Kaluan dy orë, por as Dervishi as Lluka nuk u kthyen. Befas, u dëgjuan krisma pushkësh.

— Gati, shokë! — foli komandanti.

Atë çast pamë të vinte drejt nesh, duke rendur, Lluka. Të gjithëve na shkoi mendja menjëherë te Dervishi. Ç'i kishte ndodhur vallë?

Ja se çfarë na tregoi Lluka për Dervishin:

«Sapo filloi të agonte dita, ne, të fshehur në pyllin që gjendet matanë, e pamë armikun. Ishin rreth 50-60 gjermanë dhe po aq ballistë. Qëndruam ca kohë, duke vërejtur lëvizjet e tyre. Dervishi, për të parë më mirë, hypi në një pemë. Por nga pesha e tij një degë u thye dhe krismën e saj e dëgjuan gjermanët, që s'ishin shumë larg, rreth 400-500 m, dhe filluan të na qëllonin me pushkë e mitraloza. S'na mbetej gjë tjetër, veçse të ktheheshim. Por në këtë kohë Dervishi lëshoi një rënkim të mbytur.

U ktheva nga ai, me që ndodhesha përpara, dhe pasë Dervishin, që ishte ulur më gjunjë dhe po shtrëngonte mesin.

— Ç'pate? — i thashë.

— Hiç! — m'u përgjegj Dervishi.

Nuk prita më gjatë, po e rrëmbeva për mesi dhe fillova ta tërheq buzë përroit. Ndërkaq, drejt nesh, duke qëlluar, u vërsulën një grup gjermanësh. Dervishi kërkonte që ta lija. Pandeha mos e kishte nga dhimbjet dhe u mundova ta merrja në krahë, por ai nuk pranoi dhe më tha:

— Ti do të nisësh vetëm dhe raportoi komandës se çfarë pamë! Thuaju të qëndrojnë të fortë dhe të më marrin hakun!

U çudita nga fjalët e tij. Në çast fishkëllyen mbi kokat tona plumbat e një mitralozi dhe pas tyre plasi një predhë mortaje. Ndërkohë dhe gjermanët, që po na ndiqnin, hapën zjarr.

— Na futën në mes, po o burra, shpejt nisu, të paktën shpëto ti! — më tha Dervishi.

Nuk doja ta lija vetëm, por Dervishi, pas disa çasteve më kapi për krahu e më tha:

— Po sikur të vritesh edhe ti, kush do t'i lajmërojë shokët? Atje s'pret një, por njëqind, prandaj nisu!

Me që unë nuk po bindesha, ai m'u drejtua duke më thënë:

— Unë jam skuadërkomandant dhe ti duhet të më bindesh, prandaj të urdhëroj të nisësh! Unë këtu do t'ju pres dhe sa të jem gjallë, gjermanët nuk kam për t'i lënë të bëjnë asnjë çap përpara. Do të luftoj deri në fishekun e fundit, — dhe zuri pozicion.

Para se të largohesha, i hodha një sy plagës së tij dhe me që akoma i rridhte gjak, ja lidha me

një copë që grisa nga këmisha ime, dhe u nisa. Pas pak dëgjova krisma pushkësh e të shtënat e një mitralozi dhe, pas tyre, krismën e vetmuar të automatikut të Dervishit. Dyluftimi vazhdonte. . . »

Komandanti dha urdhër të hapeshim në pozicione.

Kur ja, gjermanët filluan t'i ngjiteshin kodrës.

Nga të gjitha anët ushtoi thirrja: «Para partizanë!» Shokët e Dervishit u hodhën në sulm. Ata u përleshën me gjermanët, të cilët u tërhoqën në panik, duke lënë disa të vrarë. Kur mbërritën në majën e kodrës, panë Dervishin të shtrirë për tokë. Edhe i vdekur, s'e kishte lëshuar automatikun nga dora.

I riu komunist Dervish Dulja u nda nga shokët përgjithmonë, por kujtimi dhe shembulli i tij i frymëzuan në betejat e tjera.

NË VARGUN E BETEJAVE

Ishte ditë vjeshte. Shiu vazhdonte të binte si me gjyma dhe herë pas here dëgjoheshin krismat e bubullimave. Sa kishim lënë Peqinin, përpara nesh, nga krahu i majtë, u duk vargu i kodrave të veshura me ullinj.

— Të jenë ato kodra? — thashë me vete. — Sa paskan ndryshuar! Ato ishin kthyer në toka pjellore.

Ndërsa treni po gjarpëronte me shpejtësi në drejtim të Elbasanit, kujtimet e atyre ditëve të stuhishme filluan të më ringjallen.

Sa kishte hyrë muaji nëntor i vitit 1944 dhe Brigada XII sulmuese kish marrë urdhër të nisej për në Veri.

Pas një marshimi të gjatë e të lodhshëm, në përpjekje të vazhdueshme me fashistët dhe forcat e reaksionit, brigada arriti në brigjet e Shkumbinit. Shiu binte i rrëmbyeshëm e pa pushim. Shkumbini sa vinte e shtohet më tepër. Ai dukej shumë i egërsuar dhe dallgët e tij përplaseshin sa nga një anë në tjetrën. Nata po afrohej.

Përtej lumit, në xhade, herë pas here kalonte ndonjë motoçikletë gjermane.

Brigada mori urdhër të kalonte me shpejtësi

Shkumbinin. Partizanët e batalionit të parë kishin pak minuta që kishin arritur. Disa ishin shtrirë për t'u çlodhur dhe disa të tjerë po sodisnin lumin e turbulluar.

Me gjithë kohën e vështirë dhe lodhjen e madhe, partizanët, të mbledhur në grupe, filluan të këndonin këngë, ashtu siç bënin para çdo aksioni. Jehona e këtyre këngëve bashkohej me oshëtimën e dallgëve të Shkumbinit dhe i çonte si lajmëtarë përmes fushave dhe maleve të atdheut.

Partizanët nuk u çliruan nga rrypat e gjerda-nëve. Ata prisnin, nga çasti në çast, të përlesheshin me dallgët e egërsuara të Shkumbinit.

Dhe ja, më së fundi, urdhëri u dha! Komandanti i batalionit, Shefit Hekali, urdhëroi që batalioni të kalonte lumin dhe me shpejtësi të vendosej në krah të xhadesë që vinte nga Elbasani.

— Me kujdes, shokë! — vazhdoi Shefiti. — Lumi ka dalë shumë, prandaj caktoni skuadra notarësh, për të ndihmuar shokët!..

Shukua i vogël, që i dilte pushka gjysmë metri mbi kokë, belbëzoi si me gjysmë zëri:

— Ne nuk kemi frikë nga gjermanët e jo nga lumi. Pastaj edhe Vjosën kështu e kaluam..

Komandanti i kompanisë, Cania, që u ndodh aty pranë, duke dëgjuar fjalët e Shukos së vogël, buzë-qeshi dhe i ra me dorë krahëve, sikur të ishte babai i tij.

— Edhe lumi, po nuk dite ta kalosh, nuk është më pak i rrezikshëm se armiku, — i tha ai, dhe, pasi u largua disa hapa, doli në krye të kompanisë.

— Kush di not, të dalë përpara! — urdhëroi komandanti.

Me shpejtësi, disa partizanë u rreshtuan para kompanisë.

Pasi komandanti i kompanisë u dha udhëzimet e nevojshme, ata filluan menjëherë nga detyra. Kështu vazhduan edhe kompanitë e tjera.

Zëri i Shefitit u dëgjua përsëri:

— Pas meje, shokë, për kalimin e lumit!

Partizanët, të zënë dorë për dorë dhe, duke përdorur litarë nga të kafshëve, vazhduan të çanin përpara.

Herë pas here Shefiti, megjithëse ujët i vajti deri në fyt, kthente kokën dhe u jepte kurajë partizanëve. Midis atij karvani të gjatë kishte nga ata, si Shukua, Violeta, etj., që nuk u takonin fare këmbët në tokë. Nuk ishte gjë e lehtë të kalohej Shkumbini. Megjithatë, partizanët as që donin t'ja dinin. Në përleshje me dallgët buçiste kënga partizane. Dhe partizanët e batalionit dhe të gjithë brigadës, duke u rrokur fort njëri pas tjetrit, e kaluan lumin pa asnjë humbje.

Shiu vazhdonte pa ndërprerje. Nata ra dhe me pëlhurën e saj të zezë mbuloi gjithshka. Nuk dije ku të hidhje këmbën. Partizanët ishin të lagur, që nga koka deri te këmbët, të lodhur e të pangrënë, por ata e kishin moralin të lartë dhe as që donin t'ja dinin.

Sipas urdhërit, partizanët ishin vendosur në pozicione shumë afër xhadesë dhe qëndronin të qetë në gatishmëri, tamam si ai gjuetari i mirë që pret gjahun të dalë në pritë. Aty pranë u dëgjua zëri i Shefitit, i cili kontrollonte vendosjen e partizanëve. Ai, duke vazhduar në drejtimin tonë, gati sa nuk e shkeli Violetën e vogël, e cila ishte vendosur midis baltës në krah të shokëve. Komandanti e

urdhëroi të largohej nga balta, por ajo nuk luajti nga vendi.

— Njëlloj është kudo, shoku komandant, — tha ajo. — Ky është pozicion më i përshtatshëm për të luftuar.

Ajo vazhdoi të qëndronte ashtu siç ishte e shtrirë mbi automatikun e saj, të cilin e mbante fort me duart e vogla, që i kishin ngrirë nga të ftohtit e asaj nate nëntori.

Shefiti nuk u çudit me partizanen e vogël, sepse të tilla përgjegje kish marrë edhe nga shumë të tjerë...

Po afronte mesi i asaj nate vjeshte të ftohtë e me shi. Zhurma monotone e shiut dhe e erës u prish nga pushkët e para të partizanëve të batalionit të tretë, që ishte vendosur në krahun tonë të majtë. Krismat e pushkëve dhe të mitralozëve sa vinin e shtoheshin. Oshëtima e tyre bashkohej gjithnjë e më shumë me zhurmën e madhe të autobлиндave.

Lufta po bëhej më e ashpër. Forcat gjermane po afroreshin në rajonin ku ishte vendosur batalioni ynë. Në xhade kalonin maqinat njëra pas tjetrës. Dritat e tyre në atë natë të errët çanin si prozhektorë dhe të verbonin sytë.

Ja, më së fundi, autoblinda e parë arriti para pozicioneve tona dhe filloi të shtinte pa pushim. Predhat e armikut vërshëllenin mbi pozicionet tona. Maqinat, të mbushura plot me ushtarë, filluan të kalonin njëra pas tjetrës. Partizanët prisnin urdhër. Në këtë kohë komandanti i batalionit, që ndodhej aty pranë, në vijën e parë, thirri me të madhe: «Para partizanë!» Ky ishte sinjali, të cilin, partizanët, në fillimin e çdo beteje, e prisnin me padurim.

«Para partizanë!» — u pasua me shpejtësi rru-

feje nga të gjithë komandantët. Kjo thirrje luftarake u pleks me «urratë» e forta të partizanëve, të cilët u vërsulën me shpejtësi mbi kolonën armike dhe u përleshën fytafyt me gjermanët.

Lufta vazhdoi e ashpër deri afër mëngjezit. Forcat gjermane sa vinin e shtoheshin.

Autokolona armike, e përbërë nga 500-600 maqina dhe 7000 ushtarë kërkonte me çdo kusht të vazhdonte rrugën në drejtim të Peqinit, për t'u ardhur në ndihmë forcave të rrethuara në Tiranë.

Detyra që kishte marrë Brigada XII sulmuese ishte që t'u shkaktonte sa më shumë humbje forcave gjermane dhe ta pengonte sa më tepër lëvizjen e tyre. Prandaj forcat gjermane, disa herë me radhë u përpoqën t'i shkëputen kontaktit me forcat tona, por partizanët e batalionit të katërt, që ishin në drejtim të Peqinit, duke luftuar me heroizëm, bënë që të dështonin përpjekjet e armiqve. Atë mëngjez, partizanët, duke përfituar nga errësira, u tërhoqën në kodrat, që shtriheshin në krah dhe, prej këtej, qëlluan pa pushim forcat gjermane që kishin zënë pozicione gjatë xhadesë.

Lufta vazhdoi pa pushim gjithë ditën dhe gjithë natën. Qysh në mëngjez herët u dha urdhëri që të pregatiteshin për sulm. Gjermanët vazhdonin të rrihnin me artileri kodrat, ku ishin vendosur partizanët dhe sidomos krahun në drejtim të Peqinit. Partizanët s'i mbantë vendi nga gëzimi.

Ata mendonin se kësaj radhe do t'i lanin hesapet me autokolonën gjermane. Para se t'u flitej partizanëve, u bënë mbledhjet e organizatave të partisë dhe të rinisë lidhur me detyrat që u delnin gjatë luftimit. Pastaj u bënë mbledhje të partizanëve dhe u bisedua me ta rreth kalimit në sulm.

Partizanët muarën pjesë aktivisht dhe me mendimet e tyre ndihmuan komandën, për ta organizuar sa më mirë sulmin. Shtabi i batalionit ishte ndarë nëpër kompani. Në kompaninë tonë, për të biseduar me ne, erdhi Shefiti.

— Ne kemi besim, shokë! — tha ai. — Megjithëse armiku ka forca të shumta, të pajisura me artilëri dhe tanksa, ne do ta shpartallojmë... Ne jemi shumë më të fortë se ai!..

Kur ishte puna për të sulmuar, ai shkante vetë i pari dhe me shembullin e tij personal, i printe partizanët në fitore. Kështu veproi edhe atë ditë.

Partizanët u vendosën në pozicione, të gatshëm për t'u hedhur në sulm. Ata, të emocionuar nga gëzimi, bisedonin me njëri-tjetrin e, pa lëvizur nga pozicionet, prisnin sinjalin e zakonshëm.

Armët e rënda partizane rrihnin pa pushim pozicionet e armikut.

Nga shtabi i brigadës erdhi urdhëri për të filluar sulmin. Ra boria. Pastaj jehoi thirrja e fuqishme: «Para partizanë!» Partizanët u lëshuan si shigjeta dhe, duke kërcyer nga njëri pozicion në tjetrin, ju afruan xhadesë.

Partizanët, që nuk dinin se ç'ishte frika, u përleshën trup me trup dhe me bomba e granata u futën tmerrin gjermanëve. Edhe më me forcë u përsërit skena e ditës së parë. Në fushë dukej vetëm tymi e flaka. Përsëri filluan të digjen maqina. Ulërimat e gjermanëve të tmerruar dëgjoheshin nga të katër anët. Armiku, duke sjellur tanksa nga Peqini, u përpoq ta shpëtonte autokolonën që kishte marrë flakë. Por partizanët, me heroizëm të jashtëzakonshëm, duke përballuar sulmin e tanksave, mundën

ta shkëpusnin një pjesë të autokolonës dhe ta shpartallojnë.

Kur lufta ishte në mbarim e sipër dhe partizanëve po u buzëqeshte fitorja, u përhap si rrufeja lajmi se ishte vrarë Shefiti, komandanti i batalionit tonë. Ky lajm i hidhur bëri që partizanët të vërsuleshin më me tërbim mbi armiqtë. . .

Beteja mori fund. Armiku në këtë përleshje pësoi humbje të rënda. Përveç dëmeve të mëdha që pati në armatim dhe teknikë luftarake, ai la në fushën e luftës me qindra ushtarë dhe oficerë të vrarë e të zënë robër.

Kjo fitore e madhe mbi forcat armike i entuziazmoi shumë partizanët. Por ata, në këtë betejë, kishin humbur edhe shokë. Përpara tyre qëndronte i shtrirë trupi i Shefitit, i cili dukej sikur buzëqeshte dhe i uronte partizanët për fitoren. Në krah të tij ishte vendosur Braho Sakua, zëvendëskomisari i batalionit, e të tjerë.

Partizanët, të mbledhur për t'u dhënë lamtumirën e fundit shokëve të tyre, e ndjenë veten krenarë. Si zakonisht, ata u betuan para shokëve, që kishin rënë heroikisht në fushën e betejës, se do t'ua merrnin hakun.

SHOKË, VËLLEZËR!

Kur çeta e rinisë mori urdhërin për të organizuar mbrojtjen në qafën e Shënthanasit, afër katundit Fterë, në Borsh vazhdonte akoma përleshja me armikun. Pas dy ditëve e dy netëve të kaluara në zjarrin e luftës, pa gjumë e pa bukë, u ulëm të rregullonim pozicionet. Afër mëngjezit erdhën dhe forca të tjera. Fotua, që dukej akoma si ndonjë fëmijë i dobët, u shtri, hoqi opingat dhe filloi të fërkonte këmbët që i ishin bërë tërë gjak. Astriti zuri të pastronte pushkën. Qamili nisi të tregonte anekdota dhe ata, që ishin afër, qeshnin me gjithë zemër. Lufta akoma zhvillohej larg nesh, vetëm predha të veçuarra pëlcisnin herë pas here në kodrat përballë.

Dielli sapo kish dalë nga qafa e Mollës, kur u dukën tanksat gjermane që filluan të villnin zjarr. Që prapa tanksave, këmbësoria shtinte parreshtur me mitraloza e automatikë, më tepër për të shkaktuar panik në rreshtat tona se sa për të na dëmtuar. Ishin akoma larg. Pasi pushuan tanksat, filloi artilleria armike. Grumbuj dheu ngriheshin përpjetë dhe binin prapë poshtë së bashku me copat e vogla të çelikut. U dëgjuan rënkimet e para. Astriti u plagos që në fillim, po nuk donte të tërhiqej. Ta shkrep një herë të shkretën! — i thoshte ai komisarit.

Predhat e armikut binin afër nesh, kurse plumbat tanë nuk arrinin aq larg. Prisnim me grushte e dhëmbë të shtrënguar të fillonim sulmin. Armiku po na afrohej nga të gjitha anët. Plumbat e «sharrësve» këputnin gjethet e pemëve përreth, pastaj filluan bataretë tona. Fashistët hodhën në luftim forca të reja, Ne qëndronim të patundur, si kodra që mbronim. U vra Sulua, u plagos Llambi, gjermanët u futën thellë nga krahu i djathtë e po na merrnin krahun dhe ne prapë qëndronim.

Llambi me Astritin, duke u zvarrisur me këmbët e plagosura, rrëshqitën poshtë bregut me shqopa, mbërritën në buzë të përroit, shuan etjen me ujët e turbulluar prej shiut, që pati rënë gjithë natën, dhe u shtrinë, për të mbledhur pak forcat.

Lart, të shtënat u rralluan. Thellë, nga Ftera, dëgjohej krisma e «Sharrësve».

— U tërhoqën më duket, — tha Astriti e u mundua të ngrihej. Fytyra ju shtrëmbërua, lëshoi një «ah» dhe u përplas për tokë. Llambi s'levizi dot tare nga vendi. Këmbët nuk i urdhëronte më. Ca dhimbje të forta ndjeu t'i çanin zemrën kur bëri përpjekje, për të drejtuar trupin. Me dorë kapi ijen e djathtë, por e hoqi shpejt të njomur e të skuqur me gjakun, që vazhdonte t'i rridhte akoma i ngrohtë.

— Qenkam plagosur dhe këtu... sikur s'mjaf-tonin vetëm këmbët! Të jetë ky fundi, pa marrë as hakën? — pëshpëriti dhe mendja i shkoi te shokët, që vazhdonin, me siguri, të përlesheshin me armikun dhëmbë për dhëmbë dhe, për një çast, ju duk vetja sikur ishte midis tyre. «Po ata as që e dinë se ku jemi... Jo, jo, s'na gjejnë dot, edhe sikur të duan!...»

— Nuk na harrojnë, jo, do vijmë të na marrin!

— tha Astriti që ishte afruar duke u zvarisur, sikur t'i kish pikasur mendimet e shokut dhe me këmishën e vet të grisur rrypa-rrypa i lidhi plagën.

Të shtrirë midis gurëve të bardhë në atë buzë përroi, vendosën përpara tyre nga dy granata dhe pritën në heshtje. Që do të luftonin deri në frymëmarrjen e fundit dhe që të gjallë nuk do të binin në dorë të armikut, për këtë as që dyshonin te njëri-tjetri, por edhe një farë shprese shpëtimi e kishin. Dielli ishte në të perënduar. Nata po afronte. Mes gurgullimës së ujit, veshi i Astritit kapi një zhurmë, që, pas pak, e dëgjoi edhe Llambi. Nga fshati po zbrisnin drejt përroit njerëz e mushka: «Gjermanët!» — thanë të dy shokët e u futën me vështirësi në mes të shelgjeve. Granatat i mbajtën gati.

— Do vrasim e do vritemi, — tha Llambi ngadalë.

Astriti nuk fliste. Dhimbja e mundonte. Në mes të dhëmbëve të shtrënguar mbante heqësin e granatës. Larg, shumë larg, dëgjoheshin plásjet e predhave. Ku ishin shokët vallë? Fashistët u dhannë ujë mushkave dhe u kthyen prapë lart. Dy të plagosurit muarën frymë lirisht.

Kur hynë në mes të shelgjeve, grumbulluan gjithë fuqitë që u kishin mbetur. Tani nuk qenë më në gjendje të lëviznin.

«Si do të bëhej? Do të vdisnin këtu të harruar, larg shokëve?» Kjo pyetje i mundonte, por asnjëri nuk kishte guxim t'ja thoshte tjetrit.

Nga pylli u dëgjuan fjalë dhe këmbë njerëzish. Astriti nuk foli, mblodhi të gjitha forcat, u afrua duke u zvarisur, dhe e përqafoi shokun.

— Gjermanët përsëri?

— Ashtu më duket...

Llambi vendosi me gjakftohtësi në mes të dhëmbëve heqësin e granatës.

— O shokë! O shokë! — u dëgjua një zë nga pylli.

— Mos u përgjegj, mund të jenë ballistë! — tha Astriti.

— Llambi! Astrit!

— Këtu, këtu jemi, — folën të dy përnjëherësh dhe lot gëzimi u rrëshqitën faqeve.

Tarja, Abdyli dhe Fotua, tre djem të rinj e të dobët, do të merrnin në krahë të dy shokët e plagosur. Deri në Qafën e Dërrasës ishin rreth 12 km. Atje kishin zënë pozicionet e reja partizanët.

Duhej kaluar me kujdes nëpër zonën, që e kish pushtuar armiku.

— Na lini këtu! Më mirë të vdesim ne të dy, se të pestë bashkë, — tha Astriti.

Tarja e shikoi drejt në sy dhe, duke e hedhur mbi supet e tij, ju përgjegj me shaka: — Fli tani, biri im!

Gjatë natës, në heshtje, ata vazhdonin të ecnin nën hundën e gjermanëve. Të plagosurit nuk rënkounin. Shokët nuk ankoheshin për lodhjen e madhe.

— Po afrohemi! — tha Fotua.

— Alt! — u dëgjua një zë dhe po në këtë kohë një breshëri e tërë automatiku u zbraz mbi kokat e partizanëve.

Abdyli dhe Fotua, me të plagosurit në krahë, zbritën poshtë pyllit, kurse Tarja ju përgjegj zjarrit. Rojet gjermane hapën zjarr në të gjitha drejtimet. Fishekët gjurmëlënës e ndriçuan vendin, sikur të ishte mesi i ditës. Tarja, duke ndërruar pozicion, shtinte pa pushim, kurse shokët qenë larguar mjaft.

Pushka e Tares nuk dëgjohej më.

— Lëshonani këtu, shkoni merrni Taren, qoftë dhe i vrrarë! — tha Astriti.

— Ose të gjithë, ose asnjë! — shtoi Fotua.

Po në kohën që po bënin gati granatat, Tarja u afrua duke rendur dhe tha vetëm një fjalë:

— Përpara!

Pas ndonjë ore mbërritën te partizanët.

— Shokë, vëllezër! — tha Automatiku,¹⁾ duke i pushtuar e përçafuar të pestë me radhë. Nga gëzimi nuk e vazhdoi fjalën më gjatë. Vonë e muarën vesh të plagosurit se, për shpëtimin e tyre, kish dalë vullnetar çdo partizan i çetës.

1) «Automatiku» ishte pseudonimi i komandantit të çetës, Balil Peçit.

ZJARR MBI PEKISHT DHE ANË HOLTIT

Aty nga fillimi i muajit qershor i vitit 1944 forcat e Brigadës I sulmuese vepronin në zonat e Sulovës, Skraparit dhe të Pogradecit.

Në këtë kohë gjermanët po pregatisnin operacionin e qershorit të vitit 1944. Elbasani ishte një nga qendrat kryesore, prej nga ata do të marshonin, për të goditur forcat partizane në Jugë. Për këtë arsye bënë çdo ditë goditje me forca të pakta deri në kompani, për të zbuluar se ku ndodheshin forcat tona. Por forcat e batalionit I, që gjendeshin në afërsitë e qytetit të Elbasanit, kryesisht në rajonin e quajtur Shpati i dytë, në katundet Shtërmën, Gostinë, Cingaraj etj, bënë kundërgoditje dhe i detyronin të futeshin në qytet.

Pothuaj për çdo lëvizje të forcave armike, ne njoftoheshim menjëherë nga qyteti, nga shokët e gueriljeve dhe sidomos nga shokët e qarkorit të Elbasanit. Korrierë specialë mbërrinin e na njoftonin në kohë.

Kështu, një ditë gjermanët nisën një kompani zbulimi të përforcuar në rrugën automobilistike Elbasan-Gramsh. Ne, të informuar qysh më parë nga qyteti, bëmë një pritë në afërsitë e fshatit Drizë. Nga goditja e rrufeshme dhe e befasishme në vend

të hapët, në xhade, kompania gjermane gati u shkatërrua e gjitha. Një pjesë e mirë e gjermanëve u mbyt në lumin Devoll, duke dashur të shpëtojnë nga goditja jonë e fortë dhe e papritur. Edhe ata pak që shpëtuan, ikën në panik në drejtim të qytetit.

Pas kësaj goditjeje, forcat e batalionit I u ndanë në dy drejtime: një kompani u vendos në kodrat e quajtura Katorraj dhe dy kompanitë e tjera në fshatin Gekin, anëmbanë lumit të vogël të Holtit, afër Gramshit.

Shtabi i batalionit u informua se një kolonë gjermane ishte nisur për t'u hakmarrë për kompaninë e zhdukur disa ditë më parë.

Të nesërmen në mëngjes, aty nga ora 4.00, duket një kolonë e gjatë forcash ushtarake, e cila ecën ngadalë gjatë grykës së lumit të Holtit. Me t'u afruar, gjermanët filluan të qëllojnë me mortaja e artileri kodrat e anës së djathtë të lumit, ku ishte vendosur kompania jonë.

Për çudinë tonë predhat e armikut goditin dy kodra para nesh të veshura me pyll dushku të madh dhe të rrallë. Këto dy kodra ishin më të larta nga ajo ku ishim vendosur ne. Si duket këtë kodër me pyll të shkurtër dhe vende-vende të zhveshur krejt, gjermanët as që e kishin në hesap dhe goditnin pëllëmbë për pëllëmbë të dy kodrat e tjera, të cilat filluan të digjeshin nga plasja e predhëve me zjarr. Era binte tek ne afshin e zjarrit, erën e barutit dhe të tymit, që na digjte sytë.

Gjermanët vazhdonin të afroheshin mengadalë gjatë lumit. Kur i pamë nuk i njohëm fare. Ata ecnin të çrregullt, duke biseduar. Pushkët i kishin të hedhura kush në një krah e kush në tjetrin, kush

me tytë para e kush krahëqafë. Me pak fjalë ecnin tamam sikur të ishin partizanë. Në fillim nuk besuam të ishin gjermanë dhe i morëm për partizanë, sepse në atë drejtim prisnim të vinte edhe batalioni ynë i dytë.

Me një dylbi të madhe topi u përpoqëm t'i shikonim më qartë, por, nga që bënte vapë, dylbia i paraqiste njerëzit duke u dridhur dhe kështu nuk i dallonim mirë. Disa nga ata që futeshin lumit kishin hequr xhaketat, i kishin hedhur mbi pushkët dhe në qafë u dalloheshin shamitë e kuqe, ashtu si i mbanin të gjithë partizanët e Brigadës së parë sulmuese. Gjermanët ishin të sigurtë se në ato zona ndodheshin forcat e Brigadës së parë, prandaj edhe vepronin e visheshin me shenja si të asaj. Qëllimi ish që të mos kuptoheshin nga larg se kush ishin.

Dhe vërtet kështu ndodhi. Për një farë kohe menduam se këto forca ishin të batalionit të dytë, prandaj dhe u qetësuam. Por vrojtimin ama s'e ndërpreme. Lufta vetë na kish mësuar të mos besonim pa i verifikuar mirë edhe sikur të na thoshin se ishin partizanë të këtij ose atij reparti.

Sytë e të gjithë partizanëve ishin kthyer nga kolona që vinte shumë ngadalë. Secili gjykonte sipas tij, dikush thoshte se ishin partizanë të batalionit të dytë, dikush të Brigadës së pestë, të tjerë thoshin se s'ishin tanët. Në bisedë e sipër, në krye të kodrës, u mblodhën gati të gjithë partizanët me përjashtim të mitralierëve dhe rojeve që qëndronin në gatishmëri në pozicione.

Në çast u mblodh organizata e partisë e kompanisë dhe pas saj e gjithë kompania, për të shqyrtuar gjendjen kolektivisht. Mendimet ishin të shumta dhe kontradiktore, por asnjë përfundim s'i dhamë.

Në këtë kohë kolona kish dalë pas një kthese. E shikojmë. Është shumë e gjatë. Numërojmë dhe secilit i dalin rreth 600 vetë dhe 24 kafshë. Kolona ndaloi buzë arës dhe po pushonte e shkujdesur dhe e shpërndarë pa rregull. Mushkat kullotnin në grurë. Kjo gjë na bëri shumë përshtypje. Ne e dinim se partizanët kurrë nuk i linin kuajt e mushkat të hanin bukën e popullit. Përkundrazi e ruanin atë si sytë e ballit. Kjo gjë na bindi se ata ishin gjermanë dhe nuk gabuam.

Ndërkohë forcat gjermane afrohen pjesë-pjesë drejt nesh, por pa na diktuar. Nga kodrat sipër nesh fillojnë të afrohen edhe ballistët, të cilët menjëherë u vënë flakën shtëpive të fshatit Cingaraj, që na kish strehuar e ish lidhur me ne. Kështu, pra, dashur padashur kompania jonë qysh në orët e paraditës u vu midis dy forcave armike.

Lidhje me forca të tjera s'kishim. Kështu, çdo situatë do ta përballonim vetë. Shpirti luftarak, gjakftohtësia dhe vendosmëria e partizanëve ishin në kulm. Asnjë panik, asnjë pëshpëritje. Vetëm presim urdhërin të fillojmë betejën e pabarabartë, e presim atë me besim të plotë në fitore.

Gjermanët futen në afërsitë e kodrave të Çekinit, duke ndjekur anën e lumit, kurse para kodrës sonë qëllojnë vazhdimisht me mortaja. Si duket ata pastronin kodrat përreth.

Vendosëm në komandën e kompanisë të dërgonim dy korierë në Çekin, që të lajmëronin shokët për këtë lëvizje të forcave armike. Rruga kalonte nga kodrat ku binin predhat e mortajave. Tjetër rrugë nuk kishte. Në një copë letër shkruanim se si ishte gjendja. Me dy fjalë përshkruam situatën dhe i ftonim shokët që ishin në Çekin, të

sulmonim nga lart poshtë në lumë, pse ne ishim në mes dhe do të hapnim zjarr si kundër kolonës ashtu edhe kundër ballistëve që ishin sipër nesh në kodrat dominuese.

Të dy korrierët, të cilët dualën vullnetarë për të çuar letrën, u vranë nga predhat e mortajave. Ne i morëm dhe i varrosëm pas mbarimit të luftimeve. Për ta u pikëlluam të gjithë. Qenë që të dy të rinj dhe djem shumë trima.

Kështu, pasi e pamë se nuk mund të lidheshim me shokët e tjerë vendosëm t'ja fillonim luftës vetëm, duke pasur besim të plotë se shokët do të dëgjonin e do të sulleshin në drejtimin tonë.

Kështu, pasi u këshilluam në këmbë, u ndamë në tre drejtime, po në të njëjtën kodër. Me një-rën skuadër shkoi Abaz Fejzua, me të dytën Xhafer Peçi dhe me të tretën unë. Abazi e Xhaferi u nisën buzë lumit në dy drejtime, kurse skuadra e tretë u vendos ballë për ballë me ballistët.

Me buzë në gaz dhe vendosmëri të plotë secili zuri vendin që i përkiste. Askujt si pritej sa të jepej urdhëri për zjarr. Të gjithë kishin besim të patundur në fitore.

Dhe ja, filloi goditja. Në fillim Abazi dhe pastaj Xhaferi. Gjermanët nuk e prisnin të goditeshin kështu në befasi nga mitraloza të kryqëzuar dhe në fillim u hutuan, se po goditeshin nga ai krah ku ishin forcat balliste. Por kur panë që zjarri ynë ishte i paktë, menjëherë e morën veten dhe morën anës kodrave të Çekinit, ku kish pyje të dendur, për të na marrë krahët nga ana tjetër.

Sa vinte e rrethimi ngushtohej. Ballistët qëllonin mbi ne dhe thërrisnin: «Hej komunistë, tani ju erdhi fundi! Gjermanët do t'ju bëjnë copë-co-

pë». Kurse disa të tjerë na thoshnin: «Hidhni armët! S'keni ku të veni! Ne do t'ju shtypim!» Por ne ua kthenim me krismat e pushkëve dhe mitra-lozave tanë dhe i ftonim të afroheshin e të provonin në shesh të burrave armët tona.

Pas 15-20 minutash luftimi, befaz dëgjojmë një mori thirrjesh: «Urra!» Ishin kompanitë e tjera të batalionit tonë, që të shpërndara në formacion luftimi, po sulmonin që poshtë nga kodrat e Çekinit, ashtu si e kishim parashikuar ne që më parë.

Urrija e shokëve na dha fuqi të madhe. Na u duk, sikur u ngjallën që të gjithë kështu ne, që më parë, ishim të rrethuar, i rrethuam gjermanët në të dy anët e lumit dhe i goditëm me furi. Të hutuar nga kjo goditja e befasishme, gjermanët u futën në mes të lumit dhe të shpartalluar filluan të kthehen nga erdhën, por ne s'i lamë, i ndoqëm, duke i vrarë në ujë. Dhjetë prej tyre ranë robër. Të tjerët gati u zhdukën.

Një pakicë e vogël që shpëtoi ja mbathi rrugës Elbasan-Gramsh, për t'i çuar komandës gjermane lajmin e disfatës.

Gjatë këtij luftimi kompanisë sonë ju vrarë dy korrierët, kurse nga kompania e tretë në sulm e sipër ra shoku Sadush Çunaj e u plagos një shok tjetër. Veç armëve të zëna, në këtë luftim ra në duart tona edhe një radiotransmetuese.

KËSHTU NGJAU

Deri në shtator të vitit 1944 Divizioni I sulmues kishte çliruar krahina të tëra të Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Peshkopia dhe Dibra ishin çliruar përgjithmonë. Në këtë kohë Brigada e parë mori urdhër të çlironte Krujën dhe t'i afrohej Tiranës.

Më 5 shtator katër batalione të brigadës, me përjashtim të batalionit II, që kishte mbetur në Mat, u nisën në drejtim të Qafë-Shtamës.

Gjatë udhëtimit, partizanëve dhe partizaneve u shkëlqenin sytë nga gëzimi. Dikush tha: «Do t'i biem Tiranës se i erdhi koha»!

Në mbrëmjen e 7 shtatorit i afrohemi Krujës. Batalioni IV dhe V shkojnë në drejtim të kalasë dhe kazermave gjermane, ndërsa i treti, për të marrë pozicionet mbi Krujë. Dy kompanitë e batalionit I zënë pritë në krahun e djathtë të xhadesë që hyn në Krujë. Kruja duhej të merrej me çdo kusht.

Në orën 3.00 të datës 8 shtator, të gjitha forcat zunë vendet e caktuara nga komanda e brigadës. Nga kalaja u dha sinjali. Lufta ndizet e rreptë rrotull kazermave. Buçasin bombat, pushkët dhe automatikët. Të dy kompanitë, që janë vendosur afër xhadesë, tek vorrezat, vazhdojnë të presin

ndonjë kolonë gjermane që mund të vijë nga Fushë-Kruja ose Tirana. Dhe nuk presin kot... Një kolonë e gjatë po afrohet. Pararoja hyri në pritë. Zjarri i të gjitha armëve tona, si rrufeja që shkar-kon, bie mbi këta xhelatë. 18 nazistë mbetën të shtrirë për tokë. Në këtë kohë, kolona gjermane, që ishte akoma larg, duke parë se krahu tjetër ishte i lirë, fillon të ngjitet andej.

Përleshja në Krujë vjen duke u ashpërsuar dhe rreth kazermave ngushtohet gjithnjë e më tepër rrethimi.

Nazistët i mban vetëm një shpresë: kolona që vjen nga Tirana. Por edhe kjo shpresë ishte e kotë. Komanda e batalionit, duke çmuar drejt situatën e krijuar, vendosi që në anën e majtë të xhadesë të dërgonte dy skuadra. Me shpejtësi, partizanët u hodhën në anën tjetër të xhadesë dhe zunë një vijë të gjerë, duke u vendosur larg njërit-tjetrit.

Kolona gjermane, duke menduar se rruga ishte e lirë, ecën në drejtimin ku qëndronin tre nga shokët tanë: skuadërkomandanti, një partizan dhe një mitralier. Armiku afrohet. Ata hapin zjarr me bomba dore. Në fillim gjermanët hutohen, por shpejt e marrin veten. Megjithatë të tre partizanët e korrin armikun pa ndërprerje.

Janë vetëm tre, kundra 100. Syri nuk u trembet. Luftojnë. Armikut s'i duhej lënë në asnjë mënyrë rrugë e lirë. Përndryshe, shokët që luftonin për çlirimin e Krujës, do rrezikoheshin dhe plani do të dështonte.

Gjermanët nga goditja e befasishme çorientohen. Por partizanëve po u mbarohet municioni. Njërit s'i punon pushka. Ka vetëm dy bomba. Mi-

tralierit i kanë mbetur 30 fishekë dhe automatiku i shokut tjetër është me një karikator.

Ata bisedojnë:

— Si t'ja bëjmë? T'i lëshojmë pozicionet?

— Jo, kurrë!

— Atëhere, duhet të hidhemi në sulm mbi nazistët! T'u marrim armët dhe të vazhdojmë luftën.

Para tyre, 7-8 metra larg, ishin dy gjermanë të vrarë, Njëri kishte pushkë 10-tëshe dhe tjetri automatik. Partizanët u sulën drejt tyre dhe u rrëmbyen armët dhe bombat. Mitralleri qëllonte për të mbrojtur shokët. Ata bënë përpara dhe morën edhe mitralozin e një gjermani të plagosur. Dhe toka prapë zien. Vdekja korr pa pushim gjermanët. Duke vazhduar sulmin zbresin gjithnjë e më poshtë në drejtim të gurores së Fushë-Krujës. Brenda pak minutash nga momenti i sulmit, kolona gjermane, e çoroditur, vihet në ikje, duke lënë në fushën e betejës 24 të vrarë, dy robër, tre mitraloza, 30 pushkë dhe të gjitha predhat e mortajës.

Në këtë kohë, u dha sinjali nga Kruja: Kruja u çlirua, Kruja ra në duart tona.

Nga të tre shokët, vetëm njëri u plagos lehtë.

Pra, kështu ngjau...

HERONJTË E VIGUT

Epopeja e Vigut ka hyrë në historinë e Luftës nacionalçlirimtare si një nga shembujt e shumtë të trimërisë dhe vetëmohimit të partizanëve tanë për çështjen e partisë dhe të popullit. Ajo do të mbetet si një burim i madh frymëzimi për akte të reja heroizmi, për mbrojtjen e atdheut dhe për ndërtimin e jetës së re.

Epopeja e pesë heronjve ka ndodhur më 21 gusht të vitit 1944, në Vig të Mirditës, në një kohë kur Divizioni i parë sulmues, sipas urdhërit të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë nacionalçlirimtare, shokut Enver Hoxha, vazhdonte mësymjen për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut.

Mirdita, para çlirimit dhe gjatë Luftës nacionalçlirimtare, ishte një nga krahinat më karakteristike të Malësisë së Veriut, të cilën regjimet shtypëse, dhe kleri e mbanin në një gjendje shumë të prapambetur.

Krahas hierarkisë zyrtare të pushtetit shtetëror, si të nënprefektit, kryetarit të komunës, postkomandantit, gjykatësit, etj, ekzistonte një hierarki tjetër, jo zyrtare, por më me autoritet dhe më me pushtet se e para, ajo e krerëve dhe e bajraktarëve, në krye të së cilës qëndronte «kapidani»

nga shtëpia e Marka-Gjonëve. Kjo familje brez pas brezi e ka tradhëtuar atdheun, duke u vënë me zell në shërbim të çdo të huaji, dhe ka shtypur e ka shfrytëzuar në mënyrën më të egër malësorët e kësaj krahine. Çdo familje, në çdo kohë, ishte e detyruar të vinte në dispozicion të «kapidanit» një mashkull, sepse, siç thoshin atëhere, «ja kishte borxh».

Gjatë pushtimit të atdheut tonë nga Italia fashiste e më vonë nga Gjermania naziste, Gjon Marka Gjoni, duke ndjekur vazhden e tradhëtisë, u vu plotësisht në shërbim të të huajve, kundër popullit dhe kundër lëvizjes nacionalçlirimtare. Ai së bashku me pushtonjësit fashistë, duke u mbështetur në krerët dhe bajraktarët, kishte organizuar në Mirditë një kordon të fortë, që të mos futej aty asnjë shkëndijë përparimi, asnjë ndjenjë revolucionare, që komunistët të mos kishin asnjë mundësi për të depërtuar dhe për të zhvilluar aktivitet në popull, që edhe kur të hynin, të kapeshin ose të vriteshin.

Komiteti qarkor i partisë për Shkodrën vendosi të dërgonte përsëri në këtë zonë një njësit partizan, i cili të çonte në popull fjalën e partisë dhe ta ngrinte atë në këmbë kundër pushtuesve fashistë dhe kundër partisë së vendit, që ishte vënë në shërbim të armikut.

Kur shokëve ju tha, se misioni ishte sa i rëndë aq dhe i rrezikshëm, njëri prej tyre Ndoc Mazi, u përgjegj: «S'ka kala që nuk marrin komunistët».

Njësit i përbëhej prej rreth dhjetë vetësh: Ndoc Mazi, komunist që me formimin e partisë, me pseudonimin «Minuku», gjithë jetën e tij ja kushtoi çështjes së madhe të revolucionit. Nga

kushtet e vështira të jetesës, Ndocit i ishte shfaqur sëmundja e tuberkulozit, nga e cila vuante aq shumë sa që shpesh, në punë e sipër humbiste ndjenjat. Por ai ishte revolucionar dhe kjo gjendje nuk e dekurajonte, përkundrazi ai ishte gjithnjë optimist. Edhe në ato çaste, me humorin e tij të këndshëm, duke përbuzur sëmundjen, ai i qetësonte shokët, të cilëve u vinte keq kur e shihnin aq të sëmurë. Kuptohet, se vetëm idetë revolucionare të partisë ishin ato, që e frymëzonin Ndocin të mos i dorëzohet vdekjes dhe të gjente forca për të përballuar sëmundjen, për të qëndruar në pararojë të luftës së popullit, duke shikuar vetëm interesin e përgjithshëm.

Me këto tipare të reja, morale i pajisi atë dhe shokët e tij Partia.

Naim Gjylbegu, anëtar partie, anëtar i Komitetit qarkor të rinisë për Shkodrën, me pseudonimin «Besniku», ishte një luftëtar i sprovuar trim dhe i vendosur, që kishte vuajtur torturat më të egra të kuesturës fashiste, duke qëndruar i patundur. Prej natyre, ishte i qetë dhe i matur edhe në situatat më të ndërlikuara. Puna e rëndë, dhe lufta kundër fashizmit, e kishin pjekur para kohe. Ishte gjithmonë gojëmbël e i dashur me shokët, tek të cilët ngjallte besim me bindjet e tij, me ndershmërinë dhe vendosmërinë e tij.

Ahmet Haxhia, anëtar partie, anëtar i Komitetit qarkor të rinisë, me pseudonimin «Tigri», që në moshë të njomë kishte provuar torturat dhe burgjet e fashizmit. Ai ishte gjithmonë optimist, plot entuziazëm, i etshëm për luftë, i gatshëm për t'u hedhur në zjarr, dhe kishte më tepër nevojë të përmbahej, se sa të nxitej për aksion. Ahmeti

ishte nga ata të rinj revolucionarë, të cilët, në atë kohë, u detyruan të linin bankat e shkollës dhe të futeshin vullnetarisht në rrugën e luftës së pamëshirshme kundër pushtonjësve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit.

Ndoc Deda, fshatar nga Miloti, anëtar partie, me pseudonimin «Teli», kishte ndjerë mbi shpatullat e tij shtypjen dhe shfrytëzimin e çifligarëve dhe të regjimit antipopullor të Zogut, si dhe të pushtonjësve fashistë. Pas një aktiviteti revolucionar në rreshtat e ushtrisë kukull «kombëtare», u hodh në radhët partizane.

Në fytyrën e tij të hequr dhe serioze, dukeshin gjurmat e jetës së rëndë si dhe urrejtja për të gjithë ata, që shtypnin dhe shfrytëzonin popullin. Ndoci fliste rrallë, por gjithmonë fjalë të matura, ishte shumë i zgjuar, i qetë dhe trim i rrallë. Në karakterin e tij ruante vetitë më pozitive të popullit tonë: burrninë dhe besnikërinë.

Hidajet Lezha, i ri komunist nga qyteti i Lezhës, me pseudonimin «Hida», në luftë me vështirësitë e jetës, për të siguruar bukën e gojës, ishte pjekur para kohe dhe ishte kalitur me urrejtjen për shtypjen dhe padrejtësitë. Hidajeti ishte djalë i shkathët. Tiparet e theksuara të fytyrës së tij, syri i mprehtë si sy shqiponje, vendosmëria e qëndrueshmëria e tij, të krijonin besimin se ai ishte i aftë për të kryer vepra heroike.

Këta ishin pesë ndër dhjetë partizanët e njësitit të vogël të Mirditës, në përbërjen e të cilit ndodheshin edhe bij të tjerë të kësaj krahine, komunistë trima, të devotshëm deri në fund për çështjen e partisë dhe të popullit, si Bardhok Biba e të

tjerë, të cilët luajtën një rol shumë të madh në këtë periudhë, si vendas, për krijimin e lidhjeve, zgjerimin e bazave dhe, në përgjithësi, për shtrirjen e aktivitetit revolucionar.

Armiqtë, duke u bazuar në masat që kishin marrë, mendonin se nuk do të gjendeshin trima të tillë, që të guxonin të futeshin përsëri në këtë çerdhe të reaksionit, se nuk do të kishte shtëpi që do t'i mbante, por do t'i vriste ose do t'i kapte, ashtu siç kishte urdhëruar «kapedani», Gjon Marka Gjoni.

Mirëpo, reaksionarët u gabuan rëndë. Njësitë i vogël, pa marrë parasysh rreziqet, që në janar të vitit 1944, shkoi në këtë zonë dhe zhvilloi një aktivitet të gjerë revolucionar, duke kaluar nga fshati në fshat, duke çuar dritën e partisë kasolle për kasolle. Populli i thjeshtë i Mirditës i priti, i ushqeui dhe i ruajti partizanët nga kurthet që herë pas herë ngrinte armiku.

Puna e partizanëve filloi shpejt të jepte frytet e veta, duke bërë që njerëzit të mos pranonin të rekrutoheshin në bandat mercenare, që të tjerë të dezertonin dhe të demaskonin tradhëtinë e Gjon Marka Gjonit e të bashkëpunëtorëve të tij.

Veprimtaria e këtij njësitë filloi t'i shqetësonte shumë krerët e reaksionit të kësaj krahine, të cilët, të egërsuar, filluan ta gjurmonin këmba-këmbës, të ngrinin prita pas pritash, me shpresë se brenda pak ditësh njësitë, ose do të ikte nga Mirdita, ose do të asgjësohej. Mirëpo, me gjithë vështirësitë shumë të mëdha, njësitë vazhdoi të qëndronte nëpër Mirditë, për të plotësuar deri në fund detyrën e partisë.

Ai vepronte herë i bashkuar e herë i ndarë në grupe, nëpër fshatra të ndryshme të Mirditës dhe

filloi ta shtrinte aktivitetin e tij edhe në Malësinë e Lezhës.

Më 18 gusht, ky njësit, u urdhërua që të kthehej në fshatrat rreth Shkodrës, për të marrë pjesë në formimin e një batalioni të ri partizan. Në këtë kohë një pjesë e tij, konkretisht pesë heronjtë, ndodheshin në Malësinë e Lezhës. Ata u nisën në drejtim të Vigut, për t'u takuar me pjesën tjetër të njësitit, që ndodhej në Mirditë.

Më 20 gusht ata arritën në katundin Ras i Bûtë, i krahinës së Mirditës, ku kaluan edhe natën.

Më 21 gusht, njësit i vazhdoi udhëtimin dhe në orën 11 para dreke, arriti tek një shesh i rrethuar prej kodrave me dushk, në vendin e quajtur Gjonabardhë të Vigut. Befas, nga të katër anët u dëgjuan klithma për t'u ndaluar dhe për t'u dorëzuar. Kishin rënë në pritën e ngrehur nga tradhëtari i atdheut, agjenti i Gjon Marka Gjonit, kryetari i komunes së Kalivaçit dhe komandant i bashibozukëve të këtij rajoni, Pjetër Lleshi si dhe nga disa krerë dhe bajraktarë të tjerë si Mark Jak Bajraktari, Dod Mark Gjokaj etj. Armiqtë ishin shumë, rreth 300 vetë, të mbrojtur, ndërsa shokët tanë ishin pak, vetëm 5 vetë, në mes të sheshit, duke pasur të drejtuara rreth 300 gryka pushkësh. Ata u gjendën përpara dy rrugëve: ose të dorëzoheshin dhe të shpëtonin jetën, por të jetonin si tradhëtarë të atdheut, të popullit dhe të partisë, ose të pranonin vdekjen e sigurtë, por me nder, në krye të detyrës, duke dhënë jetën për popullin për partinë. Koha nuk priste, duhej vendosur. Të gjithë partizanët, pa nguruar, zgjodhën vdekjen me nder për atdhe, përpara jetës me turp dhe në tradhëti. Ky qëndrim i komunistëve që krejtësisht i papritur

për armiqtë dhe ngjalli habi dhe tronditje në radhët e bashibozukëve, sepse gjer atëhere nuk kishin parë njerëz të tillë, të cilëve, megjithëse ju dha mundësia për të shpëtuar jetën, pranuan të vdesin si burrat, duke luftuar me armë në dorë.

Thonë, se shumë prej bashibozukëve u shtangën nga ky qëndrim dhe nuk qëlluan fare. 5 heronjtë, ashtu të pambrojtur, me një trimëri të pashembullt, vazhduan luftën, derisa punoi dora dhe syri dhe, deri në frymën e fundit, duke vulosur me gjakun dhe jetën e tyre besnikërinë ndaj popullit, duke ngritur kështu lart lavdinë e partisë dhe të ushtrisë sonë.

Në kohën kur armiqtë, nga prita, bënë përpjekje për t'i bindur partizanët që të dorëzoheshin, sepse i kishin premtuar «kapedanit» t'ja çonin të gjallë, në vendin e rrethimit kaloi një grua mirditore, Drandja e Jak Markut. Pesë heronjtë i dorëzuan kësaj një letër për Komitetin qarkor të partisë së Shkodrës, me këtë përmbajtje:

«Vig 21 Gusht 1944.

Të dashun shokë!

Jena të rrethuem dhe po presim në çdo çast të na përshkojnë plumbat e tradhëtarëve, por na kena da ma mirë me dhanë jetën si me le, se sa me tradhëtue luftën që kena nisë. Një herë thamë: Ja vdekje ja liri! Pra shokë, ju do të ndjekni punën tonë, prej ku po e lamë na, me guxim të pathyeshëm.

Shokë, prej maleve të Mirditës, ku asht çerdhja e tradhëtarëve, ju çojmë përshëndetjet tona tue brohoritë të gjithë nji zani: «Vdekje fashizmit — Liri e Popullit!»

Të fala.

Të pesë shokët: Teli, Besniku, Tigri, Minuku, Hida».

Kështu dhanë jetën pesë trimat. Në truallin e vaditur me gjakun e tyre dhe të mijëra dëshmorëve, u ngritën themelet e forta të Shqipërisë së re socialiste. Atdheu ynë është sot ashtu si e kanë dashur ata: i lirë, i bukur e i fortë.

LUFTA NË QAFËN E KRRABËS

Në muajin tetor të vitit 1944, Brigada XV sulmuese zhvillonte luftime në rrugën Librazhd-Elbasan. Kolona të mëdha gjermane lëviznin nga Struga dhe nga Selaniku me drejtm për në Tiranë. Kolonat e automjeteve të blinduara e të armatosura deri në dhëmbë, goditeshin kudo, në prita dhe në vende që ato nuk e pritnin.

Batalionit II të Brigadës XV sulmuese, që kishte zhvilluar luftime edhe brenda në qytetin e Elbasanit, ju ngarkua detyra që të bënte pritë në Qafën e Krrabës, kundër kolonave armike dhe një reparti gjerman, që ishte ngarkar të ruante rrugën automobilistike.

Kompania I dhe II u ngarkuan që të zhvillonin luftime me forcat gjermane dhe mercenare të dislokuara për ruajtjen e rrugës. Midis tyre kompanitë ishin në garë se kush do të bënte luftime më shumë, kush do të vriste më shumë armiq.

Pritat në rrugë ndërtoheshin prej mbrëmjes deri në të zbardhur. Partizanët, të vendosur në pozicione dhe me sy pishë, vështronin, po armiku nuk dukej. U informuan se ai kishte ndërruar drejtimin, nuk do të kalonte nga Qafa e Krrabës por në rrugën Elbasan-Peqin-Durrës. Duhej të gjenim

mundësinë për t'i prerë udhën armikut dhe për t'u ndeshur me të.

Hitlerjanët kishin diskoluar forca gjatë lëvizjes dhe kishin fortifikuar shumë vende. T'i sulmonim ato mund të pësonim dëme dhe mund të mos arrinim asnjë sukses.

C'duhej të bënim?

U mbledh kompania, u informuan partizanët e partizanet se batalionet e tjera po bënin kërdrinë në kolonat gjermane në rrugën Xhyre-Librazhd, ku kërciste kudo pushka. Kompani të shkëputura, gjithashtu po bënin kërdrinë në prita, kurse sektori i kompanisë sonë për pesë net po heshtte. Dhe me një zë vendosëm të kalojmë me një marshim të shpejtë, në rrugën Peqin-Elbasan. Kjo detyrë duhej të kryhej sa më parë.

Ishte një natë e kthjellët. Një kolonë erdhi nga Durrësi në drejtim të Elbasanit. Partizanët kishin zënë pozicionet.

Kolona po afrohej, partizanët prisnin me padurim të jepej sinjali për të hapur zjarr. Të gjithëve u gufonte zemra, për t'u kacafytur me pushtuesit e urryer. Priste në radhë edhe partizan Vasil Barova, një djalë trim dhe mitralier i zoti.

Kolona e armikut vazhdonte rrugën dhe më në fund u fut në mesin e kompanisë. Të gjithë ishin gati. U dha sinjali, u shkrehën armët. Vendi oshëtiu. Vasili qëllonte dhe kornte me mitralozin e tij. Hitlerianët u sakatosën e u asgjësuan. Shumë maqina u dogjën. Në këtë luftim u dallua shumë skuadra e Neshoicës. Partizanët e saj sulmuan një automjet, vranë shoferin gjerman, morën materialin që kish dhe i vunë zjarrin.

Në këtë përlshje ranë dëshmor Estref Meko,

R. Berogozhda, Xhafer Benjozo, Slaniko Staria, Vasil Barova.

Armiku kolonat i drejtoi në rrugën Elbasan-Qafa e Krrabës. Po edhe komanda jonë urdhëroi që në këtë rrugë t'u hapej dhe një varr tjetër pushtonjësve, që ishin bërë si të tërbuar. Kompania jonë në mesnatë u vendos në Qafën e Krrabës.

Artileria gjermane filloi të rrihte vargun e kodrave të kësaj qafe dhe nga kjo u kuptua se në këtë udhë do të kish lëvizje. Në orën 8 të mëngjezit, 10 maqina të mbushura me ushtarë gjermanë të shoqëruara nga dy autoblanda, duke ecur me kujdes, kontrollonin, qëllonin dhe vrojtonin. Kur kolona u fut në kthesën e fortë të Qafës së Krrabës, jehoi pushka partizane. Për dy orë rresht aty u bë tym nga krismat e pushkëve, të mitralozave e bombave të dorës. Gjermanët kërkonin të mbuloheshin dhe të shpëtonin. Por kishin rënë në një darë që nuk i lëshonte. U vranë 60 vetë dhe 20 u zunë të gjallë. Të gjitha maqinat dhe pajisjet u kapën nga partizanët.

Komanda gjermane, për t'i ardhur në ndihmë kolonës, dërgoi përforcime, por këto përforcime u pritën në befasi nga kompania fqinje poshtë Qafës së Krrabës, dhe u detyruan të iknin me turp për në Elbasan.

Batalioni në këtë rajon filloi aksionet njërin pas tjetrit. Çdo kompani ndërtoi prita të pakalueshme që u bënë tmerr dhe varr për kolonat gjermane që përpiqeshin të kalonin në këtë rrugë.

ASNJË HAP PRAPA!

Ishte java e fundit e shtatorit të vitit 1944. Moti ishte i keq. Ditë e natë binte shi. Partizanët të lagur vazhdonin luftimet, për të afruar ditën e çlirimit të kryeqytetit tonë të dashur, Tiranës.

Komanda e batalionit të tretë të Brigadës së katërt sulmuese kishte marrë urdhër që të sulmonte Prezën në bashkëveprim me dy batalione të Brigadës së parë sulmuese, pasi Abaz Ermeni, Xhelal Staravecka dhe Murat Basha kishin organizuar një forcë të madhe dhe ishin përqëndruar në Prezë.

Në pasditën e datës 27 shtator, komisar i batalionit mbloodhi të gjithë komunistët dhe parashetroi planin e sulmit, për shpartallimin e forcave mercenare, të vendosura në Prezë. Ai tregoi se detyra ishte e vështirë, pasi marshimi do të bëhej në fshehtësinë më të madhe natën, duke kaluar rrugët automobilistike Vorë-Tiranë dhe Vorë-Shkodër, të cilat ruheshin nga forcat Gjermane. Të gjithë partizanët u përgatitën shpirtërisht dhe bënë gati armët, municionin dhe granatat e dorës.

Marshimi filloi në orën 21.00. Në krye të kolonës udhëhiqte kompania e dytë. Shi, errësi, baltë. Në të zbardhur të dritës, ne u ndodhëm në

rrugën automobilistike Vorë-Shkodër dhe një pjesë e batalionit e kapërceu xhadenë. Në këtë kohë u dukën në xhade patrullat Gjermane me autoblanda. Batalioni u nda në dy pjesë, një pjesë mbi xhade dhe tjetra nën xhade. Por gjermanët nuk i zbuluan forcat tona dhe vazhduan rrugën. Me kalimin e autoblandave batalioni kaloi i gjithë dhe forcat mercenare, të përqëndruara në Prezë, nuk muarën vesh fare se ç'ndodhi.

Kompania e parë dhe e tretë u caktuan të sulmonin katundin Prezë, kurse kompania e dytë të ruante kodrat e para të Prezës dhe rrugën automobilistike Vorë-Prezë. Armiku u zu në befasi. Forcat tona muarën me një sulm dy lagjet e para të katundit, por në të njëjtën kohë dhe forcat gjermane, që ndodheshin në Vorë, dërguan një togë ushtarësh në drejtim të kodrave të para të Prezës. Skuadra, e komanduar nga Nazif Nexhipi, i priti me zjarr të befasishëm dhe ata u thyen, duke lënë katër të vrarë dhe 11 biçikleta që kishin me vete. Ky sukses na dha shumë guxim. Por pas 5-6 orësh, aty nga mesdita e datës 28 shtator, në xhade u duk një autokolonë e madhe gjermane me tanksa dhe maqina. Ajo zuri vend në veri-lindje të Prezës. Në këtë kohë, gjermanët filluan të bënin qitje me artileri nga Vora e Rrushkulli, ndërsa tanksat na u turrën nga lindja. Të inkurajuara, forcat mercenare u hodhën në kundërsulm.

Gjendja jonë u bë e vështirë. Territori ynë sa vinte e ngushtohej, pasi nga katundi Prezë sulmonin disa qindra mercenarë. Komisari i batalionit, duke qëndruar në vijën e parë të përpjekjes, thirri:

— Shokë, asnjë hap prapa!
Dhe partizanët i qëndrojnë burrërisht furisë

armike. Në këtë kohë një mitralier dhe komandanti i kompanisë së tretë u plagosën, por një shoqe e bëri shoshë me automatik trupin e një oficeri madhor Zogist, gjë që shkaktoi rrëmujë e panik në radhët e armikut. Por në këto çaste, duke kaluar përmes Fushë-Krujës ja mbërritën partizanët e Brigadës së parë sulmuese, të cilët menjëherë sulmuan kolonën gjermane. E thyer, kolona armike ecën në drejtim të Shkodrës. Pas këtij sukcesi, partizanët e Brigadës së parë sulmojnë Prezën, nga ana e veriut. Forcat mercenare, të përqëndruara në Prezë, duke lënë pas një numër të vrarësh, shpartallohen keq dhe ua mbathin me të katra.

LUFTA PËR KALANË E BERDICËS

Nëntori i vitit 1944 ka lënë në kujtesën time ngjarje të paharruara.

Në ato ditë, kur pushka partizane qëllonte ditë e natë kundër armiqve, entuziazmi i partizanëve e i popullit kish arritur kulmin. Çdo ditë vinin lajme për fitore të reja. Ja, Tirana u çlirua, pastaj Fushë-Kruja, Miloti, Lezha.

Brigada XXIII sulmuese, që ishte vendosur në rrugën Tiranë-Fushë-Krujë-Milot, në këtë kohë godiste pa pushim kolonat armike që tërhiqeshin për të shpëtuar gjallë.

Pasi kaluam me trap Drinin, në afërsi të Lezhës (se ura që prishur), brigada jonë u përqëndrua në fshatrat e krahut të majtë të rrugës automobilistike Lezhë-Shkodër dhe u pregtit që të sulmonte armikun që kishte përballë.

Ishte pikërisht nata e datës 26 nëntor 1944. Kompania jonë mori urdhër që të sulmonte po atë natë kalanë e Berdicës, në fshatin Berdicë, afër Shkodrës, ku forcat gjermane dhe mbeturinat balliste, ishin përqëndruar dhe ruanin, me çdo kusht portat e Shkodrës, sidomos hyrjen për nga ura e Baçallekut.

Para nisjes u bë mbledhja e organizatës së

partisë së kompanisë, ku u diskutuan dhe u ndanë detyrat për të gjitha çështjet, që na dilnin përpara. Shokët e komandës u shpërndanë nëpër toga që t'i udhëhiqnin direkt në sulm.

Aty nga mbrëmja filloi marshimi drejt kalasë së Berdicës. Me ndihmën e një udhërrëfyesi që ish fshatar patriot i këtyre anëve, ne u nisëm drejt objektit që do të sulmonim, një kala gjysmë e rrënuar mbi kodra të zhveshura. Ecnim herë në rrugëza këmbësore dhe herë nëpër fusha që ishin plot me baltë e me ujë nga shirat e rrëmbyeshëm të vjeshtës, që vazhdonin të binin. Disa kanale ishin mbushur plot e përplot me ujë dhe mezi i kalonim. Por asnjëri nuk mbeti prapa. Të gjithë ecnin me shpejtësi, pa zhurmë. Prapa mbetej aty këtu ndonjë opingë llastiku e partizanëve, që këputej e mbulohej nga lluca.

Ne donim të shkonim sa më afër armikut dhe të mos diktoheshim prej tij. Por edhe ay përgjonte sapo mbaroi fusha dhe filloi rrëza e kodrave, u mblodhën të gjithë tok, ndamë detyrat për çdo togë këmbësorie dhe i caktuam detyrën togës mitraliere, që do të na shoqëronte me zjarr gjatë sulmit. Porsa filluam t'u ngjiteshim kodrave, u diktua nga armiqtë (pasi ishim afruar shumë me ta) dhe filloi lufta. Dy mitraloza «Shars» gjerman na qëllonjë me fishekë gjurmë-lënës nga krahu i djathtë dhe një tjetër, nga krahu i majtë, nga kisha, kurse nga sipër, duke qënë në pozicione të pregatitura dhe të mbrojtura mirë me kodra natyrale dominonjëse, armiqtë hidhnin radhazi bomba dore gjermane me bisht druri të cilat, megjithëse ishte natë, dalloheshin kur fluturonin mbi kokat tona dhe binin para ose prapa nesh.

Në një situatë të tillë, lufta u ndez e rreptë. Partizanët tanë, të kalitur nga partia jonë, nuk mba-heshin. Ata shfrynin me furi tërë urrejtjen e tyre mbi armikun. Aty sulmoi krah për krah komandan-ti me partizanin, nënkomandanti me skuadërko-mandantin, mitralieri me automatiksin, sulmoi ma-tjani dhe ishmaku, të gjithë si një trup i vetëm u hodhën përpara megjithëse sulmi ynë bëhej në të përpjetë.

Lëvizja dhe manovrimi ynë i shpejtë e goditi në zemër dhe e hutoi armikun. Ata të majës së ko-drave u tërhoqën më tutje, kurse ata të krahëve, kur panë se zjarri i armëve tona u ngjit në majë, pushuan me mitralozat e tyre dhe ua mbathën kë-mbëvet.

Megjenëse ishte një natë shumë e errët dhe he-rë-herë binin shira, ne nuk pamë se cilat qenë kon-kretisht humbjet e armikut në njerëz, por pamë atë që këta armiq nuk qenë të zotët të qëndronin dot dhe u shtynë gjithnjë kodër pas kodre, derisa u larguan krejt nga toka jonë.

Në këto luftime nga kompania jonë u dalluan, për trimëri dhe guxim të vendosur, nënkomandan-ti i kompanisë, shoku Sadik Sana, skuadërkomandan-ti Xhemal Meta e Sadik Beshku dhe mjaft par-tizanë të tjerë.

Në këtë përpjekje ne humbëm partizanin Vath Lleshi nga katundi Bizë i lokalitetit të Ishmit, i cili u plagos rëndë nga bombat e dorës që hodhi armi-ku. Ai jetoi vetëm 4-5 orë dhe vdiq si trim në duart tona. Patëm gjithashtu edhe një të plagosur, por detyrën e kryem. Armiku u dëbua disa kilometra më tutje dhe pas dy ditësh, ne hymë në Shkodër.

Në mëngjez herët të datës 29 nëntor kolonat

P È R M B A J T J A

	faqe
<i>Qiriako Deçka</i> — Sihariqi i një ngjarjeje të madhe ..	5
<i>Vehbi Hoxha</i> — Kujtime nga ditët e para	7
<i>Qiriako Deçka</i> — Vojo Kushi «Hero i Popullit»	14
<i>Qiriako Deçka</i> — Ju lumtë dora, bre trimat e Shqipërisë	25
<i>Vehbi Hoxha</i> — Epopeja e Gjormit	27
<i>Raqi Janushi</i> — Automatikun t'ja dorëzoni nënës sime si kujtim.	36
<i>Koli Mborja</i> — Çlirimi i Voskopojës	40
<i>Adnan Qatiji</i> — Ai jetoi dhe vdiq si komunist	45
<i>Luan Qafëzezi</i> — Trim mbi trimat	55
<i>Selam Qejvani</i> — Kujtime nga lufta e Mezhgoranit ..	58
<i>Qazim Kapisyzi</i> — Lufta e Reçit	63
<i>Lake Vodica</i> — E fundit në tërheqje	69
<i>Gaqo Stefo</i> — Goditje e befasishme	72
<i>Xhafer Matuka</i> — Nëna e çetës	77
<i>Stiliano Sallabanda</i> — Nënë, mos tradhëto shokët! ..	83
<i>Petro Kito</i> — Aksioni pranë urës së Kranesë	87
<i>Gaqo Çollaku</i> — Armiku nuk kaloi	89
<i>Shuaip Shaze</i> — Komunistja e orëve të para	94

	faqe
<i>Ilmi Telegrafi</i> — Shalli i kuq	99
<i>Qebir Hysi</i> — Ai ishte njeriu më i dashur	104
<i>Mehmet Karashabani</i> — Lufta e Selbës	112
<i>Lame Çekani</i> — Lavdi Trimave	117
<i>Ilmi Telegrafi</i> — Zbuluesit	123
<i>Qebir Hysi</i> — Në vargun e betejave	127
<i>Lame Çekani</i> — Shokë, vëllezër!	134
<i>Bedri Gjergji</i> — Zjarr mbi Pekisht dhe anë Holtit. . .	139
<i>Mitat Goxhi</i> — Kështu ngjau	145
<i>Qazim Kapisyzi</i> — Heronjtë e Vigut	148
<i>Stavri Qafëzezi</i> — Lufta në qafën e Krrabës	156
<i>Sali Pronjari</i> — Asnjë hap mbrapa!	159
<i>Jani Borova</i> — Lufta për kalanë e Berdicës	162